

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

Fakulteti i Drejtësisë

STUDIMET POSTDIPLOMIKE-MASTER

DREJTIMI PENAL



PUNIM MASTERI

**ANKESA KUNDËR AKTGJYKIMIT NË
PROCEDURËN PENALE TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS**

Kandidati:

Flamur Xhelili

Mentorja:

Prof.Dr. Besa Arifi

Tetovë, 2022

Përmbajtja.....	2
HYRJE.....	4
1. Objekti dhe interesi shkencor i studimit.....	4
2. Metodologjia e studimit.....	5
3. Struktura e punimit.....	6

KAPITULLI I

VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME LIDHUR ME ANKESËN.....	7
1. Nocioni i ankesës.....	7
2. Llojet e ankesave.....	9
3. Ankesa gjatë zhvillimit historik të procedurës penale.....	10
4. Ankesa sipas të drejtës zakonore penale shqiptare.....	13

KAPITULLI II

ANKESA KUNDËR AKTGJYKIMIT NË PROCEDURËN PENALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.....	16
1. Llojet e mjeteve juridike sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.....	16
2. Ankesa kundër aktgjykimit.....	17
3. Përmbajtja e ankesës kundër aktgjykimit.....	22
4. Arsyet për ushtrimin e ankesës ndaj aktgjykimit.....	28
4.1. Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale.....	31
4.2. Shkelja e ligjit penal.....	44
4.3. Vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike.....	50
4.4. Ankesa kundër aktgjykimit lidhur me vendimin mbi sanksionin penal dhe vendimeve tjera.....	55
5. Ankesa si mjet i rregullt juridik në praktikën e Gjykatës Themelore Gjilan dega në Viti për periudhën 2019-2022.....	60
5.1. Numri i rasteve të paraqitjes së ankesës në Gjykatën Themelore Gjilan dega në Viti për periudhën kohore 2019-2022.....	60

5.2. Dinamika e rasteve të paraqitjes së ankesës në Gjykatën Themelore Gjilan dega në Viti për periudhën kohore 2019-2022.....	61
5.3. Pesonat të cilët kanë paraqitur ankesë në Gjykatën Themelore Gjilan dega në Viti për periudhën kohore 2019-2022.....	62

KAPITULLI III

PROCEDURA SIPAS ANKESËS.....	63
1. Procedura për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit.....	63
2. Procedura lidhur me ankesën kundër aktgjykimit në gjykatën e apelit.....	65
2.1. Reformatio in Peius.....	68
2.2. Efekti shtesë i ankesës së paraqitur për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike ose shkeljes së ligjit penal.....	69
2.3. Beneficium Cohesionis.....	71
3. Vendimi i gjykatës së apelit lidhur me ankesën ndaj aktgjykimit të gjykatës themelore.....	72
4. Ankesa në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.....	74
5. Ankesa kundër aktvendimit.....	77
 Përfundimi.....	 80
Literatura.....	83

HYRJE

1. Objekti dhe interesi shkencor i studimit

Shtytës për hartimin e këtij punimi të masterit ka qënë dhe mbetet rëndësia jashtëzakonisht e madhe e kësaj teme, dëshira ime e veçantë për të ndikuar në forcimin e bindjes institucionale dhe të respektimit të ligjit në teori e në praktikë. Por, edhe qëllimi final për të dhënë një kontribut plus për ngritjen e standarteve ligjore të aplikuara në vendin tonë sa i përket ankesës si mjet i rregullt juridik kundër aktgjykimit në procedurën penale të Kosovës.

Edhe për kundër shumë garancive procedurale të parashikuara me ligjet e procedurës penale, të cilat kanë për qëllim konstatimin e të vërtetës materiale dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në veçanti të drejtave të të pandehurit, nuk përjashtohet mundësia që me aktgjykimin e shkallës së parë, të bëhet ndonjë gabim i natyrës faktike apo juridike. Sikur mos të ekzistonte mundësia e paraqitjes së ankesës kundër aktgjykimit, këto gabime të natyrës faktike apo juridike, nuk do të mund të evitoheshin, për arsye se gjykimi në shkallë të dytë, mund të vazhdohet vetëm nëse personat e autorizuar paraqesin ankesë kundër aktgjykimit. Prandaj, ankesa në një mënyrë paraqet mjet për evitimin e këtyre gabimeve, që mund të bëhen gjatë zhvillimit të procedurës penal.

Në këtë aspekt, nëpërmjet këtij punimi shpresojmë të aktualizojmë rëndësinë e paraqitjes së ankesës kundër aktgjykimit në procedurë penale. Qëllimi i hulumtimit dhe i trajtimit të kësaj teme, është njohja e shumë çështjeve tjera që kanë të bëjnë me ankesën kundër aktgjykimit në procedurë penale si në Kosovë.

Instituti procedural i ankimit ka lindur në kuadër të procedurës inkuizitore. Ai bazohej në të drejtën e perandorit për të ndërhyrë në veprimet e nëpunësve të tij. Lutja që i bëhet perandorit për të ndërhyrë në veprimet e nëpunësve të varur prej tij quhej *apellatio*, kështuqë apeli kuptonte të drejtën e subjektit procedural për të goditur vendimin e një gjyqtarit më të ulët përpara gjyqtarëve më të lartë. Më tutje çdo gjykatë më e lartë kishte të drejtë ta rishikonte çështjen duke dhënë një vendim të ri, veprimi procedural i gjykimit në dy shkallë i bazuar jo në varësinë e

gjyqtarit më të ulët nga ai më i lart sepse gjyqtarët varen vetëm nga ligji, por në dhënien e vendimeve sa më të mira.

Në nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është paraparë e drejta për ankimim efektiv, ku çdokush të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.

Përkundër garancive procedurale të parashikuara në procedurë të cilat kanë për qëllim gjetjen e së vërtetës, për kundër faktit se me aktgjykim synohet vërtetimi i gjendjes faktike ashtu siç është zhvilluar ngjarja me rastin e kryerjes së veprës penale, nuk përjashtohet mundësia që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë për shkaqe të ndryshme të jetë jo i drejt ose me atë të jetë shkelur ndonjë dispozitë ligjore.

2. Metodologjia e studimit

Për realizimin dhe finalizimin e këtij studimi janë zbatuar metodat bazë të studimeve empirike. Për interpretimin e rezultateve kërkimore dhe gjetjeve, u përdorën gjerësisht: metoda e analizës së të dhënave dhe fakteve, e sintezës, metoda e kërkimit doktrinar, metoda statistikore, metoda e referimit tek instrumentet ligjore, etj.

Kërkimi doktrinar përbën një tjetër hap në realizimin e këtij punimi, nëpërmjet të cilit është arritur identifikimi, mbledhja dhe sistemimi i librave, monografive, studime shkencore të autorëve dhe bashkautorëve specialistë të fushës së të drejtës procedurale penale.

Një metodë tjetër që ndjek hartimin e këtij punimi, është metoda e analizës së legjislacionit. Për të arritur realizimin sa më të plotë të objektivave që synohen të përmbushen në këtë punim, jemi mbështetur në metodën e analizës dhe sintezës, metodë kjo e cila konsiston në formulimin e problemeve ligjore nëpërmjet analizës së normativës që shqyrtohet.

Metodën krahasuese. Me anë të kësaj metode kanë dalë në pah risitë dhe përparësitë e objektit të studimit, si dhe përfundimet e bazuara në argumente bindës, po ashtu, edhe problematika në lidhje me objektin e studimit.

Metoda normative. Ku me anë të kësaj metode kam hulumtuar anën formale të normave dhe akteve juridike, duke u bazuar kryesisht në fuqinë e tyre juridike, duke studiuar përbërjen e ligjeve dhe rregulloreve si dhe lidhjet dhe raportet ndërmjet tyre.

Metodën interpretuese. Përmes kësaj metode është realizuar gërshetimi i metodave të mësipërme, duke arritur në konkluzione mbi atë se çfarë mund të përmirësohet nga pikëpamja legislative, por edhe zbatimi në praktikë të legjislacionit ekzistues.

3. Struktura e punimit

Punimi nis me vështrime të përgjithshme lidhur me ankesën si: nocioni i ankesës, llojet e ankesave, ankesa gjatë zhvillimit historik të procedurës penale dhe ankesa sipas të drejtës zakonore penale shqiptare.

Në kapitullin e dytë kemi trajtuar ankesën kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës si: llojet e mjeteve juridike sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, ankesa kundër aktgjykimit, përmbajtja e ankesës kundër aktgjykimit, arsyet për ushtrimin e ankesës ndaj aktgjykimit, shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale, shkelja e ligjit penal, vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike dhe ankesa kundër aktgjykimit lidhur me vendimin mbi sanksionin penal dhe vendimeve tjera, ankesa si mjet i rregullt juridik në praktikën e Gjykatës Themelore Gjilan dega në Viti për periudhën 2019-2022; numri i rasteve të paraqitjes së ankesës në Gjykatën Themelore Gjilan dega në Viti për periudhën kohore 2019-2022, dinamika e rasteve të paraqitjes së ankesës në Gjykatën Themelore Gjilan dega në Viti për periudhën kohore 2019-2022, dhe pesonat të cilët kanë paraqitur ankesë në Gjykatën Themelore Gjilan dega në Viti për periudhën kohore 2019-2022.

Në kapitullin e fundit kemi trajtuar procedurën sipas ankesës si: procedura për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit, procedura lidhur me ankesën kundër aktgjykimit në gjykatën e apelit, Reformatio in Peius, efekti shtesë i ankesës së paraqitur për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike ose shkeljes së ligjit penal, Beneficium Cohesionis, vendimi i gjykatës së apelit lidhur me ankesën ndaj aktgjykimit të gjykatës themelore, ankesa në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe ankesa kundër aktvendimit.

KAPITULLI I

VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME LIDHUR ME ANKESËN

1. Nocioni i ankesës

Në jetën e përditshme termi ankesë (apo “me u anku” në gjuhën popullore) nënkupton me shpreh paknaqësinë për ndonjë fenomen apo ngjarje. Ankesa, pra është shprehje paknaqësie e ndonjë personi për ndonjë gjendje apo për ndonjë ngjarje. Në anën tjetër, termi ankesë është një lloj reagimi i një personi apo i një grupi të personave kundër një vendimi apo veprimi të një personi tjetër.¹ Nga kjo shihet se ankesa, si nocion i përgjithshëm përbëhet nga dy anë apo nga dy faza: shprehja e paknaqësisë për ndonjë ngjarje apo vendim dhe reagimi i këtyre personave kundër këtyre ngjarjeve. Meqë marrëdhëniet juridike janë edhe marrëdhënie shoqërore, atëherë ankesës mund ti qasemi edhe nga aspekti juridik.

Në aspektin juridik ankesa është shprehje e paknaqësisë së personave të autorizuar dhe reagim i tyre kundër një vendimi të organit shtetëror në përgjithësi dhe gjykatave në veçanti. Ankesa, në përgjithësi ka një domethënie të gjerë, e cila në vete përmbanë të gjitha mjetet juridike të goditjes së vendimeve të organeve shtetërore.²

E drejta e paraqitjes së ankesës, si e drejtë themelore e njeriut, është e garantuar me kushtetutat e shteteve të ndryshme të botës. Kjo e drejtë është e garantuar dhe e paraparë edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila emërohet si E drejta për Mjete Juridike. Në këtë dispozitë kushtetuese është parashikuar se secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.³

Duke parë rëndësinë kaq të madhe të ankesës, ajo është e paraparë në të gjitha procedurat pranë organeve shtetërore, si psh., në procedurën penale, kontestimore, përmbarimore, administrative, etj. Ankesa kundër aktgjykimit në procedurë penale si objekt studimi dhe

¹ Alsula Ardita, Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë me praktikë gjyqësore, Tiranë, 2008, fq. 357.

² Afrim Shala, Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2010, fq. 22.

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 32.

shqyrtimi i këtij punimi, është një nocion më i ngushtë se sa ankesa në përgjithësi sim jet i rregullt juridik.⁴

Në procedurën penale, sikurse në procedurat tjera, edhe përkundër shumë garancive procedurale të parashikuara në procedurë penale, të cilat kanë për qëllim gjetjen e së vëretës, përkundër faktit se me aktgjykim synohet vërtetimi i drejtë i gjendjes faktike, nuk përjashtohet mundësia që aktgjykimi i shkallës së parë të jetë jo i drejtë ose me të të jetë shkelur ndonjë dispozitë ligjore.⁵ Me qëllim që të pengohet efekti juridik i këtyre aktgjykimeve, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës përmban një sistem të mjeteve të mbrojtjes procedurale, të cilat mund ti përdorin palët dhe personat e tjerë. Ato mjete procedurale janë mjetet juridike. Detyra e tyre është që në procedurën e kontrollit gjyqësor të evitojnë vendimin e gabuar apo që të sjellin deri te gjykimi i ligjshëm.⁶ Mjet juridik procedural është edhe ankesa kundër aktgjykimit në procedurë penale, qëllimi i së cilës në përgjithësi është evitimi i të metave që e kanë shoqëruar këtë procedurë.

Nocioni i ankesës kundër aktgjykimit nuk përcaktohet me KPPK-në. Edhe pse nuk është përcaktuar nocioni i ankesës kundër aktgjykimit, me KPPK janë paraparë disa elemente në bazë të të cilave mund të përcaktohet nocioni i ankesës, si psh., përmbajtja, forma, personat e autorizuar për paraqitjen e saj, bazat dhe afati për paraqitjen e ankesës, procedura e ankesës, etj. Duke i marrë për bazë këto elemente të ankesës kundër aktgjykimit në procedurë penale, të parapara me ligj, teoria e së drejtës së procedurës penale është përpjekur të përcaktoj edhe nocionin e saj. Kështu ankesa është një mjet i rregullt juridik i goditjes së vendimeve gjyqësore të cilat nuk e kanë marrë formën e prerë, për dallim nga mjetet e jashtëzakonshme juridike të cilat paraqiten kundër vendimeve gjyqësore të cilat e kanë marrë formën e prerë. Tipar i përbashkët i këtyre mjeteve, qofshin të rregullta apo të jashtëzakonshme është synimi për të marrë vendim të drejtë.⁷

Ankesa kundër aktgjykimit në procedurë penale është një mjet juridik i plotë, për arsye se mund të paraqitet nga të gjitha bazat juridike (shkeljet procedurale dhe materiale), ashtu edhe faktike.⁸

⁴ Islami, Halim, Hoxha, Artan, Panda, Ilir, Procedura penale, Tiranë, 2009, fq. 95.

⁵ Weaver, Russell L. - Abramson, Leslie W. - Bacigal, Ronald - Burkoff, John M. - Hancock, Catherine - Lively, Donald E., Criminal Procedure: Cases, Problems and Exercises, second edition, Weaver, 2003, fq. 203.

⁶ Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005, fq. 223.

⁷ Rexhep Murati, Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe provave të reja, Prishtinë, 2006, fq. 15.

⁸ Ligori, Henrik, Manual i procedurës penale për policinë gjyqësore, Korçë, 1999, fq. 47.

Në literaturën juridike, vlerësohet se ankesa kundër aktgjykimit është mjet juridik i dyanshëm, për arsye se gjykata para se të vendos për të, duhet që palës kundërshtare ti jepet mundësia që të deklarohej lidhur me thëniet dhe pretendimet të cilat i ka parashtuar ankuesi në ankesë.⁹

2. Llojet e ankesave

Varësisht se cili kriter mirret për bazë, në procedurë penale kemi ndarje të ndryshme të ankesave. Si kritere për klasifikimin e ankesave mund të merren lloji i vendimit që atakohet, numri i personave që e paraqesin ankesën, fakti se a paraqitet ankesa në dobi apo në dëm të të akuzuarit, lejueshmëria e ankesës, bazueshmëria e ankesës, etj.¹⁰

Kështu nëse mirret për bazë lloji i vendimit që atakohet, kemi ankesë kundër aktgjykimit, ankesë kundër aktvendimit dhe në disa raste të parashikuara kundër urdhërit. Sipas këtij kriteri, ankesa mund të ndahet edhe në ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së dytë.¹¹

Kriter tjetër me rëndësi për ndarjen e ankesave është edhe numri i personave që e kanë paraqitur ankesën. Duke e marrë për bazë këtë kriter, kemi ankesë individuale kundër aktgjykimit dhe ankesë kolektive kundër aktgjykimit. Ankesa individuale kundër aktgjykimit është ajo ankesë të cilën e paraqet një person, kurse ankesë kolektive kundër aktgjykimit është ajo ankesë të cilën e paraqesin dy ose më shumë persona. Ankesa kolektive kundër aktgjykimit ndryshe mund të quhet edhe si ankesë e përbashkët kundër aktgjykimit. Nuk konsiderohet ankesë kolektive kundër aktgjykimit, nëse disa persona ankohen veç e veç kundër aktgjykimit të njëjet.¹²

Ankesa kundër aktgjykimit në procedurë penale mund të paraqitet si në dëm ashtu edhe në dobi të të akuzuarit. Prandaj, duke u bazuar në këtë kriter në procedurë penale dallojmë ankesën kundër aktgjykimit në dëm të të akuzuarit dhe ankesën kundër aktgjykimit në dobi të të akuzuarit. Edhe pse nuk është thënë në mënyrë shprehimore me dispozitat e KPPK-së, i akuzuari nuk lejohet që të paraqesë ankesë në dëm të tij. Një gjë të tillë nuk mund ta bëjë as mbrojtësi i tij. Prokurori i Shtetit, si palë në procedurë mund të paraqesë ankesë kundër aktgjykimit si në dëm

⁹ Azem Hajdari, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2013, fq. 153.

¹⁰ Luarasi, Aleks, Kodi i procedurës penale me praktikë gjyqësore, botimi i parë, Tiranë, 2002, fq. 106.

¹¹ Afrim Shala, vep. e cit., fq. 29.

¹² Po aty.

ashtu edhe në dobi të të akuzuarit.¹³ Në praktikën gjyqësore, kemi konstatuar se në shumë raste kundër të njëjtit aktgjykim është paraqitur ankesë si në dëm ashtu edhe në dobi të të akuzuarit.

Ankesa kundër aktgjykimit në procedurë penale ndahet edhe në ankesë të plotë dhe jo të plotë. Ankesa konsiderohet e plotë nëse i përmban të gjitha elementet e parapara me ligj, në të kundërtën nëse ankesa nuk i përmban të gjitha elementet e parapara me ligj, konsiderohet se ankesa është jo e plotë. Përveç kriterëve të lartëpërmendura, ankesa mund të ndahet edhe në ankesë të lejuar dhe në ankesë të palejuar, në ankesë të bazuar dhe në ankesë të pabazuar, ankesë në formë të shkruar dhe në ankesë gojarisht e shënuar në procesverbal të gjykatës, etj.¹⁴

3. Ankesa gjatë zhvillimit historik të procedurës penale

Ankesa kundër aktgjykimit është një institut i procedurës penale. Prandaj, historia e zhvillimit të procedurës penale është në fakt edhe histori e zhvillimit të ankesës kundër aktgjykimit në këtë procedurë. Zhvillimi historik i procedurës penale i deritanishëm ka hedhur në dritë tri tipe-sisteme të kësaj procedure dhe atë: tipi akuzator (paditës), tipi inkuizitor(hetues) dhe tipi mikst (akuzator-inkuizitor).¹⁵ Çdo procedurë penale pa marr parasysh periudhën historike apo formacionin ekonomiko-shoqëror në të cilin është zbatuar, në essence i takon ndonjërit prej këtyre tri tipave themelore. Kalimi nga një tip në tipin tjetër ka qenë një proces i gjatë dhe në kuadër të një tipi gjenden elemente të tipit pasues apo edhe kur kalohet në tipin e ri gjithashtu hasim elemente të tipit të mëparshëm.¹⁶

- a) **Tipi akuzator i procedurës penale.-** Procedura akuzatore penale, si formë më e vjetër e procedurës penale, ka prejardhjen prej të drejtës orientale. Formën e vet më të përsosur e fiton në Greqi dhe në Romën e vjetër. Ky tip i procedurës penale ka vazhduar të zbatohet deri në shekullin XII-XIII, ku është zëvendësuar me tipin inkuizitor të procedurës penale.¹⁷ Tipi akuzator i procedurës penale zhvillohet në formë të kontestit ndërmejt dy palëve të barabarta- paditësit dhe të pandehurit. Funksionet themelore të procedurës

¹³ Kodi Nr. 04/L-123, i Procedurës Penale i Kosovës, neni 381 parag. 2.

¹⁴ Afrim Shala, vep. e cit., fq. 30.

¹⁵ Murati, Rexhep, Main Characteristics of the Judicial Criminal System in Kosovo, Deccenium Moztanicense, Rijeka, 2008, fq. 337-352.

¹⁶ Ejup Sahiti, vep. e cit., fq. 8.

¹⁷ Ejup Sahiti, vep. e cit., fq. 8-11.

penale janë të ndara ashtu që secilin funksion e ushtron nga një subject i posaçëm. Kështu funksionin e ndjekjes e ushtronte paditësi, funksionin e mbrojtjes e ushtronte i pandehuri, ndërsa atë të gjykimit e ushtronte gjykata. Paditësi ishte i obliguar që të ofroj prova të mjaftueshme para gjykatës, po që se dëshironte që ajo, sipas padisë së tij ta shpallë fajtor të pandehurin. Gjykimi ishte kontradiktor, ku edhe i pandehuri kishte mundësi të paraqiste prova dhe ti kundërvihet provave të palës kundërshtare. Gjykata përcillte gjykimin dhe në fund, duke i çmuar provat sipas bindjes së lirë, me shumicë votash merrte aktgjykimin.¹⁸ Me rëndësi është të theksohet se kundër aktgjykitimit të marrë nga gjykata, në këtë tip të procedurës penale, palët nuk kishin të drejtë që të ankoheshin. Pra, procedura penale akuzatore nuk e ka njohur parimin e shumëshkallëshmërisë së gjykitimit të një çështje penale. Procedura penale përfundohej qysh në shkallë të parë dhe kundër vendimit të marrë nuk ishte e lejuar paraqitja e ankesës.¹⁹ Në procedurën penale të Perandorisë Romake, ka qenë e njohur një lloj i ankesës kundër aktgjykitimit, i emëruar “appellation”. Mirëpo edhe përkundër kësaj, instituti i ankesës kundër aktgjykitimit, në kuptimin e sotëm, është paraqitur më vonë tek te tipi inkuizitor i procedurës penale.²⁰

- b) **Tipi inkuizitor i procedurës penale.**- Pa rënies së Republikës Romake, perandorët romakë apo monarkët absolute të mesjetës, koncentruan në duart e veta të gjitha funksionet shtetërore të cilat i ushtronin përmes nëpunësve të vet. Kështu edhe gjyqësia më nuk ushtrohet nga gjyqtarët laikë, siç veprohej në procedurën akuzatore, por nga gjyqtarët profesionalë të përgatitur enkas për këtë qëllim.²¹ Tipi inkuizitor i procedurës penale ka filluar të zbatohet prej shekullit XII-XIII. Në këtë tip të procedurës penale më nuk ekzistojnë palët, përballë të pandehurit më nuk qëndron paditësi privat, por inkuirenti-hetuesi, në duart e të cilit janë përqendruar të tri funksionet themelore të procedurës penale. I pandehuri konsiderohet objekt ndaj të cilit zhvillohet procedura penale. Meqë të tria funksionet ishin përqendruar në duart e inkuirentit, ai nuk ishte në gjendje që ti ushtronte këto funksione në nivelin e duhur.²² Tipi inkuizitor i procedurës penale, karakterizohet nga këto cilësi: ndjekja e veprës penale ndërmaerret kryesisht,

¹⁸ Po aty, fq. 9.

¹⁹ Murati, Rexhep, Protection of Human Rights Under Kosovo's Criminal Code and Criminal Procedure Code, Chicago-Kent Law Review, Volume 80, Number 1, 2005.

²⁰ Afrim Shala, vep. e cit., fq. 33.

²¹ Ejup Sahiti, vep. e cit., fq. 11.

²² Po aty.

organi hetues në punën e vetë është i pavarur, funksionet themelore të procedurës penale (ndjekjes, mbrojtjes dhe të gjykimit) janë të bashkuara në një subjekt dhe në procedurë nuk ka palë, i pandehuri nuk kishte kurrfarë të drejtash, përveç atyre të cilat ia jep inkuvirenti-hetuesi.²³ Procedura penale zhvillohet nëpër dy stadi- stadin e hetimeve dhe atë të gjykimit. Procedura zhvillohet me detyrë të mbyllura. Gjithë rrjedha e procedurës shënohet në procesverbal, e pastaj të gjitha këto procesverbale i dërgoheshin kolegjit gjyqësor për të vendosur. Kolegji vendoste vetëm në bazë të shkresave dhe vllente parimi “quod non est in actis, non est id mundo” (çka nuk është në shkresa nuk ekziston. Në fund gjykata merrte aktgjykimin. Aktgjykimi i marrë në këtë tip të procedurës penale mund të sulmohej me ankesë.²⁴ Shumica e teoricientëve të procedurës penale mendojnë se ankesa në kuptimin e plotë të fjalës, për herë të parë është paraqitur në këtë tip të procedurës penale. Në këtë mënyrë ky institut procedural ka lindur në mesjetë, në periudhën e monarkisë, kur gjyqëtarët u bënë nëpunës të aparatit shtetëror. Ky institut, bazohej në të drejtën e perandorit për të ndërhyrë në veprimet e nëpunësve të tij. Lutja që i drejtohet perandorit për të ndërhyrë në veprimet e nëpunësve të varur prej tij quhej “apellatio”, dmth., apel që kishte kuptimin e të drejtuarit diku me fjalë për të goditur vendimin e një gjyqtari më të ulët përpara gjyqëtarëve më të lartë.²⁵ Çdo gjykatë më e lartë kishte të drejtë ta rishikonte çështjen, duke dhënë një vendim të ri. Në këtë mënyrë lutja që i bëhet perandorit për të ndërhyrë në vendimet e gjyqtarit, shërbente për shqyrtimin e çështjes nga një autoritet më i lartë dhe u bë mjet i rëndësishëm për formimin e së drejtës.²⁶ Nga kjo që u tha më lartë mund të konstatojmë, se ankesa, si institut i procedurës penale ka lindur në këtë tip të procedurës penale dhe ka shërbyer sim jet për kontrollimin e vendimeve të organeve më të ulta nga organet më të larta shtetërore.

- c) **Tipi mikst (i përzier) i procedurës penale.**- Tipi mikst i procedurës penale ndryshe emërtohet edhe si tipi bashkëkohor i procedurës penale. Quhet tip mikst apo i përzier i procedurës penale, sepse në vete ngërthen elemente pozitive të tipeve të mëparshme të procedurës penale. Ky tip i procedurës penale fillon të aplikohet nëpër shtete të Evropës,

²³ Azem Hajdari, vep. e cit., fq. 21.

²⁴ Ejup Sahiti, vep. e cit., fq. 13.

²⁵ Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, Procedura penale, komentar, Tiranë, 2003, fq. 525.

²⁶ Po aty.

që nga fundi i shekullit XVIII. Tipi mikst i procedurës penale ka formën e procedurës kontradiktore.²⁷ Në të i pandehuri prap e fiton cilësinë e subjektit procedural me të drejta dhe obligime të caktuara. Funksionet themelore të procedurës janë të ndara dhe ushtrohen nga subjekte të veçanta. Gjykimi zhvillohet në dy faza: në fazën e hetimit dhe atë të gjykit. Faza e hetimit, parimisht zhvillohet me mbështetje në elementet të procedurës penale inkuizitore, kurse ajo e gjykit parimisht mbështetet në elementet e procedurës akuzatore, si psh., parimi i publicitetit, parimi i drejtëpërdrejtë, kontradiktor, etj. Në këtë tip të procedurës penale është bërë përpjekje që dy tendencat antagoniste-tendenca e efikasitetit të procedurës penale dhe tendenca e ruajtjes së lirive të qytetarëve sa më tepër të harmonizohen.²⁸ I pandehuri si palë në procedurë ka një numër të madh të të drejtave të njohura si me akte juridike kombëtare të shteteve, ashtu edhe me aktet juridike ndërkombëtare. Në tipin mikst- të përzier të procedurës penale, përveç të drejtave të tjera, të parapara me ligj, i pandehuri ka të drejtë edhe të paraqesë ankesë kundër aktgjykit të gjykatës së shkallës së parë, e në disa raste edhe kundër aktgjykit të gjykatës së shkallës së dytë.²⁹ Mbrojtësi i të pandehurit, mund të paraqesë ankesë kundër aktgjykit pa autorizim të veçantë të të pandehurit, por jo edhe kundër vullnetit të tij, përveç kur të pandehurit i shqiptohet dinimi me burgim afatgjatë. Të drejtë që të paraqesë ankesë kundër aktgjykit ka edhe prokurori i shtetit, pastaj i dëmtuari dhe personat tjerë të përcaktuar me ligj. Afati për paraqitjen e ankesës, forma, përmbajtja, personat e autorizuar, procedura e ankesës, etj., janë të rregulluara me ligjet e procedurës penale të shteteve të ndryshme.³⁰

4. Ankesa sipas të drejtës zakonore penale shqiptare

E drejta zakonore shqiptare³¹ është tërësi e normave të pashkruara të sjelljes, me të cilat rregullohen marrëdhëniet shoqërore. Ajo shpreh zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore

²⁷ Murati, Rexhep, Protection of Human Rights Under Kosovo's Criminal Code and Criminal Procedure Code, Chicago-Kent Law Review, Volume 80, Number 1, 2005.

²⁸ Rexhep Murati, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2022, fq. 35.

²⁹ Murati, Rexhep, Efikasiteti i procedurës penale dhe mbrojtja e të drejtave dhe e lirive të të pandehurit në procedurën penale, ED, 1996, nr. 3, Prishtinë

³⁰ Afrim Shala, vep. e cit., fq. 38.

³¹ E drejta zakonore shqiptare është tërësia e normave të pashkruara (rregullave të sjelljes) të vendosura ad hoc nga gjykata e pleqve apo kuvendet për rregullimin e marrëdhënieve shoqërore në fusha të ndryshme të jetës, zbatimi i të

ekonomike shumëvjeqare në kushtet e rregullimit fisnor nëpër të cilat ka kaluar populli shqiptar i rajoneve malore. Mosekzistimi i pushtetit qendror, ka mundësuar krijimin e rregullave të sjelljes-normave zakonore me të cilat është plotësuar zbarastira në lëmin e rregullimit juridik. E drejta zakonore shqiptare, në përgjithësi dhe e drejta zakonore penale në veçanti, është e përmbledhur në kanune, të cilat njëherit edhe konsiderohen si burime kryesore të saj. Kanunet më të rëndësishme të së drejtës zakonore shqiptare janë: Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Skenderbeut, Kanuni i Malësisë, Kanuni i Labërisë dhe kanunet e tjera lokale. Me këto kanune rregullohen çështjet nga sfera e të drejtës penale, procedurës gjyqësore, të drejtës civile, trashëgimore, familjare, etj.

Kanunet, si burime të së drejtës zakonore shqiptare përmbajnë edhe norma me të cilat rregullohet procedura në çështjet penale. Sipas kanunit të Lekë Dukagjinit, si burim kryesor i së drejtës zakonore shqiptare, procedura penale zhvillohet para pleqnisë, si organ gjyqësor. Pleqninë, si organ të posaçm gjyqësor e përbëjnë të parët e fiseve, bajraktarët ose njerëzit e pjekur dhe personat e shkathtë-pleqë të cilët në mesin e tyre gëzonin famën e njerëzve të mençur, të ndershëm dhe të urtë. Shikuar juridikisht gratë dhe të rinjët nuk mund të pleqnojnë. Përbërjen e pleqnisë e përcaktojnë palët.³² Me qëllim që puna të shkonte normalisht, për çdo rast pleqnia nga radhët e veta e zgjedh një pleqnar për kryepleqnar, i cili në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues e udhëheqë gjykimin. Procedura të cilën e zhvillon pleqnia i përgjigjet procedurës akuzatore. Ajo sipas rregullit, fillon me shqyrtimin gjyqësor publik. Në shqyrtimin gjyqësor pleqnia duke u mbështetur në parimin gojor, dëgjon paditësin, pyet të akuzuarin dhe merr e analizon provat e tjera, ku pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor merr dhe ua komunikon vendimin palëve. Kundër vendimit (gojor) palët nuk kishin të drejtë që të ankoreshin.

Normat e së drejtës zakonore shqiptare duke ju përmbajtur karakteristikave themelore të tipit akuzues të procedurës penale nuk e njohin institutitn e ankimit të vendimeve.³³ Në Kanunin e Lekë Dukagjinit janë parashikuar këto parime: plak mbi plak, gjyq mbi gjyq e be mbi be kanuja nuk ban (neni 1002), po sta mbushi mendjen gjyqi i pleqve, që ti zgjodhe tager ske me sterrmarrun pengun tand e as me zgjedh pleq tjerë (neni 1037).³⁴ Nga kjo mund të konstatojmë se

cilave sigurohet nga forcat e traditës, opinionit shoqëror dhe nga autoriteti patriarkal i organizmave të vetëqeverisjes së popullit. Ajo është krijuar nga populli gjatë shekujve dhe jo nga një person i caktuar apo organ legjislativ i posaçëm. Ismet Elezi, Njohuri për të drejtën zakonore mbarë shqiptare, Prishtinë, 2003, fq. 10

³² Koço Nova, Zhvillimi historik i gjykimin në Shqipëri, Tiranë, 1965, fq. 74.

³³ K. Krisafi, etj, Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri, Tiranë, 2001, fq. 285.

³⁴ Shtjefën Gjeçovi, vepra 1 Kanuni i Lekë Dukagjinit, Rilindja, Prishtinë, 1985, fq. 285.

Kanuni i Lekë Dukagjinit, njihje vetëm një instance gjyqësore dmth., nuk e njihje gjykimin në shkallë të dytë. Të njëjtat parime i gjejmë edhe në Kanunin e Labërisë.³⁵ Pra, palët nuk kishin mundësi që të kundërshtonin vendimin të cilin e merrte pleqnia. Vendimet e pleqënisë ishin të formës së prerë dhe mbi të nuk ekzistonte ndonjë instance tjetër gjyqësore ku mund të ankohej. E drejta zakonore penale shqiptare nuk e njihje parimin e shumëshkallshmërisë së gjykimit të çështjeve penale. I tërë gjykimi zhvillohej në një instance dhe kundër vendimit të marrë nga pleqnia nuk lejohej paraqitja e ankesës. Rregullat kanunore megjithatë parashikonin mundësinë e ankimit kundër vendimit nga ana e gjyqbjerësit vetëm kur ky i fundit pretendonte se pleqtë kishin dhënë një vendim qëllimisht të padrejtë, dmth., kishin shpërdorur detyrën e gjyqtarit të paanshëm. Kjo do të thotë se nuk lejohej rishikimi i vendimit të pleqve për arsye se ata kishin gabuar. Ankimi bëhej vetëm për shkelje të rregullit parimor të kanunit, se gjyqi i pleqve duhej të ishte i paanshëm dhe në mirëbesim, i pa korruptueshëm.³⁶ Pra, kundër vendimit të pleqve mund të paraqisnin ankesë vetë gjyqbjerësit, nëse konstatojnë se vendimi i marrë nga ana e tyre ishte qëllimisht i padrejtë. Duke u nisur nga parimi i paanshmërisë së gjyqtarëve (pleqve) në zgjidhjen e çështjeve të caktuara, e drejta zakonore penale shqiptare, i mbronte palët nga gjykimi joobjektiv dhe i njëanëshëm.

Nga gjitha këto që u thanë më lartë mund të konstatojmë se e drejta zakonore penale shqiptare, nuk ia njihje palëve, paditësit dhe të pandehurit të drejtën që të paraqesin ankesë kundër vendimit të pleqënisë. Ankimi mund të bëhej vetëm në raste të veçanta dhe atë nga vetë pleqtë nëse ata më vonë konstatojnë se gjykimi ka qenë qëllimisht i njëanëshëm dhe i padrejtë. Ky vështim i shkurtër historik i ankesës kundër aktgjykimit është me interes të veçantë, sepse nuk mund të njihet në mënyrë thelbësore një institut i së drejtës së procedurës penale, pa e njohur historikun dhe evolucionin e këtij instituti, respektivisht të ankesës kundër aktgjykimit në procedurë penale.

³⁵ K. Krisafi, etj, vep. e cit., fq. 286.

³⁶ Po aty.

KPAITULLI II

ANKESA KUNDËR AKTGJYKIMIT NË PROCEDURËN PENALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1. Llojet e mjeteve juridike sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës ka përcaktuar se përveç rasteve kur parashihet ndryshe me këtë Kod, pala mund të paraqesë mjetin juridik në gjykatën e shkallës drejtpërdrejtë më të lartë përmes:

- Ankesës kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit;
- Ankesës kundër aktgjykimi të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme të Kosovës sipas paragrafit 1 të nenit 407, ose kur me aktgjykim shqiptohet dënimi me burgim të përjetshëm;
- Ankesës kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit;
- Kërkesës për mjetin e jashtëzakonshëm juridik nga Gjykata Themelore apo Gjykata e Apelit në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Kur lejohet me këtë Kod, urdhri i gjyqtarit të procedurës paraprake mund të shqyrtohet nga kolegji i përbërë prej tre gjyqtarëve të gjykatës themelore. Urdhri i shqyrtuar nga kolegji shqyrtues nga ky paragraf mund të shqyrtohet nga Gjykata e Apelit apo Gjykata Supreme vetëm me rastin e ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës themelore.³⁷

Dispozita e paragrafit 1 të këtij neni shpreh karakterin devolutiv të mjetit juridik - ankesës dhe kërkesës (për mjet të jashtëzakonshëm juridik), ndonëse karakteri devolutiv i ankesës në mënyrë indirekte kuptohet edhe nga nenet 388, 389 dhe 407, kurse për mjet të jashtëzakonshëm nga nenet 431 dhe 435. Sipas dispozitës së paragrafit 1 pala mund të paraqesë ankesën nëpërmjet gjykatës që ka marrë aktgjykimin të cilin e atakon me ankesë, drejtpërdrejtë, në gjykatën më të lartë. Kështu, ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore paraqitet për Gjykatën e Apelit;

³⁷ Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Kosovës, neni 374.

ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit paraqitet për Gjykatën Supreme të Kosovës. Ankesa kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore paraqitet për Gjykatën e Apelit.³⁸

Nga paragrafi 1, nënparagrafi 1.4., po të interpretohej si dispozitë e izoluar, do të mund të konkludohet se për kërkesë të paraqitur për mjet të jashtëzakonshëm juridik vendosë Gjykata Supreme e Kosovës. Konkludimi i tillë vlen për sa i përket Kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit dhe për Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, por jo edhe për sa i përket Kërkesës për rishikim të procedurës penale. Kërkesa për rishikim të procedurës penale paraqitet për shkak të lajthimeve të natyrës faktike, andaj për të vendosë gjykata e cila e ka marrë aktgjykimin e formës së prerë (neni 427, paragrafi 3). Sipas nenit 24 të Kodit të procedurës penale, gjyqtari i procedurës paraprake në departamentin e përgjithshëm apo departamentin për krime të rënda mund të nxjerr vendime apo urdhra. Vendimet e gjyqtarit të procedurës paraprake, në bazë të ankesës mund të shqyrtohen në Gjykatë të Apelit. Mirëpo, kur pala e kundërshton urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake, kundërshtimi mund të shqyrtohet nga kolegji shqyrtues i të njëjtit departament. Afati për paraqitje të kundërshtimit është dyzetë tetë orë, ndërsa për ankesë pesë ditë nga momenti kur pala pranon urdhrin apo vendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake. Sipas paragrafit 2 të nenit 374 urdhri i gjyqtarit të procedurës paraprake mund të shqyrtohet nga kolegji shqyrtues të gjykatës themelore. Urdhri i shqyrtuar nga kolegji shqyrtues i gjykatës themelore mund të shqyrtohet nga Gjykata e Apelit apo Gjykata Supreme vetëm me rastin e ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës themelore.³⁹

2. Ankesa kundër aktgjykimit

Kundër aktgjykimit të marrë në nga gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues i gjykatës themelore, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa e personit të autorizuar e paraqitur brenda afatit të caktuar e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit.⁴⁰ Sipas paragrafi 1 të këtij neni kundër aktgjykimit të marrë nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i gjykatës themelore, ankesë mund të paraqesin bartësit e të drejtës në ankesë, brenda afatit prej

³⁸ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, Komentari Kodi i Procedurës, Prishtinë, 2014, fq. 872.

³⁹ Po aty, fq. 873.

⁴⁰ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 380.

pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ky afat i ankesës është prekluziv çka do të thotë se në një anë nuk mund të zgjatet dhe në anën tjetër me skadimin e tij, personi i cili ka lëshuar këtë afat nuk mund të paraqesë ankesë kundër aktgjykimit. Megjithatë, KPP lejon mundësinë e sanimit të kësaj pasoje procedurale, duke i lejuar paraqitjen e ankesës vetëm të pandehurit (neni 447).⁴¹ Në dispozitën e nenit 380, paragrafi 2 përcaktohet që ankesa e personit të autorizuar e paraqitur në afat e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit. Rrjedhimisht, ankesa e paraqitur në afat kundër aktgjykimit nga personat e autorizuar, e shtynë ekzekutimin e aktgjykimit derisa gjykata e shkallës së Apelit nuk vendos lidhur me ankesën kundër aktgjykimit. Ankesa e paraqitur jashtë afatit të ankesës dhe ankesa e paraqitur nga personi i paautorizuar nuk e shtynë ekzekutimin e aktgjykimit.⁴²

Kodi i Procedurës Penale i Kosovës i ka përaktuar personat e autorizuar për të paraqitur ankesë kundër aktgjykimit. Sipas tij ankesë mund të paraqesin:

- Prokurori i shtetit, i akuzuari, mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit dhe i dëmtuari;
- Prokurori i shtetit mund të paraqesë ankesë në dëm dhe në dobi të të akuzuarit;
- I dëmtuari mund të ushtrojë ankesë ndaj aktgjykimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale;
- Ankesë mund të paraqesë edhe personi, pasuria e të cilit është konfiskuar ose nga i cili është konfiskuar dobia pasurore e fituar me vepër penale, si dhe personi juridik, pasuria e të cilit është konfiskuar.⁴³

Me dispozitat e nenit 381, paragrafi 1, përcaktohen decidivisht bartësit e të drejtës në ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Sipas kësaj dispozite, bartës të drejtës në ankesë kundër aktgjykimit janë: prokurori i shtetit, i akuzuari, mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit dhe i dëmtuari. Me rastin e përcaktimit të subjekteve në fjalë, ligjdhënësi ka marr parasysh dy kritere: a) pozitën procedurale të çdo subjekti dhe b) interesin e drejtpërdrejtë juridik të subjektit për të parashtruar ankesë kundër aktgjykimit i cili nuk ka marrë formën e prerë. Kjo

⁴¹ Afrim Shala, vep. e cit., fq. 86.

⁴² Dragoljub Dimitrijeviq, E drejta e procedurës penale, (botim shqip), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të KSAK, Prishtinë, 1976, fq. 183.

⁴³ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 381.

do të thotë se çdo njëri nga këta subjekt të ankesës mund ta atakojë aktgjykimin ose ndonjë vendim në kuadër të aktgjykimit (p.sh. vendimin mbi fajësinë, vendimin mbi sanksionin penal, shpenzimet e procedurës penale etj.) vetëm në ato raste kur subjekti përkatës ka interes të drejtpërdrejtë juridik.⁴⁴ Me fjalë tjera, çdo subjekt i ankesës mund ta atakojë aktgjykimin vetëm nëse me të i është shkelur ndonjë interes juridik i drejtpërdrejtë i tij por jo edhe në dobi të interesit juridik të palës kundërshtare. Nëse eventualisht bartësi i të drejtës në ankesë e atakon aktgjykimin në interes të palës kundërshtare, kjo do ta cenonte para se gjithash të drejtën e palës kundërshtare për të vlerësuar vet nëse aktgjykimi është në dëm të saj dhe nëse do të parashtronte fare ankesë kundër aktgjykimit. Prandaj për këto arsye, ankesa e tillë është e palejuar dhe duhet hedhur me aktvendim.⁴⁵ Përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit mund të paraqesë ankesë në dobi të akuzuarit.

KPP nuk përmban asnjë dispozitë të veçantë me të cilën parashikohet e drejta në ankesë kundër aktgjykim lirues por ankesa e tillë nuk përjashtohet shprehimisht. Prandaj nuk përjashtohet mundësia e paraqitjes së ankesës nga i akuzuari edhe kundër aktgjykimit lirues. Por sikurse të çdo ankesë edhe për paraqitje të ankesës nga i akuzuari ndaj aktgjykimit lirues, kusht themelor është që me aktgjykimin lirues të jetë cenuar interesi juridik i drejtpërdrejtë i të akuzuarit. Kjo për arsye se me KPP mbrohet interesi juridik i drejtpërdrejtë i çdo bartësi të ankesës, duke përfshirë edhe të akuzuarin. Sipas nenit 364 të KPP-së gjykata e liron të akuzuarin nga akuza nga tri baza.⁴⁶ Dy bazat e para janë të karakterit juridik, ndërkaq baza e tretë është e karakterit faktik. Baza e tretë, nga neni 364, paragrafi 3 - ngase nuk është provuar se i akuzuari ka kryer verën penale për të cilën akuzohet është më e volitshme se baza nga paragrafi 2- se vepra penale për të cilën i akuzuari akuzohet nuk është vepër penale dhe baza nga paragrafi 2 - se ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale. Prandaj, kur aktgjykimi lirues mbështet në bazën juridike p.sh. se i akuzuari ka vepruar në mbrojtje të nevojshme ose se ka qenë i papërgjegjshëm penalisht,⁴⁷ i pandehuri ka interes të drejtpërdrejtë juridik për të atakuar aktgjykimin lirues nga baza faktike p.sh. se i akuzuari nuk e ka kryer fare veprën penale.⁴⁸

⁴⁴ Maksim Haxhia, Komentari i Kodit Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1997, fq. 224.

⁴⁵ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 400.

⁴⁶ Bashkim Hyseni, Albert Zogaj, Fejzullah Hasani, Doracak i gjyqtarve për shkrim dhe arsyetim ligjor, Prishtinë, 2017, fq. 126.

⁴⁷ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 364 parag. 1 dhe 2.

⁴⁸ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 364 parag. 3.

Interes i drejtpërdrejt juridik i të akuzuarit për të kërkuar lirim nga akuza nga baza faktike e jo nga dy bazat të tjera juridike gjen mbështetjen edhe në dispozitën e nenit 472 paragrafi 2, sipas së cilës me rastin e vendosjes për çështjen kryesore, gjykata së pari vendos nëse i akuzuari ka kryer veprën penale. Mirëpo, vetëm nëse i akuzuari nuk lirohet nga kjo bazë, atëherë vinë në shprehje dy bazat të tjera. Me rastin e marrjes së aktgjykimit lirues gjykata duhet të respektojë radhën e përcaktimit të bazave për shqiptimin e aktgjykimit lirues. Për më tepër, shkelja nga ana e gjykatës e radhës përkatëse të përcaktimit të bazave të aktgjykimit, përbën shkelje esenciale relative e dispozitave të procedurës penale.⁴⁹ Mirëpo, i akuzuari nuk mund të paraqesë ankesë në dëm të tij ngase ankesa e tij është në kundërshtim me pozitën e të akuzuarit lidhur me funksionin e mbrojtjes të cilin e realizon në procedurën penale.

Kështu, nuk është e lejuar ankesa e të akuzuarit me të cilën kërkohet ndryshimi i aktgjykimit lirues në aktgjykim dënues, ose ndryshimi i aktgjykimit dënues në aktgjykim dënues me dënim më të rëndë i cili për arsye personale mund të jetë me i volitshëm për të akuzuarin p.sh. dënim më burgim në vend të dënimit me të holla, dënim me burgim në vend të dënimit me kusht etj. Po ashtu, i akuzuari nuk ka të drejtë për ankesë ndaj aktgjykimit refuzues, i cili është marr për shkak të tërheqjes së prokurorit të shtetit. Megjithatë, ndaj aktgjykimit refuzues i akuzuari mund të paraqes ankesë p.sh. në rastet kur me aktgjykim është refuzuar akuza në vend se të shqiptohet aktgjykimi lirues.⁵⁰ Po ashtu i akuzuari mund të paraqes ankesë ndaj aktgjykimit refuzues me të cilën kërkon që një bazë e refuzimit të akuzës p.sh. parashkrimi të zëvendësohet me bazën tjetër p.sh. çështjen e gjykuar). I akuzuari dhe mbrojtësi i tij, mund ta atakojnë aktgjykimin për shkak të vendimit mbi kërkesën pasurore juridike. Me fjalë të tjera, ankesa e të akuzuarit nuk përjashton ankesën e mbrojtësit ose e më shumë mbrojtësve.⁵¹

Prokurori i shtetit është paditës i autorizuar për veprat penale që kryesisht ndiqen. Ai në procedurën penale, ka rol të dyfishtë, përkatësisht është palë dhe organ shtetëror. Cilësia e të qenit organ shtetëror e detyron prokurorin, gjykatën dhe policinë për të vërtetuar faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të drejt dhe të ligjshëm.⁵² Përveç kësaj, prokurori i shtetit dhe policia detyrohen që më vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional të vërtetojnë edhe

⁴⁹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 384 parag. 2.

⁵⁰ Burim Ademi, Afrim Shala, Avni Mehmeti, Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional (Penale-materiale dhe procedurale), Prishtinë, 2021, fq. 518.

⁵¹ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 880.

⁵² Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 7 parag. 1.

faktet kundër të pandehurit po ashtu edhe ato në favor të tij.⁵³ Nga cilësia e të qenit organ shtetëror i cili vepron në dobi të shqyrtimit objektiv të çështjes penale, buron njëherësh e drejta e prokurorit të shtetit në ankesë në dëm dhe në dobi të akuzuarit. Prokurori i shtetit është i autorizuar të paraqesë ankesë pa marrë para sysh së aktgjykimi i marrë nga gjykata është në përputhje me propozimin e prokurorit të shtetit. Për më tepër, prokurori i shtetit mund të atakojë aktgjykimin refuzues i cili është marr për shkak të tërheqjes së tij nga akuza. I pandehuri nuk mund ta pengojë prokurorin e shtetit për të parashtruar ankesë në dobi të tij ngase prokurori i shtetit në procedurën penale nuk vepron në emër të të pandehurit por vepron në mënyrë të pavarur dhe në interes të përgjithshëm.⁵⁴ Ankesë mund të paraqes edhe prokurori i shtetit siç u cek më lartë. Po ashtu, prokurori më i lartë i shtetit mund të tërhiqet nga ankesa e paraqitur nga prokurori më i ulët i shtetit. Prokurori më i lartë i shtetit mund të ushtrojë ankesë vetëm me kusht që prokurori më i ulët i shtetit nuk ka hequr dorë nga ankesa, përkatësisht nuk është tërhequr nga ankesa e paraqitur. Prokurori i shtetit nuk mund të ushtrojë ankesë kundër vendimit mbi kërkesën pasurore juridike, sikurse që nuk mund të paraqesë propozim për realizimin e kërkesës pasurore juridike.⁵⁵ Në praktikën gjyqësore është konsideruar se është në kundërshtim me ligjin që prokurorit të shtetit t'i lejohet e drejta në ankesë kundër vendimit mbi kërkesën pasurore juridike, ndërkaj të dëmtuarit t'i mohohet kjo e drejtë. (GjSKr. AP. nr. 2330/56). Qëndrimi sipas të cilit, prokurorit të shtetit nuk duhet lejuar të drejtën për ankesë kundër vendimit mbi kërkesën pasurore juridike gjën mbështetjen në faktin se prokurori i shtetit në procedurën penale i realizon interesat e përcaktuara me të drejtën penale.⁵⁶

Me dispozitën e paragrafit 3 të këtij neni, rregullohet e drejta për ankesë e të dëmtuarit të thjeshtë, patribute të tjera. Kështu, sa i përket të dëmtuarit, me këtë dispozite të KPP është zgjeruar e drejta për ankesë ndaj aktgjykimit në krahasim me Ligjin e mëparshëm të procedurës penale i cili është zbatuar pas luftës në Kosovë, deri me nxjerrjen e Kodit të përkohshëm të procedurës penale. Në të vërtetë, i dëmtuari, përveç ankesës kundër aktgjykimit lidhur me shpenzimet e procedurës penale ka të drejtë të paraqes ankesë ndaj aktgjykimit edhe lidhur me sanksionet penale por duke u përkufizuar vetëm në ankesë për veprat penale kundër jetës dhe

⁵³ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 7 parag. 2.

⁵⁴ Azem Hajdari, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2009, fq. 605.

⁵⁵ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 459 parag. 2.

⁵⁶ Rexhep Murati, vep. e cit., fq. 159.

trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurimit të trafikut publik.⁵⁷ Gjykata me aktgjykim, sipas Kodit Penal, mund t'ju shqiptojë personave të tjerë fizikë dhe juridikë masa për konfiskim të pasurisë ose të dobisë pasurore. Me dispozitën e paragrafit 4 të këtij neni, përcaktohen bartësit të tjerë të drejtës në ankesë siç janë: personi, pasuria e të cilit është konfiskuar⁵⁸ ose nga i cili është konfiskuar dobia pasurore e fituar me vepër penale⁵⁹ si dhe personi juridik, pasuria e të cilit është konfiskuar.⁶⁰ Këta persona mund të parashtrojnë ankesë të kufizuar kundër aktgjykimit, përkatësisht aktgjykimit të limituar (vetëm lidhur me vendimet në fjalë) dhe jo ankesë nga të gjitha bazat. Kështu, me rastin e marrjes së dobisë pasurore p.sh. personi të cilit i është marrë dobia pasurore mund të theksojë se nuk ka realizuar fare dobi pasurore ose se ajo nuk ka qenë aq sa i është ngarkuar me aktgjykim.

3. Përmbajtja e ankesës kundër aktgjykimit

Kodi i Procedurës Penale i Kosovës ka përcaktuar se ankesa kundër aktgjykimit duhet të jetë në pajtim me nenin 376 të këtij Kodi por përfshinë edhe:

- të dhënat mbi aktgjykimin i cili ankimohet;
- arsyet për kundërshtimin e aktgjykimit nga neni 383 i Kodit;
- propozimin për anulim të tërësishëm apo të pjesërisht të aktgjykimit ose për ndryshim të tij; dhe nënshkrimin e ankuesit.

Kur ankesën e paraqet i akuzuari ose i dëmtuari i cili nuk përfaqësohet nga mbrojtësi, dhe ankesa nuk është përpiluar në pajtim me dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues kërkon nga ankuesi që në afat të caktuar të ndryshojë ankesën me parashtrësën me shkrim. Nëse ankuesi nuk e përmbush kërkesën e tillë, ndërsa ankesa nuk përfshin informatat nga neni 376 të këtij Kodi ose paragrafi 1. i këtij neni, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e hudh ankesën nëse të dhënat nuk mund të zbulohen lehtë. Në ankesë mund të paraqiten fakte dhe prova të reja, por ankuesi detyrohet të arsyetojë

⁵⁷ Afrim Shala, Kompetencat e gjyqtarit të procedurës paraprake sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Revista "Justicia", Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, 2009, fq. 224.

⁵⁸ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 69 parag. 2.

⁵⁹ Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Kosovës, neni 97 parag. 2.

⁶⁰ Kodi Penal i Kosovës, neni 99.

përse ato nuk i ka paraqitur më parë.⁶¹ Kur ankuesi thirret në fakte të reja, ai detyrohet të paraqesë prova me të cilat këto fakte mund të provohen, e kur u referohet provave të reja, detyrohet të paraqesë faktet që ai synon t'i vërtetojë me to. Kur ankuesi pretendon në ankesë arsye të cilat nuk i ka ngritur në gjykatën themelore gjatë shqyrtimit fillestar, shqyrtimit të dytë apo shqyrtimit

gjyqësor, ankuesi nuk mund të ankohet mbi këto baza, përveç nëse vërteton se ka pasur shkaqe të jashtëzakonshme apo prova ose fakte të reja nga paragrafi 3. të këtij neni.⁶²

Sipas KPP-së me nocionin përmbajtja e ankesës nënkupton elementet përbërëse të ankesës të cilat duhet t'i përmbajë çdo ankesë me të cilën atakohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Sipas nenit 382, paragrafi 1, ankesa kundër aktgjykimit duhet të jetë në pajtim me nenin 376 por përfshinë edhe të dhënat nga neni 382. Kështu, ankesa e cila i përmban të gjitha elementet e parashikuara me nenin 376 dhe 382, paraqet bazë për të vendosur gjykata e Apelit lidhur me ankesën. Elementet e ankesës nga neni 382 mund të ndahen në dy grupe: 1. elementet e domosdoshme të ankesës dhe 2. elementet fakultative të ankesës.⁶³

Në elemente të domosdoshme të ankesës bëjnë pjesë:

- a) identifikimi i aktgjykimit i cili atakohet me ankesë përkatësisht të dhënat mbi aktgjykimin i cili atakohet;
- b) arsyet përkatësisht bazat e kundërshtimit të aktgjykimit;
- c) arsyetimin e ankesës;⁶⁴
- d) propozimin për anulim të tërësishëm apo të pjesërisht të aktgjykimit ose për ndryshim të tij dhe e. nënshkrimin e ankuesit.

Në elementet fakultative të ankesës bëjnë pjesë faktet dhe provat të cilat mund të parashtrohen në ankesë (paragrafi 3).

- a) Në të dhënat e aktgjykimit bëjnë pjesë numri i aktgjykimit, gjykata e cila e ka shqiptuar aktgjykimin, data e shpalljes së aktgjykimit etj. Të dhënat e theksuara të aktgjykimit mund mungojnë por ankesa megjithatë mund të konsiderohet valide, në rastet kur nga të dhënat të tjera mësohet se cili aktgjykim atakohet me ankesë (paragrafi 2).

⁶¹ Afrim Shala, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, Gjilan, 2010, fq. 47.

⁶² Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 382.

⁶³ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 882.

⁶⁴ KPP në fuqi nuk e përmban shprehimisht këtë element të rëndësishëm të ankesës, për dallim nga KPP i mëparshëm. Mos përfshirjen e këtij elementi të ankesës e konsiderojmë si lëshim teknik të cilin duhet korrigjuar me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të KPP-së. Në situatën e tanishme ligjore, arsyetimi i ankesës do të duhej të jetë pjesë e arsyeve-bazës të ankesës kundër aktgjykimit (nenit 382 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2).

- b) Ankuesi duke paraqitur arsyet (ndonëse konsiderojmë se Kodi do të duhej të përdorte termin bazat) e ankesës në të vërtetë përcakton drejtimin dhe vëllimin e shqyrtimit të aktgjykimit nga gjykata e shkallës së dytë. Në rastet kur ankuesi shprehimisht nuk e ka theksuar arsyen-bazën e ankesës, gjykata bazën e ankesës do ta përcaktojë nga përmbajtja e vet ankesës. Shkaqet e paraqitjes së ankesës duhet dalluar nga arsyet-baza e paraqitjes së ankesës.⁶⁵ Të gjitha shkaqet e ankesës të cilat mund të theksohen në ankesë, ndahen në katër grupe të mëdha, përkatësisht në arsye-baza të paraqitjes së ankesës si vijon: në shkelje të dispozitave të procedurës penale, në shkelje të ligjit penal, në vërtetim të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike ose në shqiptim jo të drejtë të sanksioneve penale etj. Theksimi vetëm i arsyeve-bazave të ankesës (p.sh. për shkelje të dispozitave të procedurës penale - neni 384, pa konkretizuar shkakun e ankesës nuk është e mjaftueshme për të vendosur gjykata e shkallës së dytë lidhur me ankesën, për arsye se ekzistojnë shkelje të panumërta të dispozitave të procedurës penale, të cilat duhet konkretizuar. Prandaj, për t'u marr në konsiderim ankesa, nuk mjafton vetëm theksimi i arsyes-bazës pa e theksuar edhe shkakun konkret të ankesës. Ndonëse, arsyet-bazat e ankesës sipas KPP-së janë element përbërës i ankesës, në teori ka mendime se theksimi i shkaqeve konkrete të ankesës e bën të tepërt dhe të panevojshëm theksimin e arsyes-bazës së ankesës. Kjo për arsye se nga ankuesi pa njohuri juridike kërkohet që përveç përshkrimit të shkeljes së bërë me aktgjykimin e shkallës së parë të bëjë edhe kualifikimin juridik të shkeljes së tillë, gjë të cilën sipas rregullit nuk mund ta bëjë çdo bartës i të drejtës për ankesë. Kualifikimin juridik të shkeljes do të mund ta bënte vetëm kur mbrojtësi i të pandehurit paraqet ankesë. Ankesa sipas rregullit përpilohet me shkrim ose gojarisht në procesverbal.⁶⁶
- c) Në arsyetimin e ankesës si pjesë përbërëse të ankesës, ankuesi vë në dukje para se gjithash shkaqet për të cilat atakohet aktgjykimi duke i përshkruar shkeljet ligjore dhe mangësitë tjera në aktgjykim dhe në procedurën e marrjes së aktgjykimitpërgatitjes së shqyrtimit gjyqësor, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe gjatë marrjes së aktgjykimit. Në këtë mënyrë arsyetimi i ankesës i mundëson gjykatës së Apelit ta shqyrtojë aktgjykimin në pjesët e goditura me ankesë. Së këndejmi vlen rregulla se çdo pretendim ankimor duhet të

⁶⁵ Afrim Shala, vep. e cit., fq. 90.

⁶⁶ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 442 parag. 1.

arsyetohet ngase në të kundërtën gjykata e Apelit nuk e di se çfarë vërejtjesh ka ankuesi në aktgjykim. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se gjykata e Apelit nuk do ta shqyrtojë aktgjykimin sipas detyrës zyrtare, edhe në pikëpamje të bazave të tjera të ankesës.⁶⁷ Në literaturë, theksohet se ankesa nuk është arsyetuar kur në ankesë nuk janë parashtruar kurrfarë arsyesh për bazat e atakimit të aktgjykimit. Po ashtu, ankesa konsiderohet se nuk është arsyetuar, kur vërtetë disa shkaqe janë dhënë në atë mënyrë që nga ato nuk shihet në mënyrë të qartë dhe konkretisht se me çka ka të bëjë paligjshmëria ose parregullsia e aktgjykimit (p.sh. kur në ankesë është theksuar se i akuzuari gjatë tërë procedurës penale e ka mohuar kryerjen e veprës penale, se mbrojtjes së të pandehurit do të duhej kushtuar më tepër kujdes etj.⁶⁸

- d) Ankuesi në ankesë detyrohet të paraqet edhe propozimin se çfarë vendimi kërkon të marr gjykata e Apelit duke vendosur me ankesë. Kështu, ai mund të propozojë që Gjykata e Apelit të marr vendim: në favor ose në dëm të të akuzuarit, të bëj propozim lidhur me përshkrimin faktik, kualifikimin juridik, vendimin mbi sanksionin penal dhe të propozojë mënyrën se si duhet të vendos gjykata e shkallës së dytë- anulim të plotë ose të pjesshëm ose ndryshim të aktgjykimit. Në literaturë, ka mendime se propozimi i ankesës nuk është element i domosdoshëm i ankesës, ngase ky propozim del nga pjesët tjera të përmbajtjes së ankesës.⁶⁹
- e) Element i domosdoshëm i ankesës sipas paragrafit 5 është edhe nënshkrim i ankuesit. Nënshkrimi i ankesës nga ankuesi përcakton identitetin e bartësit të ankesës. Nuk kërkohej që nënshkrimi të jetë i lexueshëm, por mjafton që ankesa të jetë nënshkruar në mënyrë të zakonshme. Në nenin 382 janë përcaktuar elementet përbërëse të ankesës sipas radhës së përshkruar më sipër. Megjithatë, radha e përmbajtjes së ankesës e përcaktuar në nenin 382, nuk është e detyrueshme për ankuesin, ashtu që ankuesi mundet që ankesën ta përpilojë me tjetër radhitje, p.sh. së pari të paraqes propozimin e ankesës për të vazhduar me elementet tjera të ankesës.⁷⁰

Ankesa mund të përmbajë të meta të përgjithshme dhe të meta të veçanta. Të metat e përgjithshme janë të mundshme të të gjitha parashtresat duke përfshirë edhe ankesën. Ndërkaq,

⁶⁷ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 394.

⁶⁸ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 882.

⁶⁹ Po aty, fq. 883.

⁷⁰ Po aty, fq. 884.

të metat e veçanta janë të lidhura me të metat me rastin përpilimit të ankesës. Kur ankesa përmban të meta të përgjithshme, të cilat i shoqërojnë edhe parashitë tjerë, gjykata do të veprojë në përputhje me nenin 442, paragrafi 4. Kur ankesa përmban të meta të veçanta, përkatësisht kur ankesa nuk i përmban elementet e parashikuara në nenin 382 paragrafi 1, është parashikuar procedurë e veçantë, në bazë të nenit 382 paragrafi 2, lidhur me ankesën e tillë. Mirëpo, procedura për evitimin e të metave të ankesës për të gjitha rastet nuk është zgjidhur në mënyrë të njëjtë por në varësi nga subjekti i ankesës dhe rrethanat tjerë të përcaktuara në nenin 401 paragrafi 2. Kështu, në rastet kur ankesën e ka paraqitur i akuzuari, i cili nuk ka mbrojtës, ose kur ankesën e ka paraqitur i dëmtuari, i cili nuk përfaqësohet nga mbrojtësi, ndërsa ankesa është e mangët, përkatësisht nuk përmban elementet nga neni 382 paragrafi 1, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues kërkon nga ankuesi që brenda afatit të caktuar të plotësojë ankesën me parashitë me shkrim. Nëse ankuesi nuk e përmbush kërkesën e tillë, ndërsa ankesa nuk përmban informatat përkitazi me aktgjykimin nga neni 376, ose nga neni 382, paragrafi 1, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e hedh poshtë ankesën nëse të dhënat nuk mundën lehtë të vërtetohen.⁷¹ Sipas nenit 382 paragrafi 3, në elementet fakultative të ankesës bëjnë pjesë faktet dhe provat e reja të cilat mund të paraqiten për të mbështetur pretendimet e ankesës dhe propozimet e ankuesit për marrjen e vendimit sa më të favorshëm nga gjykata e shkallës së dytë. Mundësia për të paraqitur fakte dhe prova të reja nënkupton institutin *beneficium novorum*, me anën e të cilit ankuesi synon ta vejë në dyshim gjendjen faktike të vërtetuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Në të kundërtën, vërtetimi i gjendjes tjetër faktike do të mund të bëhej vetëm në kuadër të rishikimit të procedurës penale. Së këndejmi, *beneficium novorum*, ka të bëjë me fakte dhe prova të reja. Por, sikur në rastet kur paraqiten fakte të reja ashtu edhe në rastet kur paraqiten prova të reja, ankuesi detyrohet të paraqet arsye pse faktet dhe provat e reja nuk i ka paraqitur më parë. Mirëpo, për mos dhënie të arsyeve pse më parë nuk janë paraqitur faktet dhe provat e reja, nuk janë paraparë kurrfarë pasojash procedurale. Faktet e reja dhe provat e reja, duhet kuptuar si fakte ose prova të paraqitura rishtas, *noviter relata* (*facta probatio*) dhe fakte ose prova të zbuluara rishtas (*facta probatin*).⁷²

⁷¹ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 382 parag. 2.

⁷² Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 885.

Në literaturë, kërkesa për të paraqitur arsyet pse faktet dhe provat e reja nuk janë paraqitur më parë, ka të bëjë vetëm me faktet dhe provat rishtas të paraqitura, për të cilat ankuesi më parë i ka ditur. Ndërkaq, sa i përket fakteve dhe provave rishtas të zbuluara, paraqitja e këtyre arsyeve nuk është e mundur, prandaj kërkesa për arsyetim pse faktet dhe provat e reja nuk janë paraqitur më herët nuk vlen. Përndryshe, paraqitja e fakteve dhe e provave të reja në ankesë kushtëzohet nga arsyet e ndryshme. Në këtë kontekst, vëmendje të veçantë duhet kushtuar taktikës së mbrojtjes në paraqitjen e fakteve dhe provave të reja. Duhet theksuar se paraqitja e fakteve dhe provave të reja, ndonëse mund të ndikojnë në zvarritje të procedurës, megjithatë kjo nuk nënkupton gjithmonë dhe zvarritjen e procedurës penale.⁷³ Me fakte të reja duhet të kuptohen të gjitha faktet që vërtetohen në procedurën penale: faktet vendimtare, faktet indicie dhe faktet ndihmëse. Po ashtu, kufizim i veçantë për paraqitje të provave dhe fakteve të reja vlen për të akuzuarin i cili gjatë procedurës penale në tërësi i ka pranuar të gjitha pikat e akuzës. Po ashtu, me dispozitën e nenit 382 paragrafi 3, shprehimisht kërkohet që nëse në ankesë paraqiten faktet e reja, ankuesi duhet të japë njëkohësisht shpjegime se me cilat prova faktet e tilla duhet të vërtetohen, e nëse mbështetet në prova të reja është e domosdoshme që ankuesi të përcaktojë se cilat fakte duhet të vërtetohen me provat e tilla. Nëse këtë nuk e bën ankuesi, gjykata e shkallës së dytë, konstatimet e tilla pa mbështetje në fakte dhe prova konkrete nuk i merr parasysh.⁷⁴ Për dallim nga e drejta anglosaksone, ku mund të kërkohet me ankesë rishqyrtimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë vetëm për shkak të metave juridike, por jo edhe për shkak të metave faktike, sipas Kodit tonë të procedurës penale, siç është theksuar më parë, në ankesë mund të paraqiten fakte dhe prova të reja të cilat nuk janë paraqitur më parë duke përfshirë edhe shqyrtimin gjyqësor, të cilat gjykata e shkallës së dytë mund t'i marrë parasysh duke vendosur lidhur me ankesën. Mirëpo, në rastet kur ankuesi pretendon në ankesë të paraqesë arsye të cilat nuk i ka paraqitur para gjykatës themelore gjatë shqyrtimit fillestar, shqyrtimit të dytë apo shqyrtimit gjyqësor, parashtuesi i ankesës nuk mund të ankohet mbi këto baza, përveç nëse vërteton se ka pasur shkaqe të jashtëzakonshme apo prova të reja nga neni 382 paragrafi 3.⁷⁵

⁷³ Azem Hajdari, vep. e cit., fq. 126.

⁷⁴ Po aty.

⁷⁵ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 382 parag. 4.

4. Arsyet për ushtrimin e ankesës ndaj aktgjykimit

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Ndaj aktgjykimit mund të ushtrohet ankesë:

- për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;
- për shkak të shkeljes së ligjit penal;
- për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike; ose
- për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, shpenzimeve të procedurës penale, kërkesave pasurore juridike, si dhe për shkak të vendimit mbi publikimin e aktgjykimit.⁷⁶

Ndaj aktgjykimit nuk mund të ushtrohet ankesë për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike kur ka marrëveshje mbi pranim të fajësisë apo kur i akuzuari ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me pranimin e tillë.⁷⁷ Në paragrafin 1 të këtij neni përcaktohen arsyet-bazat për paraqitjen e ankesës, si një nga elementet e domosdoshme të ankesës. Duke qenë se Kodi ka përcaktuar taksativisht arsyet- bazat e ankesës kundër aktgjykimit, kjo nënkupton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk mund të atakohet nga arsyet- bazat tjera. Arsyet-bazat e përcaktuara në nenin 383, paragrafi 2, mund të jenë të natyrës juridike (error iuris) ose faktike (error fakti) dhe të përziera (faktike-juridike). Arsyet juridike të mjetit juridik paraqesin gabimet lidhur me zbatimin e ligjit dhe konsistojnë në moszbatimin ose zbatimin e gabuar të ligjit. Arsyet-bazat e natyrës juridike në të vërtetë kanë të bëjnë me gabimet lidhur me zbatimin e drejtës së procedurës penale (gabimet gjatë procedimit ose error in procedendo) ose të drejtës penale materiale (gabimet në zbatimin e së drejtës penale materiale përkatësisht gabimet e bëra gjatë gjykimit ose error in iudiciando)-paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe 1.2.⁷⁸ Gjatë zhvillimit të procedurës penale mund të bëhen shkelje të shumta ligjore, por të gjitha shkeljet nuk janë bazë e ankesës. Bazë e ankesës mund të jenë vetëm shkeljet esenciale të ligjit formal ose material. Por edhe të gjitha shkeljet esenciale të ligjit nuk kanë rëndësi të njëjtë. Sipas rëndësisë së shkeljeve, ato ndahen në shkelje absolute dhe relative. Shkeljet absolute konsiderohen të gjitha shkeljet e KP (neni 385) dhe disa shkelje taksativisht të numëruara në KPP (neni 384 paragrafi 1). Shkeljet absolute janë ato shkelje të cilat përbëjnë prezumimin e pa kundërshtueshëm të ndikimit negativ në aktgjykim, për ç'arsye,

⁷⁶ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 383 parag. 1.

⁷⁷ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 383 parag. 2.

⁷⁸ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 886.

gjykata e shkallës së dytë, kur konstaton këtë shkelje duhet ta anulojë aktgjykimin ose ta ndryshojë, pa u lëshuar në të provuarit e ndikimit të kësaj shkeljeje në aktgjykimin e atakuar. Shkeljet relative rregullohen me dispozitën e nenit 384, paragrafi 2. Shkeljet relative të dispozitave të procedurës penale janë ato shkelje të cilat nuk ekziston prezumimi i ndikimit negativ të shkeljes në vendimin gjyqësor, por gjykata këtë ndikim e vërteton në çdo rast konkret. Si të tilla shkeljet relative kanë të bëjnë vetëm me shkeljet e dispozitave të procedurës penale, ngase shkeljet e dispozitave të ligjit penal, siç është theksuar më parë janë të gjitha absolute. Për të qenë bazë e ankesës, shkeljet esenciale absolute dhe relative të dispozitave të procedurës penale duhet të jenë edhe aktuale. Kështu, aktgjykimi mund të atakohet për shkak të shkeljeve të bëra gjatë përgatitjes së shqyrtimit gjyqësor, gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor ose gjatë marrjes së aktgjykimit.⁷⁹

Arsyet-bazat e natyrës faktike kanë të bëjnë me vërtetimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike (paragrafi 1, nënparagrafi 1.3). Në procedurën penale duhet bërë dallimin ndërmjet zgjidhjes së çështjeve faktike dhe atyre juridike. Zgjidhja e çështjeve faktike nënkupton vërtetimin e gjendjes përkatëse faktike, përkatësisht vërtetimin e atyre rrethanave konkrete nga jeta reale të cilat e përbëjnë veprën penale, të cilat janë të lidhura ngushtë me kryerësin e veprës penale. Për dallim nga çështjet faktike, zgjidhja e çështjeve juridike nënkupton vlerësimin nga ana e gjykatës, nëse fakti i vërtetuar apo më shumë fakte në procedurën penale i përgjigjet nocionit të normës juridike. Ndërmjet, çështjeve faktike dhe juridike ekziston lidhje reciproke. Ndërkaq, arsyet-bazat e natyrës së përzier (faktike-juridike) kanë të bëjnë me sanksionet penale, konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, shpenzimet e procedurës penale, kërkesat pasurore juridike, si dhe me vendimin mbi publikimin e aktgjykimit. Arsyet - bazat e ankesës paraqiten sipas radhës së përcaktuar në dispozitën e nenit 383, paragrafi 1. Kriter kryesor i radhitjes në këtë mënyrë është rëndësia që kanë bazat e ankesës në krahasim me njëra tjetrën. Në hierarkinë e bazave të ankesës, primat i është dhënë shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale. Kur Gjykata e shkallës së Apelit konstaton se janë bërë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, parimisht duhet ta anulojë aktgjykimin, përveç rasteve shprehimisht të përcaktuar në nenin 403 të KPP-së. Veprimet procedurale që i kanë paraprirë aktgjykimin të tillë janë të pa vlefshme (nule) duke përfshirë edhe vet aktgjykimin, e gjykatës së shkallës së parë. Për këtë arsye, nëse Gjykata e Apelit konstaton se janë shkelur dispozitat e

⁷⁹ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 887.

procedurës penale, nuk mund të lëshohet në shqyrtimin e bazave të tjera të ankesës, përkatësisht të shqyrtojë rregullsinë e zgjidhjeve të çështjeve tjera faktike dhe juridike, ndonëse në praktikën gjyqësore nganjëherë veprohet ndryshe.⁸⁰

Në literaturën e së drejtës së procedurës penale, konsiderohet me të drejtë se Kodi gabimisht ka radhitur bazën faktike të ankesës në vendin e tretë përkatësisht pas shkeljes të ligjit penal. Kjo para se gjithash për shkak të raportit që ekziston ndërmjet gjendjes faktike dhe çështjeve juridike. Duke qenë se zgjidhja e çështjeve faktike kushtëzon zgjidhjen e çështjeve juridike përkatësisht zbatimin e të drejtës, është plotësisht e arsyeshme që vërtetimi i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike si bazë e ankesës të vendoset në vend të dytë, pra para shkeljes së ligjit penal. Në rastet kur ankuesi ka atakuar aktgjykimin e shkallës së parë nga të gjitha bazat (kumulativisht), Gjykata e Apelit, kur gjen se nuk ekzistojnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, i hyjnë shqyrtimit të ankesës sipas bazave të tjera, përkatësisht vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Kur Gjykata e Apelit gjen se pretendimet e ankesës lidhur me gjendjen faktike nuk janë të bazuara, atëherë kalon në shqyrtimin e ankesës për shkak të shkeljes së ligjit penal. Në fund, Gjykata e Apelit shqyrton ankesën sipas bazës së katërt të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 383.⁸¹

I akuzuari mund ta atakojë aktgjykimin e gjykatës themelore sipas rregullit nga të gjitha bazat për paraqitjen e ankesës. Përjashtim i vetëm nga kjo rregull, përbën pikërisht dispozita e nenit 383 paragrafi 2, sipas së cilës i akuzuari i cili ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me pohimin e tillë, ndaj aktgjykimit të tillë nuk mund të ushtrohet ankesë për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike. Ndonëse, në dispozitën në fjalë përmendet vetëm i akuzuari, ankesë me të cilën atakohet aktgjykimi i shkallës së parë për shkak të gjendjes faktike po ashtu nuk mund të paraqes në mënyrë analoge edhe mbrojtësi i të pandehurit. Ratio legis për një zgjidhje të tillë qëndron në eliminimin e mundësisë për zvarritje të procedurës penale nga i pandehuri në rastin e nenit 383 paragrafi 2. Përveç kësaj, kjo zgjidhje rezulton edhe nga vlera dhe rëndësia që Kodi i ka dhënë pohimit të të pandehurit si provë në procedurën tonë penale kur përmbushen kushtet e nenit 248 të KPP-së. Përndryshe kjo dispozitë është e re, dhe si e tillë nuk ka ekzistuar në legjislacionin tonë të mëparshëm procedural penal. Për më tepër, me këtë formulim nuk haset as në

⁸⁰ Po aty.

⁸¹ Afrim Shala, vep. e cit., fq. 96.

legjislacionet e procedurale penale të shteteve në regjion. Nëse i akuzuari nuk mund ta atakojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të gjendjes faktike në procedurën lidhur me ankesë në rastet kur ka pohuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, atij i mbetet alternativa tjetër që kundër aktgjykimit të formës së prerë të paraqesë kërkesën për rishikim për shkak të fakteve dhe provave të reja.⁸²

4.1. Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse:

- përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin ose kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi;
 - në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet;
 - shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj, ose kur të akuzuarit apo mbrojtësit, pavarësisht nga kërkesa e tij, i është mohuar përdorimi i gjuhës së vet në shqyrtim gjyqësor dhe përcjellja e zbatimit të shqyrtimit gjyqësor në gjuhën e tij;
 - publiku është përjashtuar nga shqyrtimi gjyqësor në kundërshtim me ligjin;
 - gjykata ka shkelur dispozitat e procedurës penale lidhur me çështjen nëse ekziston akuza e prokurorit të autorizuar, propozimi i të dëmtuarit ose leja e organit publik kompetent;
 - aktgjykimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes;
 - gjykata me aktgjykim nuk e ka gjykuar plotësisht lëndën e akuzës;
 - aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme;
 - i akuzuari i thirrur të deklarohej mbi fajësinë nuk e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës ose ndonjë pikë të saj dhe është marrë në pyetje para prezentimit të provave;
- 2.4. aktgjykimi ka tejkaluar akuzën;
- 2.5. me aktgjykim është shkelur dispozita e nenit 395 të këtij Kodi; ose

⁸² Po aty.

2.6. aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 të këtij Kodi.⁸³

Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet edhe kur gjatë procedurës penale, duke përfshirë edhe procedurën paraprake, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia:

- nuk kanë zbatuar ndonjë dispozitë të këtij kodi ose kanë zbatuar gabimisht; ose
- kanë shkelur të drejtat e mbrojtjes, dhe kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.⁸⁴

Përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin ose kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi. Kjo shkelje ka disa forma: e para ka të bëjë me përbërjen e pa rregullt gjykatës. Me dispozitën e nenit 24 parashikohet në cilat raste dhe në çfarë përbërje gjykojnë gjykatat.⁸⁵ Kur është shkelur dispozita lidhur me përbërjen e rregullt të gjykatës, në të vërtetë është bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Në praktikën gjyqësore kjo shkelje ekziston kur në vend të trupit gjykues gjykon gjyqtari i vetëm gjykues. Po ashtu, në praktikën gjyqësore janë të mundshme rastet kur prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor e ndryshon aktakuzën⁸⁶ duke ia ngarkuar të akuzuarit veprën më të rëndë penale për të cilën është kompetente gjykata në përbërje kolegjiale. Dhe, nëse eventualisht gjyqtari individual do të vazhdonte gjykimin dhe do të merrte aktgjykimin, në këtë rast do të bënte shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Por, në praktikën gjyqësore mund të ndodh edhe e kundërta që prokurori i shtetit ta ndryshojë aktakuzën në atë mënyrë që në vend të veprës më të rëndë penale të akuzuarit t’ia ngarkojë veprën më të lehtë penale e cila është në kompetencë të gjyqtarit të vetëm gjykues.⁸⁷ Në këtë rast, sikurse edhe në rastet të tjera kur në vend të gjyqtarit të vetëm gjykues vendos trupi gjykues, konsiderohet se nuk ekziston shkelje esenciale nga ky paragraf, ngase gjykimi në përbërje më të gjerë nga që është paraparë me ligj, ofron më shumë garanci procedurale se gjykimi do të jetë i drejtë dhe i ligjshëm. Megjithatë, në teori nuk përjashtohet krejtësisht mundësia që gjykimi në përbërje më të gjerë nga që është paraparë me ligj të keqësojë situatën procedurale të pandehurit në procedurën penale.⁸⁸ Po ashtu, shkelje nga ky paragraf do të përbënin rastet nga praktika gjyqësore kur p.sh. gjykimin e

⁸³ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 384 parag. 1.

⁸⁴ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 384 parag. 2.

⁸⁵ Nenet 11-23 të Ligjit për gjykatat i Kosovës.

⁸⁶ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 350.

⁸⁷ Ejup Sahiti, vep. e cit., fq. 228.

⁸⁸ Po aty.

ka zhvilluar gjyqtari i cili nuk është emëruar në mënyrë të rregullt, përkatësisht formalisht nuk është emëruar në funksion të gjyqtarit, të cilit i është ndërprerë mandati i gjyqtarit, për shkak të kalimit të kohës për të cilën është emëruar, është shkarkuar nga funksioni i gjyqtarit, kur në procedurën për të mitur trupi gjykues ka qenë në kundërshtim me dispozitën nën 51 paragrafi 3 të Kodit të drejtësisë për të mitur përkatësisht. kur për gjyqtar porot në trupin gjykues për të mitur nuk emërohen persona nga mesi i arsimtarëve, edukatorëve, punëtorëve social, psikologëve dhe personave të tjerë që kanë përvojë në edukimin e të miturve ose kur aktgjykimin e merr praktikanti i gjykatë e tjerë. Po ashtu konsiderohet, se gjykata nuk ka qenë në përbërje të rregullt, nëse në marrjen e aktgjykimit nuk ka marr pjesë procesmbajtësi etj.⁸⁹

Forma e dytë përbën rastet kur në marrjen e aktgjykimit ka marr pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor. Kjo shkelje esenciale ndërlidhet me domosdonë e zbatimit të parimit të drejtpërdrejt të përcaktuar në dispozitën e nenit 332, sipas së cilës kryetari, anëtarët e trupit gjykues, procesmbajtësi si dhe gjyqtarët dhe gjyqtarët rezervë duhet të jenë vazhdimisht të pranishëm në shqyrtimin gjyqësor. Shkelja esenciale nga paragrafi 1 ekziston si në rastet kur në marrjen e aktgjykimit, ndonjëri nga gjyqtarët gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka marrë pjesë fare ose nga një pjesë e shqyrtimit gjyqësor. Kështu, në rastet kur gjyqtari për një kohë të shkurtër largohet nga shqyrtimi gjyqësor, kryetari i trupit gjykues detyrohet ta ndërpres shqyrtimin gjyqësor përderisa gjyqtari i cili ka munguar nuk kthehet në shqyrtim gjyqësor.⁹⁰ Në të kundërtën, do të ekzistonte shkelje esenciale nga neni 384, paragrafi 1. Në këtë kontekst, parimi i drejtpërdrejt kërkon që edhe kur shqyrtimi gjyqësor i shtyrë është mbajtur para trupit gjykues në përbërje tjetër si edhe në rastet kur shtyrja ka zgjatur më shumë se tre muaj ose kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para një kryetari tjetër të trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të fillojë rishtas dhe shqyrtohen të gjitha provat (neni 311).⁹¹ Nëse veprohet në kundërshtim me dispozitën e nenit 345, ekziston shkelje esenciale nga neni 384 paragrafi 1. (Gj. S. e Sllovenisë, AP. 62./69, dt. 21. III. 1969). Ndërkaq, pa rregullsitë lidhur me mos praninë e procesmbajtësit në shqyrtimin gjyqësor si edhe pjesëmarrjen e tij në shqyrtimin gjyqësor edhe kur do të duhej të përjashtohet nga gjykimi⁹² nuk përbëjnë shkelje esenciale absolute nga neni 384, paragrafi 1 nëparagrafi 1.1, por shkelje esenciale relative nga neni 384 paragrafi 2. Forma e tretë e kësaj

⁸⁹ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 891.

⁹⁰ Po aty.

⁹¹ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 311.

⁹² Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 45 parag. 1.

shkeljeje ekziston në rastet kur gjyqtari, ndonëse është përjashtuar nga gjykimi me aktvendim të formës së prerë, megjithatë merr pjesë në marrjen e aktgjykimit. Këtë formë të shkeljes, si bazë të ankesës duhet dalluar nga shkelja esenciale absolute e dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2. Në rastin e dispozitës së nenit 403 paragrafi 1 nënparagrafi 1 shkelja konsiston në marrje të aktgjykimit nga gjyqtari i cili me aktvendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi, ndërkaq rastin e dispozitës së nenit 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 shkelja konsiston në marrjen aktgjykimit nga ana e gjyqtarit i cili është dashur të përjashtohet nga gjykimi sipas nenit 39 paragrafi 1 dhe nënparagrafi 1.2. Duhet theksuar se Gjykata e Apelit, ankesën sipas kësaj baze e merr në shqyrtim jo vetëm nëse është theksuar në ankesë por sipas detyrës zyrtare (neni 394).⁹³

Në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet (neni 39, paragrafët 1 dhe 2);

Kjo shkelje ekziston vetëm në rastet kur janë plotësuar kushtet për përjashtim të detyrueshëm të gjyqtarit nga neni 39, paragrafi 1 dhe 2 dhe gjykata nuk ka marr vendimi për përjashtim të gjyqtarit. Kjo shkelje esenciale mund të bëhet vetëm atëherë kur kërkesa për përjashtim gjatë shqyrtimit gjyqësor është refuzuar pa arsye, ndërkaq nuk ka ankesë të veçantë kundër aktvendimit për refuzim të kërkesës, por ajo mund të paraqitet në ankesën kundër aktgjykimit.⁹⁴

Duhet theksuar se këtë shkelje gjykata e shqyrton vetëm sipas ankesës së palës dhe jo sipas detyrës zyrtare. Siç është theksuar më sipër, këtë shkelje duhet dalluar nga shkelja nga neni 384 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, ngase në rastin e parë ekziston aktvendimi i formës së prerë për përjashtim, por gjyqtari megjithatë ka bërë shkelje esenciale duke marrë pjesë në gjykim, ndërkaq në rastin nga neni 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2., aktvendimi për përjashtim nuk është marr fare ndonëse është dashtë të merret për shkak të ekzistimit të shkaqeve për përjashtim. Në këtë rast, arsyet për përjashtim fakultativ nga neni 39 paragrafi 3 nuk vijnë në shprehje. Kjo dispozitë ka të bëjë vetëm me gjyqtarin por jo edhe me personat tjerë të cilët duhet të përjashtohen (prokurori i shtetit, mbrojtësi procesmbajtësi etj.). Siç mund të shihet me këtë dispozitë, është sanksionuar pjesëmarrja e gjyqtarit në gjykim në rastet kur janë plotësuar kushtet për përjashtim të detyrueshëm, pa marrë parasysh nëse pala ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit. Në këtë kontekst, nëse në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari individual atëherë shkelja në fjalë

⁹³ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 394.

⁹⁴ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 408 parag. 3.

mund t'i përshkruhet gjyqtarit individual, ndërkaq nëse është fjala për vendosje kolegjiale, atëherë shkelja mund t'i përshkruhet kryetarit të trupit gjykues.⁹⁵

Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj, ose kur të akuzuarit apo mbrojtësit, pavarësisht nga kërkesa e tij, i është mohuar përdorimi i gjuhës së vet në shqyrtim gjyqësor dhe përcjellja e zbatimit të shqyrtimit gjyqësor në gjuhën e tij (neni 14 i KPP);

Për të ekzistuar shkelja absolute nga neni 484, paragrafi 1 nënparagrafi 1.3. kusht me rëndësi është që shqyrtimi gjyqësor të jetë mbajtur pa praninë e personave prania e të cilëve në shqyrtimin gjyqësor është e detyrueshme, pa marrë parasysh se ata nuk janë thirrur fare ose janë thirrur po nuk i janë përgjigjur thirrjes. Shkelja në këtë rast ka të bëjë me detyrimin për të marrë pjesë në shqyrtimin gjyqësor të këtyre subjekteve: të pandehurit, mbrojtësit, prokurorit të shtetit dhe përkthyesit. Për të ekzistuar shkelja tjetër absolute nga kjo dispozitë, kërkohet që pjesëmarrësve procedural përkatës t'u jetë mohuar përdorimi i gjuhës dhe përcjellja e shqyrtimit gjyqësor në gjuhën e tyre. Në shqyrtimin gjyqësor duhet të jenë të pranishëm prokurori i shtetit⁹⁶, i pandehuri⁹⁷, mbrojtësi⁹⁸ dhe përkthyesi.⁹⁹ Konsiderojmë se në vend të termit përkthyesi duhet përdorur termin interpreti, termë ky i cili më mirë i përgjigjet funksionit të këtij subjekti procedural. Nëse shqyrtimi gjyqësor mbahet pa praninë e ndonjërit prej subjekteve të theksuara më sipër, ekziston shkelja nga neni 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3. Kështu, konsiderohet se ekziston shkelja nga dispozita e nenit 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3. kur vetëm një pjesë e shqyrtimit gjyqësor është mbajtur pa praninë e të pandehurit. Për më tepër, është e pa rëndësishme nëse i pandehuri ka munguar gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit ose vetëm gjatë përfshirjes së deklaratës së të pandehurit në procesverbal dhe se për ekzistimin e kësaj shkeljeje nuk është e rëndësishme nëse mbrojtësi është pajtuar ose jo me këto veprime (Gjykata Supreme e Kroacisë, Ap.- 896/84). Po ashtu, kur në shqyrtimin gjyqësor të pandehurin e ka mbrojtur praktikanti i cili e ka dhënë provimin e judikaturës, në vend të mbrojtësit, ekziston shkelje esenciale absolute nga neni 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3. Kjo, për arsye së sipas dispozitës së nenit 70 paragrafi 1, mbrojtës mund të jetë vetëm avokati. Gjykata ka për detyrë që të akuzuarit me çrregullime mendore apo paaftësi mendore t'ia caktojë mbrojtësin sipas detyrës zyrtare (neni

⁹⁵ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 892.

⁹⁶ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 306 parag. 1.

⁹⁷ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 407 parag. 1 dhe 2.

⁹⁸ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 308.

⁹⁹ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 153 parag. 1 dhe 2.

57 paragrafi 1). Shqyrtimi gjyqësor është zhvilluar pa praninë e personit prania e të cilit ka qenë e detyrueshme, nëse gjykata posa ka vërejtur se i akuzuari është i sëmur psikik, nuk ia ka caktuar mbrojtësin sipas detyrës zyrtare (Gjykata Supreme e Kroacisë, Ap-28/64.).¹⁰⁰

Mos prania e mbrojtësit në shqyrtimin gjyqësor si shkak i ankesës nga neni 384, paragrafi 1 nënparagrafi 3, është ngushtë e lidhur me llojin e mbrojtjes e cila i ofrohet të pandehurit. Kështu, kur është fjala për mbrojtje të detyrueshme, mosprania mbrojtësit në shqyrtimin gjyqësor parimisht përbën shkeljen esenciale absolute nga neni 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3, ndërkohë kur është fjala për mbrojtjen fakultative, mosprania e mbrojtësit në shqyrtimin gjyqësor parimisht nuk e përbën këtë shkelje. Megjithatë, vlerësimi i gabuar i gjykatës se gjykimi në mungesë të mbrojtësit nuk do të shprehet negativisht për mbrojtjen e të pandehurit, mund të jetë shkelje esenciale absolute nga neni 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3.). Forma tjetër e shkeljes ka të bëjë me shkeljen e dispozitave të nenit 14 përkitazi me përdorimin e gjuhës në procedurën penale. Sipas nenit 14 paragrafi 2 personi që merr pjesë në procedurën penale i cili nuk flet gjuhën e procedimit, ka të drejtë të flasë gjuhën e vet dhe të jetë i informuar nëpërmjet përkthimit pa pagesë me faktet, provat dhe procedurën.¹⁰¹ Lidhur me këtë të drejtë, gjykata duhet ta njoftojë personin i cili merr pjesë në procedurën penale. Këta persona mund të heqin dorë nga e drejta në përkthim nëse e dinë gjuhën në të cilën zhvillohet procedura penale. Udhëzimi për të drejtën në përkthim dhe deklarata e pjesëmarrësit shënohet në procesverbal. Si mund të shihet në KPP, të drejtën në përkthim si një e drejtë themelore të njeriut, nuk e ka rezervuar vetëm për subjekt të caktuar procedural (p.sh. për të pandehurin, mbrojtësin, dhe të dëmtuarin) por këtë të drejtë ua njeh të gjithë personave që marrin pjesë në procedurën penale.¹⁰² Prandaj, mohimi i kësaj të drejte të cilitdo person që merr pjesë në procedurën penale paraqet shkelje esenciale absolute të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3. Duhet theksuar ekzistimin e disa shkeljeve, por jo të gjithave të kësaj dispozite si shkak për paraqitjen e ankesës, gjykata e shkallës së dytë i shqyrton sipas detyrës zyrtare: a). nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në mungesë të të akzuarit në kundërshtim me dispozitat e KPP-së, b). nëse në rastin e mbrojtjes së detyrueshme shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa praninë e mbrojtësit.¹⁰³ Ndërkohë, shkeljet tjera Gjykata e Apelit i shqyrton sipas dispozicionit të vullnetit të palëve.

¹⁰⁰ Afrim Shala, vep. e cit., fq. 100.

¹⁰¹ Ejup Sahiti, vep. e cit., fq. 230.

¹⁰² Joel Samaha, Criminal Law, Tenth Edition, Wadsworth, Cengage Learning, 2011, fq. 156.

¹⁰³ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 394 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3.

Publiku është përjashtuar nga shqyrtimi gjyqësor në kundërshtim me ligjin;
Me dispozitën e nenit 31, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është përcaktuar se gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata në rrethana të veçanta konsideron se, në të mirë të drejtësisë është e domosdoshme përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Më dispozitat nenit 293 - 296 KPP-së rregullohet publiciteti i shqyrtimit gjyqësor, si një element i rëndësishëm i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm. Dispozitat KK sikurse edhe dispozitat e KPP mbi publicitetin e gjykimit, janë shprehje e dispozitës së nenit 6 paragrafi 1 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) dhe nenit 14 paragrafit 1 të Paktit Ndërkombëtar për Drejtat Civile dhe politike (PNDKP), me të cilat garantohet e drejta e publicitetit të shqyrtimit publik.¹⁰⁴

Gjykata ka shkelur dispozitat e procedurës penale lidhur me çështjen nëse ekziston akuza e prokurorit të shtetit, propozimi i të dëmtuarit ose leja e organit publik kompetent;
Shkelja nga neni 384 paragrafi 1 nënparag. 1.5, përbën shkeljen e parimit akuzator në procedurën penal, sipas të cilit procedura penale fillon vetëm me vendim të prokurorit të shtetit kur ekziston dyshimi i bazuar se është kryer vepër penale. Kjo shkelje vjen në shprehje në tri situata procedurale: a) kur gjykata ka shkelur dispozitat e procedurës penale lidhur me çështjen nëse ekziston akuza e prokurorit të shtetit, b) nëse ekziston propozimi i të dëmtuarit ose c) nëse ekziston leja e organit publik kompetent. Konsiderohet se gjykata ka shkelur dispozitat lidhur me ekzistimin e akuzës të prokurorit të shtetit, kur ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor pa prokurorin e shtetit, ose pas tërheqjes së prokurorit të shtetit.¹⁰⁵ Për një numër të veprave penale taksativisht të caktuara me KP, ndjekjen e bënë prokurori i shtetit vetëm me propozim të të dëmtuarit me veprën penale. Nëse ndodhë që prokurori i shtetit për këto vepra penale të ndërmarr ndjekjen pa propozim paraprak të dëmtuarit ekziston shkelja esenciale absolute nga neni 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5. Po ashtu, prokurori i shtetit nuk mund të ndërmarr ndjekjen në rastet kur me ligj është parashikuar së për ndjekjen e personave të caktuar është e nevojshme leja e organit publik kompetent. Nëse në kundërshtim, me këtë, mbahet shqyrtimi gjyqësor dhe të pandehurit i shqiptohet aktgjykimi, ekziston shkelja nga neni 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5. Ndërkaq,

¹⁰⁴ Azem Hajdari, vep. e cit., fq. 130.

¹⁰⁵ Ejup Sahiti, vep. e cit., fq. 232.

kryetari i trupit gjykues i gjykatës themelore, para dhe gjatë shqyrtimit, kur gjen se ekzistojnë shkaqet nga neni 358, merr aktvendim me të cilin e hedhe aktakuzën. Siç mund shihet, KPP, me këtë zgjidhje ka evituar mundësinë e marrjes së aktgjykimit refuzues, zgjidhje kjo që ekzistonte në legjislacionin tonë procedural penal të mëparshëm para hyrjes në fuqi të KPP-së së përkohëshme.¹⁰⁶

Aktgjykimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes; Gjykata detyrohet të kontrollojë kompetencën e vet lëndore dhe territoriale dhe posa të konstatojë se nuk ka kompetencë, shpallet jokompetente dhe pasi aktvendimi merr formën e prerë, ia dërgon lëndën gjykatës kompetente.¹⁰⁷ Pasi aktakuza të marrë formë të prerë, gjykata nuk mund të shpallët jokompetente në pikëpamje territoriale dhe palët nuk mund të paraqesin kundërshtim për shkak të moskompetencës territoriale¹⁰⁸ Dispozitat e KPP lidhur me kompetencat janë shprehje e dispozitës së nenit 6 të KDLNJ-së dhe neni 14 paragrafi 1 të PNDKP-së, sipas të cilave procedura penale duhet të zhvillohet para gjykatës me kompetencë lëndore dhe trupit gjykues të përcaktuar me ligj.¹⁰⁹ Me dispozitat e këtyre konventave sigurohet që përkitazi me aktakuzën e ngritur për vepër penale të vendos gjykata e caktuar që më parë dhe në trupin gjykues të përcaktuar me ligj dhe jo të përcaktuar drejtpërdrejt për një rast konkret. Shkelja nga neni 384, paragrafi 1 nëparagrafi 1.6, vjen në shprehje kur aktgjykimin e ka marr gjykata e cila nuk ka pas kompetencë. Në këtë rast bëhet fjalë vetëm për shkelje të dispozitave lidhur me kompetencën lëndore, por jo edhe për kompetencën territoriale e cila nuk mund të shqyrtohet pasi që aktakuza të marr formën e prerë.¹¹⁰ Me rastin e vlerësimit të kompetencës, gjykata nuk është e lidhur me kualifikimin juridik të cilin e ka dhënë prokurori i shtetit në aktakuzë, por vetëm me përshkrimin faktik të dhënë në aktakuzë Për këtë shkelje, gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.¹¹¹

Gjykata me aktgjykim nuk e ka gjykuar plotësisht lëndën e akuzës;

Me këtë dispozitë synohet zgjidhja e aspektit kuantitativ të raportit ndërmjet akuzës dhe aktgjykimit duke detyruar gjykatën që me aktgjykim të zgjidh lëndën e akuzës në tërësi duke mos lënë pa zgjidh asnjë element të përmbajtjes së akuzës të paraqitur fillimisht përkatësisht të

¹⁰⁶ Rexhep Murati, vep. e cit., fq. 391.

¹⁰⁷ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 38 parag. 2.

¹⁰⁸ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 37 parag. 3.

¹⁰⁹ Koço Nova, Procedura Penale, pjesa e përgjithshme, Tiranë, 1966, fq. 265.

¹¹⁰ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 37 parag. 2.

¹¹¹ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 394 parag. 1.

ndryshuar, të zgjeruar ose të plotësuar. Duke qenë se akuza dhe aktgjykimi duhet të jenë në pikëpamje të përmbajtjes ekuivalente, gjykata detyrohet ta zgjidhë lëndën e akuzës në tërësi, duke përfshirë me aktgjykim të gjitha veprat penale dhe të gjithë të akuzuarit nga akuza e paraqitur ose eventualisht të ndryshuar ose të zgjeruar në shqyrtimin gjyqësor.¹¹² Gjkata duke vendosur lidhur me ankesë, vlerësimin nëse është zgjidhur në tërësi lënda e akuzës, e bën në bazë të përshkrimit të dhënë në aktin paditës të prokurorit të shtetit. Kjo nënkupton se gjykata nuk është e lidhur me kualifikimin juridik të dhënë nga prokurori i shtetit, ashtu që më shumë vepra penale nga aktakuza, me aktgjykim mund t'i kualifikojë si një vepër penale në vazhdim, vepër penale e përbërë ose kolektive me të tjerë.¹¹³

Shkelja nga neni 384 paragrafi 1 nënparag. 1.7, ekziston kur gjykata nuk vendos për njërën nga më shumë vepra penale të kryera në bashkim. Kështu, konsiderohet se kjo shkelje ekziston kur p.sh. me rastin e akuzës se i pandehuri e ka sulmuar të dëmtuarin duke i shkaktuar lëndim të lehtë trupor, me qellim që t'ia marr sendet dhe të hollat, gjykata ka gjetur se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale të grabitjes dhe e ka liruar të pandehurin për vepër penale të grabitjes, por në anën tjetër nuk e ka shpallur fajtor për vepër penale të lëndimit të lehtë trupor, kryerja e së cilës është provuar para gjykatës.¹¹⁴ Po ashtu, kjo shkelje ekziston edhe në ato raste kur gjykata ndonëse ka gjetur se nuk ekziston vepra penale e grabitjes për të cilën prokurori i shtetit ka ngritur akuzën dhe për të njëjtën nuk e liron nga akuza, por duke e tejkaluar aktakuzën, e shpall të pandehurin fajtor për vepër penale të lëndimit të lehtë trupor, ndonëse vepra penale e lëndimit të lehtë trupor nuk ka qenë e përfshirë në përshkrimin faktik të veprës në aktakuzë (GJSKr, Ap.625/63 dt. 11. IV. 1963).¹¹⁵ Kur është fjala për veprën penale të vazhduar, gjykata nuk e ka zgjidhur në tërësi lëndën e akuzës, në rastet kur në dispozitivin e aktgjykimit nuk e ka theksuar veprën penale përkatëse për të cilën e ka liruar të akuzuarin ndërkaq për veprat të tjera penale që e përbëjnë tërësinë e veprës penale të vazhduar e ka shpallur fajtor. Te vepra penale e përbërë, në rastet kur gjykata merr aktgjykim lirues, duhet vendosur për të gjitha pjesët nga të cilat përbëhet vepra penale e përbërë. Kur vepra penale është kryer me shumë veprime ndaj më shumë personave, me aktgjykim duhet të vendoset lidhur me të gjitha veprimet. Në anën tjetër, konsiderohet se nuk ekziston shkelja në fjalë nëse gjykata në dispozitiv vërtetë nuk i përfshinë

¹¹² Marenglen Rrapi, Komentari i Kodit të Procedurës Penale, Tirnaë, 2000, fq. 297.

¹¹³ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 896.

¹¹⁴ Po aty, fq. 897.

¹¹⁵ Po aty.

disa veprime të cilat e përbëjnë veprën penale unike, mirëpo i shpjegon shkaqet e mos përfshirjes së këtyre veprimeve.¹¹⁶ Kur gjykata nuk vendos për ndonjë fakt vendimtar që përbën veprën penale konkrete, nuk bën shkelje nga neni 384, paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, por në këtë rast është fjala për vërtetimin jo të drejtë të gjendjes faktike e sipas rrethanave të rastit konkret, edhe shkeljen e ligjit penal. Për këtë shkelje, gjykata nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare.¹¹⁷

Aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme;

KPP në kapitullin lidhur me parimet themelore të procedurës, krahas dispozitave të tjera parimore nuk përmban dispozitën me të cilat në mënyrë të qartë rregullohet çështja e provave të papranueshme. Për dallim nga kjo, KPP, në kapitullin e XVI, në kuadër të dispozitave të përgjithshme lidhur me provat, ka përfshirë edhe dispozitat lidhur me provat e papranueshme në procedurën penale. Përveç kësaj, provat e papranueshme rregullohen edhe me dispozitat të veçanta të KPP-së me të cilat rregullohen veprimet përkatëse penale procedurale (marrja në pyetje e të pandehurit, dëshmitarit, ekspertit etj). Siç mund të shihet, provat e marra në kundërshtim me dispozitat e KPP-së, konsiderohen prova të papranueshme.¹¹⁸ Në prova të papranueshme gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj.¹¹⁹ Këto prova në legjislacionet të tjera, në veçanti në legjislacionet e procedurës penale të shteteve në regjion emërtohen si prova të paligjshme dhe rregullohen në kuadër të dispozitave parimore përkatësisht dispozitave hyrëse dhe dispozitave të veçanta me të cilat rregullohen veprimet përkatëse penale procedurale. Në këtë kontekst, konsiderojmë se për të nënvizuar më shumë pasojat e dëmshme të përdorimit të provave të pa pranueshme, këto prova në KPP duhet të emërtohen si prova të pa ligjshme (ndonëse provat e papranueshme në brendinë e tyre janë të papranueshme pikërisht ngase janë marr në kundërshtim me dispozitat e KPP-së) dhe të parashikohen në kuadër të dispozitave parimore të procedurës penale. KPP ka përcaktuar një numër të rasteve kur aktgjykimi nuk mund të bazohet në provat e papranueshme.¹²⁰ Dhe pikërisht shkelja e këtyre dispozitave përbën shkelje esenciale absolute nga neni 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8. Gjykata e Apelit kur e konstaton këtë shkelje, nuk lëshohet konkretisht në vërtetimin nëse kjo shkelje ka ndikuar në marrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm, ngase siç dihet të gjitha shkeljet absolute përmbajnë

¹¹⁶ Tahir Rrecaj, Enver Peci, Kodi i Procedurës Penale, pjesa 5-8, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, 2008, fq. 291.

¹¹⁷ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 394 parag. 1.

¹¹⁸ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 257 parag. 2.

¹¹⁹ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 257 parag. 3.

¹²⁰ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, nenet 155, 128, 249 paragrafi 4, dhe 111

prezumimin ligjor të pa kundërshtueshëm se shkelja e tillë ka ndikuar në marrjen e vendimit, për çka vendimi i tillë duhet të priset përkatësisht të anulohet. KPP nuk bën dallimin nëse shkelja ka qenë në dëm ose në dobi të pandehurit, por duke pasur parasysh natyrën e shkeljes, konsiderohet se kjo shkelje mund të bëhet sipas rregullit në dëm të pandehurit. Për të ekzistuar kjo shkelje, kështu siç është paraparë, në nenin 384, paragrafi 1 nënparagrafi 1.8, nuk kërkohet që përdorimi i provës së papranueshme të ketë pasur rol vendimtar në marrjen e aktgjykimit. Mjafton që gjykata ta ketë mbështetë aktgjykimin në provën e papranueshme. Për këtë shkelje, gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.¹²¹

I akuzuari i thirrur të deklarohej mbi fajësinë, nuk e ka pranuar fajësinë për tërë akuzën ose ndonjë pikë të saj, dhe është marrë në pyetje para prezantimit të provave;

KPP në nenin 384 ka paraparë 12 shkelje esenciale absolute. LPP (i cili ishte në zbatim para aprovimit të KPP-së të përkohshme), kishte paraparë gjithsej 11 shkelje esenciale absolute, të cilat pa përjashtim janë përfshirë edhe në KPP në grupin e shkeljeve esenciale absolute. Mirëpo, shkeljeve ekzistuese esenciale absolute, në nenin 384 paragrafi 1 të KPP-së u është shtuar edhe shkelja nga nënparagrafi 1.9., duke rritur kështu numrin e shkeljeve në 12 shkelje esenciale absolute. Kjo shkelje esenciale absolute është përfshirë edhe në KPP-në në fuqi. Rrjedhimisht, kjo shkelje përbën sanksion procedural për shkelje të dispozitës për marrje në pyetje të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor i cili nuk ka pranuar fajësinë nga neni 345 paragrafi 1 ose shkeljes së dispozitës nga neni 325, paragrafi 3. Prandaj nëse në këtë rast nuk zbatohen në mënyrë konsekuente dispozitat për marrje pyetje të akuzuarit, përkatësisht nëse i akuzuari i cili ka mohuar pranimin e fajësinë ose konsiderohet se nuk ka pranuar fajësinë, merret në pyetje para prezantimit të provave, ekziston shkelja nga neni 484, paragrafi 1 nënparagrafi 1.9.¹²² Nga sa u tha më sipër, mund të jepet përfundim se deklarimi i të akuzuarit lidhur me fajësinë ka ndikim të drejtpërdrejtë në rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor. Kështu, kur i akuzuari pranon fajësinë, në vijim do të pasojë marrja e tij në pyetje. Kjo nënkupton se deklarimin për fajësinë duhet dalluar nga marrja në pyetje. Mirëpo, nëse i akuzuari ka mohuar pranimin e fajësisë ose konsiderohet se nuk e ka pranuar fajësinë dhe përkundër kësaj merret në pyetje para prezantimit të provave, në këtë

¹²¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 394 paragrafi 1.

¹²² Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 899.

rast, do të konsiderohet se gjykata ka bërë shkelje esenciale absolute, nga neni 484, paragrafi 1 nënparagrafi 1.9. Për këtë shkelje, gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.¹²³

Aktgjykimi ka tejkaluar akuzën (neni 360, paragrafi 1);

Me dispozitën e nenit 360 paragrafi 1 përcaktohet domosdoja e ekzistimit të identitetit objektiv dhe subjektiv ndërmjet aktgjykimit dhe aktakuzës. Mosekzistimi i identitetit objektiv dhe subjektiv ndërmjet aktgjykimit dhe aktakuzës përbën shkelje absolute nga neni 348, paragrafi 1 nënparagrafi 1.10. Tejkalimi i aktakuzës në kuptimin objektiv nënkupton tejkalimin e aktakuzës kur me aktgjykim përfshihet edhe ndonjë vepër tjetër penale e cila nuk ka qenë objekt i aktakuzës, përkatësisht kur gjykata gjykon për ngjarjen tjetër nga e kaluara ose për përshkrimin tjetër faktik dhe jo për ngjarjen dhe përshkrimin faktik të dhënë në aktakuzën e paraqitur fillimisht ose aktakuzën e ndryshuar ose të zgjeruar në shqyrtimin gjyqësor. Kështu gjykata, nuk mundet vet ta ndryshojë përshkrimin faktik të veprës, duke përfshirë në te ose duke lënë pjesë të cilat do të shpinin te kualifikimi më i rëndë i veprës penale nga përshkrimi faktik i veprës penale në aktakuzë.¹²⁴ Gjukata ka tejkaluar akuzën kur i akuzuari është shpallur fajtor për formën e kualifikuar të veprës penale, kur në përshkrimin e veprës penale në aktgjykim janë shtuar rrethanat kualifikuese të cilat nuk kanë ekzistuar në akuzë (Gj.S. e B. e H., Ap.-76/81, Bilten 1/89. Po ashtu, asnjëherë gjykata nuk mund të shpallë fajtor të akuzuarin për vepër tjetër penale nga ajo që i ngarkohet me aktakuzë, pa marrë parasysh nëse është fjala vepër penale më të lehtë ose më të rëndë nga vepra penale e cila i ngarkohet me aktakuzë. Mirëpo, vetëm përjashtimisht gjykata mund ta shpallë fajtor një person për vepër të ndryshme, e cila është njësoj e rëndë ose e lehtë në krahasim me veprën e përshkruar në aktakuzë, me kusht që këto ndryshime nuk kanë të bëjnë me elementet thelbësore të veprës penale.¹²⁵ Ndërkaq, tejkalimi i aktakuzës në kuptim subjektiv nënkupton kur me aktgjykim është përfshirë edhe ndonjë person i cili nuk ka qenë i përfshirë me aktakuzë ose i cili fare nuk ka qenë i akuzuar. Lidhur me identitetin subjektiv në praktikën gjyqësore nuk ka vështirësi ngase çështjet kontestuese që lidhën me identitetin subjektiv të aktakuzës me aktgjykim zgjidhën praktikisht me vërtetimin e i identitetit të akuzuarit. Mirëpo, tejkalimi i akuzës mund të jetë i kombinuar në rastet kur me aktgjykim është përfshirë vepra penale e cila nuk ka qenë objekt i akuzës përkatësisht ngjarja tjetër dhe jo ngjarja

¹²³ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 394 parag. 1.

¹²⁴ Ejup Sahiti, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, (shqyrtim teorik), Revista “E drejta”, nr. 3/2003, Prishtinë, fq. 7-36.

¹²⁵ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 899.

e paraqitur në aktakuzë dhe në këtë rast këto elemente objektive i përshkruhen personit i cili fare nuk ka qenë i akuzuar.¹²⁶ Por, tejkalimi i aktakuzës ekziston edhe në rastet kur personit i cili është i akuzuar për një formë të caktuar të pjesëmarrjes në kryerjen e veprës penale, i përshkruhet forma më e rëndë e pjesëmarrjes në kryerjen e veprës penale. Kështu, p.sh. kur një person akuzohet si ndihmës në kryerjen e veprës penale, ndërkaq gjykata e dënon si nxitës, ose kur akuzohet si nxitës ndërkaq shpallet fajtor si kryerës i veprës penale. Në anën tjetër, nuk ka tejkalim të akuzës, nëse gjykata në përshkrimin e veprës penale ka përfshirë detaje të cilat nuk i përmban akuza dhe shërbejnë për të precizuar më afër veprën penale. Identiteti i aktakuzës me aktgjykim, nuk nënkupton lidhshmërinë e gjykatës me kualifikimin juridik të veprës penale dhe se mospërfillja e kualifikimit juridik të veprës nga gjykata nuk nënkupton tejkalim të aktakuzës.¹²⁷

Aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370.

Kjo shkelje absolute ka të bëjë me pa rregullsitë formale të aktgjykimit. Ndonëse, edhe me KPP të mëparshëm, kjo shkelje kishte të bënte me parregullsitë formale, KPP në fuqi e ka shndërruar këtë shkelje absolute në një shkelje edhe më formale përkatësisht tejet formale. Kjo shkelje ekziston në rastet kur aktgjykimi nuk është në përputhje me përmbajtjen dhe formën e përcaktuar në nenin 370 KPP-së. Me fjalë të tjera, të metat e aktgjykimit kryesisht i përkasin aktgjykimit me shkrim i cili duhet hartuar në bazë të nenit 370.¹²⁸ Përndryshe, kjo shkelje përbënte shkeljen më të shpeshtë në praktikën gjyqësore, për të cilën shkelje gjykatat më të larta i anulonin vendimet e gjykatave të shkallës së parë. Sipas paragrafit 2 të këtij neni, shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet edhe kur gjatë procedurës penale, duke përfshirë edhe procedurën paraprake, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia: a) nuk kanë zbatuar ndonjë dispozitë të këtij kodi ose kanë zbatuar gabimisht; ose b) kanë shkelur të drejtat e mbrojtjes, dhe kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë. Si mund të shihet shkeljet esenciale relative të dispozitave të procedurës penale, rregullohen me paragrafin 2 të këtij neni. Në grupin e këtyre shkeljeve, bëjnë pjesë të gjitha shkeljet të tjera të dispozitave të procedurës penale, të cilat nuk janë përcaktuar taksativisht, kur gjykata, prokurori dhe policia nuk kanë zbatuar ndonjë dispozitë të procedurës penale ose gabimisht e kanë zbatuar

¹²⁶ Azem Hajdari, vep. e cit., fq. 137.

¹²⁷ Rexhep Murati, vep. e cit., fq. 396.

¹²⁸ Ejup Sahiti, vep. e cit., fq. 239.

dhe kjo ka ndikuar ose mund të ndikojë në marrjen e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë.¹²⁹ Me këtë dispozitë përcaktohen fazat e procedurës penale në të cilën vinë në shprehje shkeljet esenciale relative, subjektet të cilët mund t'i shkaktojnë këto shkelje dhe format e këtyre shkeljeve. Shkeljet relative vijnë në shprehje: a) gjatë tërë procedurës penale përfshirë edhe fazën e përgatitjes së shqyrtimit gjyqësor ndërkaq subjektet e mundshëm të këtyre shkeljeve janë: b) gjykata, prokurori i shtetit dhe policia. Ndërkaq, sa i përket mënyrës se shkeljeve esenciale relative, Kodi përcakton dy mënyra themelore të shkeljeve relative: a) kur gjykata, prokurori dhe policia nuk ka zbatuar ndonjë dispozitë KPP ose ajo është zbatuar gabimisht ose b) kur janë shkelur të drejtat e mbrojtjes; dhe kjo ka ndikuar ose ka mund të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të rregullt.¹³⁰

4.2. Shkelja e ligjit penal

Sipas KPPK-së, Shkelje e ligjit penal ekziston kur:

- vepra për të cilën i akuzuari ndiqet nuk është vepër penale;
- ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale;
- ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, e sidomos nëse ndjekja penale është parashkruar ose është përjashtuar për shkak të amnistisë apo faljes, ose më parë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë;
- lidhur me veprën e gjykuar penale është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet;
- në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore; ose
- janë shkelur dispozitat mbi llogaritjen e paraburgimit dhe të dënimit të mbajtur.¹³¹

Vepra për të cilën i akuzuari ndiqet nuk është vepër penale;

Kjo shkelje ekziston kur gjykata gabimisht gjen se veprimet e të pandehurit përbëjnë vepër penale, ndonëse do të duhej të gjente se veprimi i tillë nuk përbën vepër penale. Me fjalë të tjera,

¹²⁹ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, E drejta procedurale penale “Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës”, botim i dytë, Prishtinë, 2004, fq. 246.

¹³⁰ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 903.

¹³¹ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 385.

shkelje në dëm të të pandehurit konsiderohen ato raste të shkeljeve kur gjykata gabimisht ka marrë qëndrim se veprimi i të pandehurit është vepër penale, ndonëse sipas zbatimit të drejtë të ligjit penal do të duhej të konsiderohej se veprimi i tillë nuk përbën vepër penale. Shkelja në këtë rast përbën shkelje në dëm të të pandehurit. Kjo shkelje paraqitet në tri forma: 1) si vlerësim i gabuar juridik se një vepër është vepër penale 2). si vlerësim i gabuar juridik i ekzistimit të figurës ligjore të veprës penale dhe 3. si vlerësim i gabuar i ekzistimit të shkaqeve për përjashtimin e kundërligjshmërisë.¹³² Ndryshe, këtë shkelje të ligjit penal sipas KPP në fuqi, gjykata mund ta bëjë vetëm në dëm të të pandehurit. Në rastin e parë, për të ekzistuar vepra penale është e domosdoshme të përmbushen të gjitha e elementet e nocionit të përgjithshëm të veprës penale¹³³ dhe të gjitha elementet e veçanta të veprës penale e cila është objekt i akuzës. Kjo shkelje ekziston nëse gjykata gabimisht vlerëson ekzistimin e këtyre elementeve të domosdoshme. Kjo formë e shkeljes ekziston, kur gjykata gabimisht vlerëson se një veprim përbën vepër penale, ndërsa veprimi i tillë p.sh. është kundërvajtje, delikt disiplinor, raport juridiko civil ose ngjarje irelevante juridike. Po ashtu, kjo formë e shkeljes ekziston edhe në ato raste kur gjykata gabimisht vlerëson se janë shfuqizuar dispozitat juridiko penale të ligjeve të Kosovës ose se ato dispozita nuk mund të zbatohen. Në rastin e dytë, shkelja e ligjit penal ekziston kur gjykata gabimisht ka konkluduar se janë realizuar të gjitha tiparet e veprës penale të parashikuara në ligj.¹³⁴ Dhe, në rastin e tretë, vlerësimi i gabuar juridik i mosekzistimit të shkaqeve për përjashtim të kundërligjshmërisë, mund të jetë shkelje e ligjit penal. Në kuptimin procedural, duhet pasur parasysh tiparet ligjore të veprës penale si fakte nga të cilat varet ekzistimi i veprës penale. Këto fakte, janë fakte të cilat shkojnë në dëm të pandehurit dhe si të tilla duhet të vërtetohen me saktësi. Në të kundërtën, shkaqet që përjashtojnë kundërligjshmërinë si fakte që shkojnë në favor të të pandehurit mjafton që të jenë të besueshme dhe nëse kjo besueshmëri nuk arrihet të rrëzohet, do të konsiderohet se ato ekzistojnë. Kjo është shprehje e rregullës in dubio pro reo e përcaktuar në nenin 3, parag. 2. Lidhur me këtë shkelje, Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare.¹³⁵

Ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale;

¹³² Ejup Sahiti, vep. e cit., fq. 242.

¹³³ Kodi Penal i Kosovës, neni 6.

¹³⁴ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, Criminal Procedure System of Kosovo, Transittion of criminal procedure systems, volume II, Rijeka, 2004, fq. 135.

¹³⁵ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 905.

Kjo shkelje ekziston në ato raste kur gjykata gabimisht i vlerëson bazat për përjashtim të përgjegjësisë penale. Gjithashtu edhe këtë shkelje të ligjit penal, gjykata mund ta bëjë vetëm në dëm të të pandehurit.¹³⁶ Shkelje e ligjit penal në dëm të të pandehurit ekziston kur gjykata gabimisht ka gjetur se nuk ekzistojnë rrethanat të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale duke e shpallur të pandehurin gabimisht fajtor. Bazat e përjashtimit të përgjegjësisë penale janë: pakujdesia kur me ligj nuk parashikohet përgjegjësia për këtë formë të fajësisë,¹³⁶ papërgjegjshmëria¹³⁷, dhe lajthitja faktike.¹³⁸ Analiza e këtyre dispozitave tregon se vetëm te lajthitja reale përcaktohet shprehimisht se ekzistimi i saj përjashton përgjegjësinë penale. Ndërkaq, sa i përket pakujdesisë dhe papërgjegjshmërisë konkludimi mbi përjashtimin e përgjegjësisë penale duhet të nxirret në mënyrë indirekte përkatësisht me interpretimin e dispozitave ligjore. Duhet theksuar se në pikëpamje të kësaj shkeljeje të ligjit penal duhet pasur parasysh se faktet në bazë të të cilave vlerësohet qëllimi dhe pakujdesia, si fakte të cilat shkojnë në dëm të të pandehurit, duhet të vërtetohen saktësisht, ndërkaq faktet lidhur me papërgjegjshmërinë dhe lajthitjen, të cilat shkojnë në dobi të të pandehurit, mjaftojnë që të jenë të besueshme ngase në këto raste vjen në shprehje rregulla in dubio pro reo. Lidhur me këtë shkelje, gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.¹³⁹

Ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, e sidomos nëse ndjekja penale është parashkruar ose është përjashtuar për shkak të amnistisë apo faljes, ose më parë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë;

Kjo shkelje nënkupton vlerësimin e gabuar të rrethanave të cilat përjashtojnë ndjekjen penale. Këtë shkelje Kodi e ka konceptuar në atë mënyrë që më parë me një dispozitë të përgjithshme ka përcaktuar se kjo shkelje ekziston nëse ekzistojnë rrethanat të cilat përjashtojnë ndjekjen penale, duke apostrofuar në veçanti disa nga bazat e përjashtimit të ndjekjes penale. Kjo do të thotë se Kodi në këtë dispozitë shprehimisht ka theksuar disa nga bazat e përjashtimit të ndjekjes duke mos përjashtuar edhe ndonjë bazë tjetër të mundshme të përjashtimit të ndjekjes. Kështu, Kodi si baza të përjashtimit të ndjekjes penale të cilat më së shpeshti vinë në shprehje, në veçanti i numëron: parashkrimin e ndjekjes penale¹⁴⁰, amnistinë¹⁴¹, faljen¹⁴² dhe çështjen e gjykuar (res

¹³⁶ Kodi Penal i Kosovës, neni 17, paragrafi 3.

¹³⁷ Kodi Penal i Kosovës, neni 18, paragrafi 1.

¹³⁸ Kodi Penal i Kosovës, neni 25.

¹³⁹ Rexhep Murati, vep. e cit., fq. 402.

¹⁴⁰ Kodi Penal i Kosovës, neni 106 dhe 107.

¹⁴¹ Ligjin për amnistinë Ligji Nr. 04/L-209, datë 11 korrik 2013.

judicata). Kuptohet se ekzistimin e parashkrimit të ndjekjes penale, gjykata e vlerëson në përputhje me rrethanat e rastit konkret mbështetur në dispozitat (e nenit 106 dhe 107 të KP), e duke pasur parasysh se në bazë të nenit 111 të KP, instituti i parashkrimit nuk vlen të ndjekja penale për gjenocid, krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit, si edhe për vepra penale të tjera për të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk mund të zbatohet parashkrimi. Duhet theksuar se ndërmjet kësaj dispozite dhe dispozitës së nenit 363 me të cilën rregullohet marrja e aktgjykimit refuzues për shkak të pengesave procedurale ekziston ngjashmëri përmbajtësore. Kështu, e njëjta rrethanë në procedurën para gjykatës themelore merret si shkelje e dispozitave të procedurës penale, ndërsa në procedurën lidhur me mjetin juridik si shkelje e ligjit penal.¹⁴³ Me fjalë të tjera, me Kodin penal parashkrimi, amnistia dhe falja konsiderohen si prezumime materialo juridike përkatësisht si pengesa të ndjekjes penale apo të fillimit të procedurës penale. Në anën tjetër, disa shkelje të cilat po ashtu janë prezumime me karakter materialo juridik penal siç është leja e organit publik për fillimin e procedurës penale, kërkesa e prokurorit të shtetit, propozimi i të dëmtuarit në procedurën para gjykatës së shkallës së parë konsiderohen si shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.¹⁴⁴ Se në një rast konkret bëhet fjalë për çështjen e gjykuar, kjo mund të vërtetohet vetëm në bazë të aktgjykimit ose të aktvendimit të formës së prerë. Gjukata e Apelit kur gjen se ekziston kjo shkelje e Kodit penal, e ndryshon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe merr aktgjykim me të cilin e refuzon akuzën.

Lidhur me veprën e gjykuar penale është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet; Shkelja e Kodit penal e parashikuar në nenin 385, paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, nënkupton zbatimin e gabuar të ligjit penal në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë. Me zbatim të gabuar të ligjit para se gjithash duhet kuptuar kualifikimin e gabuar të ligjit ose çdo zbatim tjetër të dispozitave materiale juridike, duke përfshirë edhe dispozitat e përgjithshme të Kodit penal. Kështu, ligji penal është shkelur kur gjykata në vend të veprës penale të vazhduar ka marr se ekzistojnë më shumë vepra penale të veçanta ose e kundërta në vend se të vlerësojë se ekzistojnë më shumë vepra penale të veçanta ka vlerësuar se ekziston vepra penale e vazhduar.¹⁴⁵ Kjo shkelje e Kodit penal ka dy forma: 1) zbatimi i ligjit i cili nuk ka mund të zbatohet 2) zbatimi i

¹⁴² Kodi Penal i Kosovës, neni 112.

¹⁴³ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 908.

¹⁴⁴ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 384, paragrafi 1 nënparagrafi 1.5.

¹⁴⁵ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 908.

ligjit i cili do të duhej zbatuar, por zbatimi është bërë në mënyrë të gabuar.¹⁴⁶ Të dy këto shkelje kanë për pasojë kualifikimin e gabuar të veprës penale. Kjo do të thotë se i akuzuari shpallet fajtor dhe se veprimet e tij vlerësohen si vepër penale, mirëpo në këto raste ligji është zbatuar në mënyrë të gabuar. Ndërmjet shkeljeve të Ligjit penal nga neni 385, paragrafi 1 dhe shkeljeve nga paragrafi 4, ekzistojnë dallime thelbësore. Kështu, përkitazi me shkeljen nga paragrafi 1 ligji penal nuk mund fare të zbatohet, ndërkaq përkitazi me shkeljen nga paragrafi 4, ligji penal ka mund të zbatohet por jo ai i cili është zbatuar por ligji tjetër. Duhet theksuar se shkeljet neni 385, paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 kanë të bëjnë vetëm me rrethanat kualifikuese dhe privilegjuese të veprës penale, që do të thotë se jo edhe me elementet konstituive, sepse në këtë rast fjala është për shkeljen e ligjit penal nga neni 404 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1. Për të zbatuar ligjin më të ashpër për shkak të cilësive të veçanta të kryerësit dhe për shkak të rrethanave të veçanta në të cilat është kryer vepra penale, cilësitë e tilla prokurori duhet t'i theksojë me rastin e përshkrimit të çdo vepre penale. Përndryshe, zbatimi i ligjit më të butë pa i theksuar këto cilësi dhe rrethana, paraqet shkelje të ligjit penal nga neni 403 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4.¹⁴⁷

Kështu, nuk është fjala për veprën penale të vjedhjes së imtë por është fjala për vepër penale të marrjes së sendit të huaj, kur kryerësi e ka marrë dhe e ka mbajtur lejen e vozitjes së automobilit (Gjykata Supreme e Kroacisë, Ap. 1866/73 dt. 28. XI. 1973. Në rastet kur është shkel ligji penal dhe është zbatuar ligji i cili nuk ka mund të zbatohet, gjykata e shkallës së dytë e ndryshon aktgjykimin e atakuar sa i përket kualifikimit juridik dhe e zbaton ligjin penal të cilin duhet zbatuar. Mirëpo, nëse për aplikimin e drejtë të ligjit penal është e domosdoshme të ndryshohet gjendja faktike, në këtë rast nuk është fjala për shkeljen nga neni 404, paragrafi 1 nënparagrafi 4, por shkeljen nga neni 405.¹⁴⁸

Në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore;

Shkelja nga neni 385, paragrafi 1 nënparagrafi 1.2. ekziston në ato raste kur gjykata shqipton dënimin përkatësisht sanksionin tjetër penal ose masat të tjera në mënyrë të paligjshme. Me fjalë të tjera, kjo shkelje ekziston kur gjykata me aktgjykim shqipton sanksionin cili nuk ekziston fare në Kodin penal (p.sh. dënimi trupor, dënimi me punë të detyrueshme, konfiskimi i pasurisë,

¹⁴⁶ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 908.

¹⁴⁷ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 908.

¹⁴⁸ Po aty.

dënimi me vdekje etj.).¹⁴⁹ Kjo shkelje ekziston edhe në rastet kur gjykata ka shqiptuar dënimin i cili ndonëse ekziston në Kodin penal, në këtë rast nuk mund të shqiptohet (p.sh. dënimi nën ose mbi minimumin e përgjithshëm ose të veçantë, përkatësisht maksimumin, dënimi pre 7 ditëve ose 60 vjetëve burg). Po ashtu, kjo shkelje ekziston edhe në rastet kur gjatë matjes së dënimit gjykata ka shkelur dispozitat të tjera të Kodit penal (p.sh. mbi zbutjen e dënimit, shndërrimit të një dënimi në llojin tjetër të dënimit, shqiptimit të dënimit me kusht, marrjes së detyrueshme të dobisë pasurore, shqiptimit të dënimit plotësues bashkë me dënimin kryesor etj.). Përveç kësaj kjo shkelje ekziston nëse gjykata kryerësit i cakton kushte plotësuese ose i cakton detyrime të cilat të cilat nuk janë paraparë me ligj. Kështu, kryerësit të veprës penale për mos ekzekutim të vendimit gjyqësor për kthim në punë nuk mund t'i imponohet detyrimi për të kthyer në punë punëtorët, ngase kjo nuk është paraparë me dispozitat e Ligjit Penal. (Gjykata Supreme e Kroacisë, Ap. 15/81 dt. 12. V. 1981).¹⁵⁰ Këto shkelje kanë të bëjnë me shkelje të dispozitave si të pjesës së përgjithshme po ashtu edhe të veçanta të legjislacionit penal. Por, këtë shkelje duhet gjithsesi dalluar nga shkelja nga neni 387, si bazë e katërt për paraqitje të ankesës. Në dispozitën e nenit 384, paragrafi 1 nënparagrafi 1.5. bëhet fjalë për sanksionin apo masën tjetër të shqiptuar në mënyrë të paligjshme, ndërkaq shkelja nga neni 387 konsiston në shqiptimin e sanksionit ose masës tjetër në mënyrë të ligjshme por që me rastin e shqiptimit të tyre, gjykata ka gabuar gjatë matjes së dënimit duke mos marrë parasysh rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese në rastin konkret.¹⁵¹

Janë shkelur dispozitat mbi llogaritjen e paraburgimit dhe të dënimit të mbajtur;
Kjo shkelje konsiston në vlerësimin e gabuar të nevojës për të llogaritur paraburgimin ose dënimin e mbajtur në aktgjykim.¹⁵² Me fjalë të tjera, kjo shkelje ekziston në ato raste kur gjykata e bën vlerësimin e gabuar juridik lidhur me llogaritjen e kohës të cilën i pandehuri e ka kaluar në paraburgim ose në mbajtje të dënimit, përkatësisht nëse këto forma të privimit nga liria duhet ose nuk duhet llogaritur në dënimin e shqiptuar me burg, burgimin e përjetshëm, dënimin për të mitur ose dënimin me të holla. Duhet theksuar se me dispozitën e nenit 83 të KP, është parashikuar se koha e kaluar në paraburgim si edhe çdo periudhë e heqjes nga liria me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim të përjetshëm dhe dënim me gjobë.

¹⁴⁹ Po aty.

¹⁵⁰ Po aty, fq. 909.

¹⁵¹ Po aty.

¹⁵² Kodi Penal i Kosovës, neni 83.

Dispozitat e KP mbi përfshirjen e ndalimit në dënimin e shqiptuar gjithashtu zbatohen edhe lidhur me masën e arrestit shtëpiak (neni 183, paragrafi 7 - fjalia e dytë). Gjykata bën shkelje të ligjit penal nga neni 385, paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, kur nxjerr përfundim juridik të gabuar se nuk duhet bërë llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim ose në mbajtje të dënimit në dënimin e shqiptuar, ndonëse janë plotësuar kushtet për llogaritjen e këtyre formave të privimit të lirisë në dënimin e shqiptuar.¹⁵³ Kur Gjykata e Apelit, duke vendosur lidhur me ankesë gjen se ekziston kjo shkelje, ajo në seancë të kolegjit e ndryshon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë duke bërë llogaritjen përkatëse. Konsiderohet se nuk ekziston shkelje nga nënparagrafi 1.6. i këtij neni kur gjykata fare nuk i ka vërtetuar rrethanat që kanë të bëjnë me zbatimin e dispozitave mbi llogaritjen e paraburgimit, kohës së privimit të lirisë ose dënimit, ngase në këtë rast nuk është fjala për vlerësim të gabuar juridik, por për lëshim të gjykatës i cili nuk konsiderohet shkelje e ligjit penal.¹⁵⁴ Prandaj, në raste të tilla kolegji i Gjykatës së Apelit, nuk mund që në dënimin e shqiptuar të llogarisë kohën e kaluar në paraburgim por mundet që në arsyetim të aktgjykimin të gjykatës së shkallës së dytë të caktojë që llogaritjen e kohës së paraburgimit ta bëjë kryetari i trupit gjykues me aktvendim të veçantë në kuptim të nenit 489 të KPP. Përveç kësaj, nuk ekziston shkelje nga nënparagrafi 1.6 paragrafi 1 të këtij neni edhe në rastet kur në vendimin lidhur me llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar gabimisht llogaritet p.sh. koha e kaluar në paraburgim. Kjo për arsye se kjo shkelje paraqet vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Gjykata e Apelit në këtë rast sipas ankesës e anulon vendimin mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar dhe cakton që kryetari i trupit gjykues të bëjë llogaritjen e paraburgimit me aktvendim të veçantë në kuptim të dispozitës së nenit 489, paragrafi 1.¹⁵⁵

4.3. Vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike

Sipas KPPK-së, aktgjykimi mund të kundërshtohet për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike. Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike ekziston kur gjykata ka vërtetuar gabimisht ndonjë fakt të rëndësishëm apo kur përmbajtja e dokumentit, procesverbalit mbi provat e shqyrtuara ose të incizimit teknik vënë në pikëpyetje saktësinë ose bazueshmërinë e

¹⁵³ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 909.

¹⁵⁴ Ejup Sahiti, vep. e cit., fq. 229.

¹⁵⁵ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 910.

vërtetimit të fakteve të rëndësishme. Vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ekziston kur gjykata nuk ka vërtetuar ndonjë fakt të rëndësishëm.¹⁵⁶ Shkelja nga neni 386, bën pjesë në grupin e gabimeve faktike përkatësisht të metat faktike të aktgjyqimit të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, për dallim nga gabimet juridike që kanë të bëjnë me të metat lidhur me zbatimin e dispozitave të procedurës penale ose dispozitave të ligjit penal.¹⁵⁷

Angazhimi i gjykatës në vërtetimin e gjendjes faktike paraqet një veprimtari tejte të rëndë dhe të ndërlikuar. Për këtë arsye, gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor pjesën më të madhe të kohës ia kushton vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike. Në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë mund të zbatohet drejt ligji material, ndonëse nuk përjashtohet mundësia që në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë të zbatohet ligji në mënyrë të gabuar. Përkundër përpjekjeve të gjykatës për të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, megjithatë kjo në disa raste për arsye të ndryshme nuk është e mundur. Të metat në vërtetimin e gjendjes faktike manifestohen në dy forma themelore: a) gjendje e vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe b) gjendje e vërtetuar në mënyrë jo të plotë. Se kur ekziston njëra nga këto të meta themelore mund të dihet nga dispozitat e ligjit procedural dhe material që është zbatuar ose që është dashtë të zbatohen, në rastin konkret.¹⁵⁸ Me fjalë të tjera, nga ligji procedural ose material shihet se cilat fakte vendimtare duhet vërtetuar lidhur me çështjen që është objekt i gjyqimit. Vërtetimi i këtyre fakteve përbën vërtetimin e gjendjes faktike, në të cilën zbatohet ligji material ose formal. Faktet vendimtare vërtetohen në mënyrë të drejtpërdrejt (direkt) dhe të tërthortë (indirekte). Kështu, faktet vendimtare vërtetohen në mënyrë të drejtpërdrejtë (direkt), me anë të provave dhe nëpërmjet vrojtimit të drejtpërdrejtë të gjykatës si formë tjetër vërtetimit të drejtpërdrejtë. Ndërkaq, vërtetimi i fakteve vendimtare në mënyrë të tërthortë (indirekte) bëhet nga faktet të tjera (faktet -indice, përkatësisht faktet kontrolluese).¹⁵⁹ Faktet -indice mundësojnë që me anë të konkludimit logjik të vërtetohet fakti vendimtar. Faktet - indice janë prova me të cilat vërtetohen faktet vendimtare por njëherësh janë edhe fakte të cilat mund të vërtetohen: 1. prova 2. indice të tjera. Duhet theksuar se indicet në shumicën e rasteve paraqiten në numër më të madh. Në procedurën penale përveç vërtetimit të fakteve vendimtare, fakteve-indice vërtetohen edhe faktet ndihmëse. Konsiderohet se faktet ndihmëse për shkak të funksionit të tyre ndryshe quhen edhe

¹⁵⁶ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 386.

¹⁵⁷ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 484 dhe 485.

¹⁵⁸ Afrim Shala, vep. e cit., fq. 119.

¹⁵⁹ Po aty.

fakte kontrolluese dhe shërbejnë: 1) për zbulimin e provave ose indiceve 2) për vlerësimin e besueshmërisë së provave ose indiceve 3) për vlerësimin e rregullsisë së gjendjes faktike 4) për qëllime të tjera.¹⁶⁰ Ka mendime se gjendjen faktike përveç gjykatës e vërtetojnë subjektet tjera në procedurën penale. Megjithatë, me gjendje faktike të vërtetuar, duhet kuptuar tërësinë e fakteve vendimtare të vërtetuar nga ana e gjykatës. Dhe, vetëm ato fakte vendimtare të cilat janë vërtetuar me aktgjykim mund të konsiderohen se ekzistojnë, por jo edhe ato të cilat ekzistojnë jashtë aktgjykimit. Ndonëse, faktet vendimtare rezultojnë nga provat e shqyrtuara, gjithmonë dhe pa përjashtim duhet të nxirret përfundimi lidhur me ekzistimin e tyre sepse në të kundërtën, do të konsiderohet se gjendja faktike nuk është vërtetuar (Gjykata Supreme e B e H, A.p.-259/97, Bilten 2/97). Për dallim nga procedurat penale të Evropës kontinentale, ku bën pjesë edhe procedura e jonë penale, në procedurën anglo-amerikane nuk shtrohet çështja e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë gjendjes faktike. Kjo para se gjithash për shkak se në procedurën penale anglo-amerikane gjykimi i çështjes penale ndahet ndërmjet jurisë dhe gjyqtarit. Kështu, gjyqtari vendos për çështjet juridike ndërkaq juria për çështjet faktike.¹⁶¹ Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor juria merr vendimin mbi fajësinë e të pandehurit (verdiktin). Në procedurën penale anglo-amerikane, kundër vendimit të fajësisë ose pafajësisë mund të paraqitet ankesa me të cilën mund të kërkohet kontrollimi i vendimit gjyqësor sa përket zgjidhjes së çështjeve juridike por jo atyre faktike. Detyrë e gjyqtarit është që pasi juria të ketë marr vendimin e pafajësisë dhe pasi të ketë konstatuar në procesverbal se është marrë vendim i pafajësisë, duhet ta lirojë të akuzuarin. Në këtë rast procedura përfundon pa kurrfarë aktgjykimi të veçantë. Në mënyrë të ngjashme vepron edhe gjyqtari kur juria merr vendim të fajësisë, ashtu që gjyqtari këtë vetëm e konstaton në procesverbal por nuk e arsyeton në aktgjykim ngase nuk e din epilogun e votimit të jurisë.¹⁶²

Vërtetimi i gabuar si bazë e paraqitjes së ankesës ekziston në ato raste kur gjykata gjatë procedurës së provave i merr në shqyrtim të gjitha faktet vendimtare dhe i nxjerrë të gjitha provat që i ka në dispozicion për vërtetimin e këtyre fakteve, por më pas e vlerëson gabimisht domethënien e provave të shqyrtuar duke nxjerrë përfundime të gabuara lidhur me ekzistimin ose mos ekzistimin e fakteve. Gjykata një provë e vlerëson gabimisht kur p.sh. konsideron se deklarimi i dëshmitarit është i besueshëm dhe në te e mbështetë aktgjykimin, ndërkaq po ta vlerësonte drejtë deklarimin ajo do të duhej të vinte në përfundim se deklarimi i tij është i gabuar

¹⁶⁰ Ejup Sahiti, vep. e cit., fq. 232.

¹⁶¹ Po aty.

¹⁶² Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 911.

dhe i rrejshëm dhe e kundërta.¹⁶³ Me fjalë të tjera, vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike përmban në vete kundërshtimin e rregullsisë së ekzistimit të përfundimeve mbi ekzistimin përkatësisht mos ekzistimin e fakteve. Kështu, gjendja faktike e vërtetuar në mënyrë të gabuar ka në ato raste kur ndonjë fakt vendimtar nuk është vërtetuar saktësisht. Vlerësimin nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar mund ta japë vetëm kolegji i gjykatës së shkallës së dytë me kusht që shqyrtimi i gjendjes faktike të jetë kërkuar me ankesë. Me rastin e vlerësimit nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar, gjykata e shkallës së dytë zbaton kriterin subjektiv ashtu që në bazë të kundërshtimeve të paraqitura në ankesë vlerëson nëse një fakt vendimtar i përgjigjet rezultateve të provave të shqyrtuara. Po ashtu, me këtë rast vlerëson nëse ndonjë fakt vendimtar do të vërtetohej më ndryshe po të nxirreshin edhe prova të tjera ose po të vërtetoheshin edhe fakte të tjera.¹⁶⁴ Kur gjykata e shkallës së dytë shqyrton bazueshmërinë e kundërshtimeve ankimore lidhur me pohimin nëse ndonjë fakt-indice ose ndonjë fakt ndihmëskontrollues është vërtetuar në mënyrë të gabuar, paraprakisht duhet të vërtetojë nëse këto fakte vërtetë janë vërtetuar në mënyrë të gabuar. Nëse gjykata vërteton se faktetindice ose fakte ndihmëse- kontrolluese janë vërtetuar në mënyrë të gabuar, atëherë duhet të vlerësojë nëse vlerësimi i gabuar i këtyre fakteve ka pas për pasojë nxjerrjen e përfundimit të gabuar lidhur me ekzistimin e faktit vendimtar.¹⁶⁵ Mirëpo, në rastet kur ndonjë indice-fakt ose fakt ndihmëskontrollues është vërtetuar në mënyrë të gabuar, por kjo nuk e vënë në pyetje vërtetimin e faktit vendimtar ngase ekzistimi faktit vendimtar p.sh. është vërtetuar me më shumë indice-fakte ose fakte ndihmëskontrolluese, në këtë rast gjykata e shkallës së dytë nuk mund të prish aktgjykimin e atakuar me ankesë. Nëse, Gjykata e Apelit, në të kundërtën do e anulonte aktgjykimin ajo në këtë rast jo vetëm që do të zbatonte kriterin objektiv, sipas të cilit mjafton që në fakt-indice ose fakti ndihmëskontrollues të vërtetohet në mënyrë të gabuar por njëkohësisht nuk do të vepronte në përputhje me dispozitën e nenit 386 paragrafi 2, sipas së cilës aktgjykimi mund të atakohet për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike vetëm kur ndonjë fakt vendimtar është vërtetuar gabimisht.¹⁶⁶

Gjykata e mjetit juridik duke vlerësuar vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike nuk vendos përfundimisht nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar, ngase ky vendim mund

¹⁶³ Afrim Shala, vep. e cit., fq. 120.

¹⁶⁴ Po aty.

¹⁶⁵ Po aty.

¹⁶⁶ Azem Hajdari, vep. e cit., fq. 143.

të merret vetëm në shqyrtimin gjyqësor në të cilin është vërtetuar gjendja faktike. Në të vërtetë, gjykata e cila vendos lidhur me mjetin juridik, mund të vendos vetëm se ekziston dyshim në rregullsinë e vërtetimit të gjendjes faktike, prandaj për t'u evituar ky dyshim duhet serish të rivërtetohet gjendja faktike. Format më të shpeshta të dyshimit në rregullsinë e vërtetimit të gjendjes faktike ekzistojnë kur gjykata: 1) nuk ka vlerësuar drejtë rezultatin e provave të nxjerra 2) nuk ka vlerësuar drejtë autenticitetin e provës, 3) nuk ka vlerësuar fare provën ose një pjesë të provave 4) nuk ka nxjerr përfundimet logjike lidhur me ekzistimin ose mos ekzistimin e faktit vendimtar nga faktet-indice 5) nuk ka marr parasysh të gjitha indicet dhe faktet ndihmëse-kontrolluese 6) nuk ka nxjerrë ndonjë provë të vërtetuar ndonjë fakt-indice ose fakt-ndihmës ose kontrollues.¹⁶⁷ Mirëpo, kur me ankesë atakohet aktgjykimi vetëm për shkak të rregullsisë së vërtetimit të një fakti vendimtar, gjykata e mjetit juridik ka të drejtë të dal jashtë suazave të ankesës duke e shqyrtuar tërësinë e fakteve të përmbajtura në atë pjesë të aktgjykimit në të cilën gjendet edhe fakti vendimtar që është objekt i ankimimit. Nga teksti ligjor me të cilin përcaktohet vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike si bazë për ankesë,¹⁶⁸ rezulton se vërtetimi i gabuar është një formë e vërtetimit jo të drejtë të gjendjes faktike dhe dyshimi në rregullsinë dhe besueshmërinë e vërtetimit të faktit vendimtar, formë tjetër e kësaj pa drejtësi. Në të vërtetë, këtu bëhet fjalë për të njëjtën situatë procedurale, përkatësisht dyshimin në drejtëshmërinë e vërtetimit të gjendjes faktike. Si formë tjetër e atakimit të aktgjykimit me ankesë është vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike. Kjo bazë e ankesës ekziston në rastet kur gjykata nuk ka vërtetuar ndonjë fakt të rëndësishëm.¹⁶⁹ Vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ekziston në rastet kur nuk është vërtetuar ndonjë fakt vendimtar që ka të bëjë me veprën penale, fajësinë, ose sanksionin juridiko penal ose kur nuk vërtetohet ndonjë fakt me karakter procedural penal. Kështu, në literaturë si fakte negative me karakter procedural theksohen ato fakte p.sh. nga të cilat varet vendimi i gjykatës për caktimin e kompetencës (vendi i kryerjes së veprës penale, vendbanimi ose vendqëndrimi i të pandehurit, vendimi mbi paraburgimin nëse ekziston rreziku nga ikja ose i ndikimit në dëshmitar, vendimi mbi përjashtimin e gjyqtarit nëse është i dëmtuar me vepër penale, ose është i afërm me gjyqtarin i cili ka zhvilluar hetimet, vendimi mbi ankesën (se është paraqitur pas skadimit të afatit etj)).¹⁷⁰ Në këtë kontekst, mos vërtetimin e faktit vendimtar duhet dalluar nga

¹⁶⁷ Azem Hajdari, vep. e cit., fq. 143.

¹⁶⁸ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 386 parag. 2.

¹⁶⁹ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 404 parag. 3.

¹⁷⁰ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 913.

vërtetimi negativ përkatësisht vërtetimi i mosekzistimit të faktit vendimtar. Në rastet e fakteve negative, duhet vërtetuar se një dukuri, një ngjarje një veprim nuk ka ekzistuar (p.sh. në literaturë theksohet rasti kur prindërit nuk e ushqejnë foshnjën dymuajshe dhe për këtë arsye foshnja vdes). Faktet negative provohen më vështirë se faktet pozitive. Konsiderohet se te vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike është pasojë e qasjes së gabuar juridike të gjykatës.¹⁷¹ Kështu, vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ekziston kur gjykata nuk e interpreton drejt kuptimin dhe përmbajtjen e dispozitës ligjore, ashtu që sipas rregullit, dispozitën e interpreton ngushtë dhe shumë rrallë në mënyrë të gjerë, përkatësisht i interpreton faktet në suaza të gabuara, të cilat sipas zbatimit të drejt të ligjit nuk janë fakte vendimtare.¹⁷² Formë tjetër tipike e vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike vjen në shprehje kur gjykata nuk ka vërtetuar qartë se cilin ligj duhet zbatuar dhe për shkak të këtij lëshimi nuk ka vërtetuar faktet vendimtare. Me fjalë të tjera, vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ekziston në ato raste kur gjykata disa fakte fare nuk i vërteton, ndonëse ka qenë e detyruar ose ka mund t'i vërtetojë ose i ka vërtetuar por në aktgjykim nuk i ka marrë parasysh, ose provat lidhur me faktet përkatëse nuk i ka nxjerr në tërësi ndonëse ka ditur për to (p.sh. ka refuzuar marrjen e ndonjë prove). Mirëpo, vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike nuk mund t'i përshkruhet gjithmonë gabimeve të gjykatës. Kjo ndodh edhe në ato raste kur gjykata gjatë procedurës provuese për disa fakte vendimtare dhe për disa prova nuk ka ditur dhe as nuk ka mundur ta dijë. Gjendja faktike jo e plotë në të tilla raste argumentohet me paraqitjen e fakteve dhe provave të reja (beneficium novorum).¹⁷³

4.4. Ankesa kundër aktgjykimit lidhur me vendimin mbi sanksionin penal dhe vendimeve të tjera

Ndaj aktgjykimit mund të ushtrohet ankesë lidhur me vendimin mbi shqiptimin e dënimit ose vërejtjes gjyqësore kur gjykata, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, përkundër mostejkalimit të kompetencave ligjore nuk e ka caktuar drejt dënimin ose vërejtjen gjyqësore. Ndaj aktgjykimit gjithashtu mund të ushtrohet ankesë kur gjykata ka zbatuar ose nuk ka zbatuar dispozitat për zbutjen ose lirimin nga dënimi apo të vërejtjes gjyqësore. Vendimi për masën e

¹⁷¹ Po aty.

¹⁷² Po aty.

¹⁷³ Po aty.

trajtimit të detyrueshëm rehabilitues të personave të varur nga droga ose alkooli ose për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale mund të kundërshtohet kur gjykata, përkundër faktit se nuk ka bërë shkelje të nenit 385, nën-paragrafi 1.5. i këtij Kodi, ka marrë vendim jo të drejtë ose nuk e ka shqiptuar masën e trajtimit të detyrueshëm me rehabilitim për personat e varur nga droga ose alkooli ose masën për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, përkundër ekzistimit të bazës ligjore për këtë.¹⁷⁴ Ndaj vendimit mbi shpenzimet e procedurës penale mund të ushtrohet ankesë kur gjykata për shpenzimet e tilla ka vendosur në mënyrë jo të drejtë ose në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi. Ndaj vendimit mbi kërkesën pasurore juridike ose vendimit mbi publikimin e aktgjykimit mund të ushtrohet ankesë kur gjykata për çështjet e tilla ka marrë vendim në kundërshtim me dispozitat ligjore.¹⁷⁵

Sipas dispozitës së nenit 387, paragrafi 1 kjo shkelje ekziston në rastet kur gjykata dënimin e përfshirë edhe dënimin me kusht (ndonëse dënimi me kusht nuk theksohet shprehimisht në nenin 387, paragrafi 1) ose vërejtjen gjyqësore i ka caktuar duke mos tejkaluar kompetencat ligjore nga neni 385, paragrafi 5, por megjithatë nuk i ka caktuar drejtë duke pasur parasysh rrethanat që ndikojnë në lartësinë e dënimit (që dënimi të jetë më i lartë ose më i ulët) ose vërejtjen gjyqësore ose për shkak se gjykata ka zbatuar ose nuk ka zbatuar dispozitat për zbutjen ose heqjen e dënimit apo vërejtjes gjyqësore përkundër ekzistimit të bazës ligjore për të marrë këto vendime. Për këtë arsye, sipas kësaj baze këto vendime të gjykatës mund të atakohen vetëm nëse nuk janë të drejta përkatësisht kur vendimi është shqiptuar në kuadër të ligjit por nuk i përgjigjet rrethanave të rastit. Këtë bazë të ankesës duhet dalluar nga baza e ankesës e përcaktuar në nenin 385, paragrafi 5, duke pasur parasysh se sipas nenit 387, paragrafi 1, sanksionet përkatëse janë shqiptuar në përputhje me ligjin, por duke mos i marrë parasysh rrethanat e rastit konkret. Ndërkaq, baza e ankesës sipas nenit 385, paragrafi 5, nënkupton rastet kur me vendimin lidhur me dënimin, dënimin alternativ (ndonëse dënimi me kusht nuk theksohet shprehimisht në nenin 387, paragrafi 1) ose vërejtjen gjyqësore është tejkaluar autorizimi ligjor.¹⁷⁶ Me fjalë të tjera, ankesa nga kjo bazë mund të paraqitet nëse gjykata ka shqiptuar sanksionin penal (dënimin, dhe vërejtjen gjyqësore), në përputhje me ligjin po duke mos ia përshtatur rastit konkret. Kështu, ankesë nga kjo bazë mund të paraqitet kur gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ose dënimit alternativ nuk e mate drejtë dënimin duke pasur parasysh rrethanat rënduese ose lehtësuese, të

¹⁷⁴ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 916.

¹⁷⁵ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 387.

¹⁷⁶ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 916.

cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i lartë ose më i ulët. Po ashtu, ankesë nga kjo bazë mund të paraqitet edhe në rastet kur gjykata ka zbatuar ose nuk ka zbatuar dispozitat për zbutjen¹⁷⁷ ose lirim nga dënimi¹⁷⁸ apo vërejtjes gjyqësore (neni 85 dhe 86 i KP) përkundër ekzistimit të bazës ligjore për të marrë këto vendime. Kështu, ankuesi parashtron ankesë sipas kësaj baze kundër aktgjykimit për vepër penale të vjedhjes së rëndë, për të cilën parashikohet dënimi me burgim prej 3 muajve deri në 7 vjet¹⁷⁹, ngase gjykata ka shqiptuar dënim prej gjashtë muajve ndonëse ka gjetur një mori të rrethanave rënduese dhe asnjë rrethanë lehtësuese. Në këtë rast gjykata, vërtetë, ka shqiptuar dënim në përputhje me ligjin por me rastin e shqiptimit të dënimit nuk ka marrë parasysh rrethanat rënduese që do të ndikonin në ashpërsim të dënimit.

Dispozitën e neni 387 paragrafi 1, ku theksohet se gjykata nuk ka zbatuar dispozitat lidhur me shqiptimin e vërejtjes gjyqësore ndonëse kanë ekzistuar kushtet për të marrë një vendim të tillë, nuk duhet kuptuar ashtu që gjykata është e detyruar që të shqiptojë vërejtjen gjyqësore kur plotësohen kushtet ligjore ose kur nuk ka pengesa ligjore. Ankuesi në ankesë mund të theksojë jo vetëm se kanë ekzistuar kushtet ligjore për shqiptim të vërejtjes gjyqësore por njëkohësisht se kanë ekzistuar edhe rrethanat përkatëse që në rastin konkret të shqiptohet vërejtja gjyqësore.¹⁸⁰ Përndryshe, kur gjykata shqipton vërejtjen gjyqësore edhe në rastet kur nuk kanë ekzistuar kushtet ligjore ose kur ka refuzuar ta shqiptojë vërejtjen gjyqësore edhe kur kanë ekzistuar kushtet formale për shqiptimin e saj, ekziston shkelja nga neni 385, paragrafi 5. Duhet theksuar se matja e dënimit paraqet një veprimtari tejte të ndërlikuar të gjykatës e cila përbëhet nga: 1) vërtetimi i fakteve- bazave për vendimin mbi dënimin, 2) subsumimi i fakteve-bazave për vendim mbi dënimin nën dispozitën ligjore, dhe 3) vlerësimin, nëse do të merret vendim ashtu siç parashikohet me dispozitat ligjore. Në këtë kontekst, faktet të cilat në aspektin procedural janë bazë për vendimin mbi dënimin, janë paraparë në nenin 73 të KP.¹⁸¹ Me fjalë të tjera, këto fakte janë rrethanë rënduese dhe lehtësuese. Këto fakte për kah rëndësia janë fakte vendimtare, të cilat duhet të provohen sikurse edhe faktet tjera vendimtare. Në rastet kur ekziston parregullsi në vërtetimin e këtyre fakteve, këtë të metë duhet evituar me ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, që për pasojë ka anulimin e aktgjykimit të atakuar. Ndërkaq, gabimet që kanë të bëjnë me subsumimin e fakteve bazë për vendim mbi dënimin, nën

¹⁷⁷ Kodi Penal i Kosovës, neni 76.

¹⁷⁸ Kodi Penal i Kosovës, neni 77.

¹⁷⁹ Kodi Penal i Kosovës, neni 327, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1.

¹⁸⁰ Afrim Shala, vep. e cit., fq. 128.

¹⁸¹ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 916.

dispozitën ligjore të theksuara nën pikën 2. përbën shkelje të ligjit penal nga neni 385, paragrafi 1 nënparagrafi 1.5. Prandaj, asnjë nga të metat e theksuara nën pikën 1 dhe 2 nuk përbën bazën për ankesë nga neni 387 paragrafi 1. Por, si bazë e ankesës nga neni 387 paragrafi 1 janë gabimet e theksuara nën 3. vlerësimi i fakteve- bazave për dënim në kuptim të nenit 73 të KP- rrethanave lehtësuese - rënduese. Analiza e bazave të ankesës nga neni 387 paragrafi 1 tregon se kjo parregullsi ka dy forma: 1) matja jo e drejtë e dënimit në kuptim të ngushtë dhe 2) gabimet gjatë zbatimit të dispozitave për zbutje të dënimit, lirim të dënimit, vërejtjes gjyqësore ose dënimit me kusht (ndonëse dënim me kusht nuk theksohet shprehimisht në nenin 387 paragrafi 1).¹⁸²

Sipas nenin 387 paragrafi 2, si objekt i atakimit me ankesë mund të jenë: 1) vendimi për masën e trajtimit të detyrueshëm rehabilitues të personave të varur nga droga ose alkooli ose 2) vendimi për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale. Masa për trajtim të detyrueshëm rehabilitues të personave të varur nga droga parashikohet me dispozitën e nenit 91 të KP ndërkaq, masa e dobisë pasurore të fituar me vepër penale me dispozitën e nenit 96 dhe 97 të KK. Vendimi i cili mund të atakohet nga kjo bazë e ankesës mund të jetë vetëm vendimi i pa drejtë por jo edhe vendimi i paligjshëm. Vendimet e paligjshme janë bazë e atakimit të aktgjykimit për shkak të shkeljeve të ligjit penal nga neni 385, paragrafi 1 nënparagrafi 1.5. Sipas kësaj dispozite vendimet në fjalë mund të atakohen nëse janë të pa drejta sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike dhe rrethanave të rastit konkret por jo edhe nëse ekziston shkelja e ligjit penal nga neni 385, paragrafi 5. Marrja e dobisë pasurore është e detyrueshme sipas nenit 96 dhe 97 të KP. Ndërkaq, lidhur me vendimin për konfiskimin e dobisë pasurore duhet të vërtetohen faktet që përbëjnë realizimin e dobisë pasurore me vepër penale. Me fjalë të tjera, sipas kësaj baze të ankesës aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë mund të atakohet si në rastet kur masat në falë janë shqiptuar në mënyrë të padrejtë në kuptimin e përshkruar më sipër ashtu edhe në rastet kur nuk janë shqiptuar fare, ndonëse kanë ekzistuar kushtet ligjore për shqiptimin e tyre.¹⁸³

Sipas nenit 387, paragrafi 3, si objekt i atakimit me ankesë mund të jetë vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale. Për dallim nga dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni ku objekt i ankesës mund të jetë vetëm vendimi i padrejtë, sipas paragrafit 3 të këtij neni, objekt i ankesës mund të jetë jo vetëm kur vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i padrejtë por edhe kur vendimi i tillë është i paligjshëm. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

¹⁸² Po aty fq. 917.

¹⁸³ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 918.

mund të atakohet si në rastet kur është vërtetuar në mënyrë të gabuar ose jo të plotë gjendja faktike sa i përket fakteve nga të cilat varet vendimi për shpenzimet e procedurës penale ashtu edhe në rastet kur janë shkelur dispozitat e procedurës penale lidhur me shpenzimet e procedurës penale (neni 458-466). Ndërkaq, të metat lidhur me shpenzimet e procedurës penale jashtë këtyre rasteve nuk përbëjnë bazën e ankesës nga neni 387, paragrafi 3. Sipas paragrafit 3 të këtij neni lejohet atakimi i vendimit mbi shpenzimet e procedurës penale edhe kur vendimi i tillë është marrë në kundërshtim me dispozitat e KPP. Kjo për arsye se këto shkelje nuk mund të subsumohen në shkelje të dispozitave të ligjit penal, ngase materia që po shqyrtohet nuk është e karakterit penal. Prandaj, sikur me këtë dispozitë të mos lejohej e drejta në ankesë kundër vendimit mbi shpenzimet e procedurës penale, ankuesi praktikisht do të privohej nga e drejta për ta atakuar vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale si të paligjshëm.¹⁸⁴

Si baza të veçanta të ankesës, sipas nenit 387, paragrafi 4, janë vendimi mbi kërkesën pasurore juridike dhe vendimi mbi shpalljen e aktgjyqimit nëpërmjet shtypit, radios ose televizionit. Për të ushtruar ankesë nga këto baza kërkohet që vendimet në fjalë të jenë përveç të padrejta të jenë marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore, nëse është marrë në kundërshtim me dispozitat nenit 458-466 KPP, ndërkaq kur është fjala për vendimin mbi shpalljen e aktgjyqimit nëpërmjet shtypit, radios ose televizionit, vendimi është i paligjshëm kur është marrë në kundërshtim me dispozitat e nenit 61 të KP.¹⁸⁵ Por, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është i paligjshëm edhe kur janë shkelur dispozitat e të drejtës pasurore. Ankesë ndaj aktvendimit mbi kërkesën pasurore juridike mund të paraqesin i pandehuri, përkatësisht mbrojtësi i tij dhe përfaqësuesi ligjor kur me aktgjykim dënues i pandehuri detyrohet të përmbush kërkesën pasurore plotësisht ose pjesërisht dhe i dëmtuari. Në funksion të realizimit të mbrojtjes, të pandehurit i mundësohet e drejta në ankesë për ta atakuar vendimin mbi kërkesën pasurore juridike. Lidhur me vendimin mbi shpalljen e aktgjyqimit nëpërmjet shtypit, radios ose televizionit, si bazë e ankesës vlen ajo që është thënë në komentet hyrëse të nenit 387, se vendimin mbi publikimin e aktgjyqimit, pasi sipas KP paraqet njërin nga dënimet plotësuese, si i tillë nuk e ka vendin në këtë grup të arsyeve të ankesës dhe nuk duhet të theksohet në mënyrë të

¹⁸⁴ Po aty.

¹⁸⁵ Po aty.

veçantë as në këtë dispozitë e as në dispozitat tjera ngase është përfshihet me nocionin e dënimeve nga paragrafi 1 i këtij neni.¹⁸⁶

5. Ankesa si mjet i rregullt juridik në praktikën e Gjykatës Themelore Gjilan Dega në Viti për periudhën 2019-2022

5.1. Numri i rasteve të paraqitjes së ankesës në Gjykatën Themelore Gjilan dega në Viti për periudhën kohore 2019-2022

Shqiptimi i ankesës si mjet i rregullt juridik është me numër të madh i paraqitur në Gjykatën Themelore Gjilan dega në Viti. Kështu, bazuar në numrin e paraqitjes së ankesës në këtë gjykatë për periudhën hulumtuese kemi ecurinë si vijon:¹⁸⁷

Tabela nr. 1. Numri i rasteve të paraqitjes së ankesës në Gjykatën Themelore Gjilan dega në Viti për periudhën kohore 2019-2022

Vitet	Numri i përgjithshëm i shqiptimit të masës së dorëzarisë
2019-2022	1.281 raste

Nga kjo pasqyrë tabelare nr.1 shihet se numri i përgjithshëm i paraqitjes së ankesës, në Gjykatën Themelore Gjilan dega në Viti, ishte me numër të madh i pranishëm në periudhën kohore 2019-2022, ku gjatë kësaj periudhe ankesa është paraqitur gjithësej në 1.281 raste.

¹⁸⁶ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 919.

¹⁸⁷ Statistikat e marrura në Gjykatën Themelore Gjilan dega në Viti, për periudhën kohore 2019-2022.

5.2. Dinamika e rasteve të paraqitjes së ankesës në Gjykatën Themelore Gjilan dega në Viti për periudhën kohore 2019-2022

Sipas statistikave të marrura në Gjykatën Themelore Gjilan dega në Viti, vlerësohet se në përmasa të mëdha shikuar sipas viteve, për çdo vit mesatarisht në këtë gjykatë paraqiten 200 deri në 300 raste të ankesave. Sipas të dhënave të mbledhura për periudhën kohore 2019-2022, paraqitja e ankesës ishte në numër të madh. Kështu, bazuar në dinamikën e paraqitjes së ankesës në këtë gjykatë sipas viteve për këtë periudhë kohore kemi ecurinë si vijon:¹⁸⁸

Tabela nr.2. Dinamika e rasteve të paraqitjes së ankesës në Gjykatën Themelore Gjilan dega në Viti për periudhën kohore 2019-2022

Viti	Numri i paraqitjes të ankesës	Të shprehura në përqindje
2019	295 raste	23 %
2020	324 raste	25 %
2021	357 raste	27 %
2022	305 raste	23 %
Gjithsej:	1.281 raste	100 %

Nga kjo pasqyrë tabelare nr.2 shihet se paraqitja e ankesës në këtë Gjykatë gjatë periudhës së hulumtuar kohore ka shënuar rënie dhe ngritje sipas viteve të caktuara, e që është determinuar nga prezenca e faktorëve të shumtë në paraqitjen e këtij mjeti. Kështu, në vitin 2019 ankesa është paraqitur në 295 raste, në vitin 2020 ka pasur ngritje të theksuar të paraqitjes së ankesës në 324 raste, në vitin 2021 vërehet një rritje edhe më e madhe e paraqitjes së ankesës në 357 raste, në vitin 2022 ankesa është paraqitur në 305 raste.

¹⁸⁸ Po aty.

5.3. Personat të cilët kanë paraqitur ankesë në Gjykatën Themelore Gjilan dega në Viti për periudhën kohore 2019-2022

Bazuar në atë se kush ka paraqitur ankesë në këtë Gjykatë për këtë periudhë kohore kemi ecurinë si vijon:¹⁸⁹

Tabela nr.3. Personat të cilët kanë paraqitur ankesë në Gjykatën Gjilan dega në Viti për periudhën kohore 2019-2022

Ankuesi	Numri i paraqitjes
I akuzuari	969 rsste
Mbrojtësi	207 raste
I dëmtuari	54 raste
Prokurori i Shtetit	51 raste
Gjithësej:	1.281 raste

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr.3, që u referohet personave të cilët kanë paraqitur ankesë në Gjykatën Themelore Gjilan dega në Viti gjatë periudhës hulumtuese, rezulton se më së shumti kanë paraqitur ankesë të akuzuarit me 969 raste, mbrojtësit me 207 raste, i dëmtuari me 54 raste dhe Prokurori i Shtetit me 51 raste.

¹⁸⁹ Po aty.

KAPITULLI III

PROCEDURA SIPAS ANKESËS

1. Procedura për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit

Ankesa kundër aktgjykimit paraqitet në gjykatën e cila ka nxjerr aktgjykimin. Kjo gjykatë i dërgon një kopje të ankesës palëve kundërshtare, të cilat mund të paraqesin përgjigje në ankesë brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i kopjes së ankesës. Kjo gjykatë i përcjell ankesën, përgjigjën dhe shkresat tjera përkatëse në gjykatën që është kompetente për shqyrtimin e ankesës. Ankesa apo kërkesa nga ky nen paraqitet në numër të mjaftueshëm të kopjeve për gjykatën dhe palët kundërshtare.¹⁹⁰ Ankesa i paraqitet gjykatës themelore e cila e ka marr aktgjykimin. Në rastet kur ankesa i paraqitet drejtpërdrejtë Gjykatës së Apelit, ajo ankesën e tillë ia drejton gjykatës themelore. Në të njëjtën mënyrë do të veprojë edhe gjykata jokompetente ose organi tjetër. Ankesa e tillë do të konsiderohet se është dorëzuar me kohë nëse gjykatës kompetente i arrin gjatë afatit të ankesës.¹⁹¹ Ndërkaq, në rastet kur ankesa për shkak të mosdijes ose të gabimit të qartë të dërguesit i është dërguar gjykatës jokompetente para kalimit të afatit, do të konsiderohet se është dorëzuar me kohë, edhe pse gjykatës kompetente i arrin pas afatit të ankesës.¹⁹²

Ankesa përveç me shkrim mund të paraqitet edhe në procesverbal vetëm para gjykatës themelore.¹⁹³ Ankesa mund të dorëzohet në mënyra të ndryshme (postës rekomande, telegramit ose ndonjë mjet tjetër- teleks, telefaks etj). Në rastet kur i pandehuri gjendet në paraburgim ankesën mund ta jep në procesverbal para gjykatës ose t'ia dorëzojë drejtorisë së burgut. Ndërkaq, personi i cili është duke e mbajtur dënimin ose masën tjetër, deklaratën e tillë mund t'ia dërgojë drejtorisë së institucionit në të cilin është vendosur.¹⁹⁴ Në rastet kur i akuzuari ka më

¹⁹⁰ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 388.

¹⁹¹ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 380 parag. 1.

¹⁹² Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 445 parag. 3.

¹⁹³ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 442 parag. 1.

¹⁹⁴ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 445 parag. 4.

shumë mbrojtës¹⁹⁵ nuk kërkohet që ankesa t'i dorëzohet çdo njërit prej tyre, por mjafton që ankesa t'i dorëzohet njërit prej tyre.¹⁹⁶

Gjykata themelore ua dërgon palëve kundërshtare ankesën. Sipas paragrafit 2 të këtij neni, të drejtë në paraqitje të përgjigjes në ankesë kanë ekskluzivisht palët. Këtë të drejtë e ka edhe mbrojtësi i të pandehurit dhe i dëmtuari në rastet kur ka të drejtë në ankesë. Asnjë subjekt tjetër nuk e gëzon të drejtën për të paraqitur përgjigjen në ankesë. Sepse, sipas kësaj dispozite, në mënyrë shprehimore kërkohet që ankesa t'i dërgohet palës kundërshtare, në bazë të rregullës *agumentum a contrario* rezulton se ankesa nuk i dërgohet palës identike për të dhënë përgjigjen në ankesë p.sh. ankesa e njërit të akuzuar të akuzuarit tjetër dhe mbrojtësit të tij, ose ankesa e të dëmtuaritprokurorit të shtetit.¹⁹⁷ Kjo dispozitë është shprehje e realizimit të parimit kontradiktor (*adiatur et altera pars*) në këtë fazë të procedurës penale e cila është kryesisht me shkrim. Me realizimin e këtij parimi, pala kundërshtare mëson për ekzistimin dhe përmbajtjen e ankesës. Kështu, duke pasur të njohur përmbajtjen e ankesës, pala kundërshtare mund të paraqesë përgjigje ndaj ankesës në të cilën i paraqet kundër argumentet duke i përfaqësuar të drejtat dhe interesat e veta në procedurën lidhur me ankesën. Në anën tjetër, mendimi i parashtruar në përgjigje në ankesë lidhur me çështjet faktike dhe juridike, i ndihmon Gjykatës së Apelit të marrë qëndrim objektiv lidhur me ankesën dhe aktgjykimin e atakuar.¹⁹⁸ E drejta për të dhënë përgjigje në ankesën e palës kundërshtare, ekziston pavarësisht nga shkaqet e ankesës. Mirëpo, në rastet kur përgjigja në ankesë është dhënë brenda afatit të ankesës, përgjigjen e tillë duhet konsideruar si ankesë ose plotësim të ankesës. Pala mund të heqë dorë nga e drejta në përgjigje në ankesë edhe para se t'i dorëzohet ankesa e palës kundërshtare. Po ashtu, pala mund të tërhiqet nga përgjigja ndaj ankesës të cilën e ka parashtruar kohë më parë. Sipas paragrafit 2 të këtij neni, afati për të paraqitur përgjigjen ndaj ankesë është tetë ditë nga dita e pranimit. Mirëpo në rastet kur ankesa paraqitet jashtë këtij afati, përgjigja e tillë nuk hedhet por i dërgohet Gjykatës së Apelit, e cila e merr në shqyrtim nëse nuk ka përfunduar procedura lidhur me ankesë.¹⁹⁹ Gjykata themelore përgjigjen ndaj ankesës ia dërgon Gjykatës së Apelit, por njëkohësisht nuk ia dërgon parashtruesit të ankesës. Duke qenë se përgjigja ndaj ankesës i mundëson palës kundërshtare dhe mbrojtësit që të deklarohet lidhur me ankesën, përmbajtja e përgjigjes ndaj ankesës sillet

¹⁹⁵ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 55 parag. 2.

¹⁹⁶ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 478 parag. 5.

¹⁹⁷ Ejup Sahiti, vep. e cit., fq. 187.

¹⁹⁸ Afrim Shala, vep. e cit., fq. 157.

¹⁹⁹ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 920.

parimisht në kufijtë e pretendimeve ankimore, me qëllim që ato të kontestohen, mbështetën ose të tregohen më ndryshe nga ato të paraqitura në ankesë. Për këtë arsye, në procedurën lidhur me ankesën vendoset lidhur me ankesën dhe jo lidhur me përgjigjen ndaj ankesës. Konsiderohet se ky konstatim del edhe nga dispozita e nenit 394, sipas së cilës parimisht Gjykata e Apelit e shqyrton aktgjykimin në pjesën për të cilën është ushtruar ankesë. Përveç kësaj, konsiderohet se ky konstatim gjen mbështetje edhe në nenin 398. Konsiderohet se shkelja e të drejtës në përgjigje në ankesë përbën shkelje relative të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2. Por, ka raste kur shkelja e së drejtës në përgjigje në ankesë, në praktikën gjyqësore është marrë si shkelje absolute e dispozitave të procedurës penale (p.sh. Gjykata Supreme e Kroacisë).²⁰⁰

Sipas paragrafit 4 të këtij neni, ankesa apo kërkesa duhet të paraqitet në numër të mjaftueshëm të kopjeve për gjykatën dhe palët kundërshtare. Mirëpo, kur ankesa nuk është dorëzuar në numër të mjaftueshëm kopjesh, gjykata e fton paraqitësin që në afat të caktuar të dorëzojë kopje të mjaftueshme. Ndërkaq, nëse parashtuesi i ankesës nuk e përmbush këtë detyrim brenda afatit të caktuar, ankesa do të shumëzohet me shpenzime të parashtuesit të ankesës.²⁰¹ Gjykata e cila e pranon ankesën nuk mund ta refuzojë pranimin ankesës edhe kur nga ankesa shihet qartë se ajo është pa afat, e palejueshme ose e pa bazuar. Për më tepër, ankesën e tillë gjykata është e detyruar ta pranojë ngase vet pranimi i ankesës përbën vetëm një veprim teknik të cilin duhet dalluar nga veprimi i vendosjes lidhur me afatshmërinë, përkatësisht lejueshmërinë e saj. Pas pranimi, ankesa mund të hidhet nga Gjykata e Apelit, sipas nenit 400 të KPP-së në fuqi e jo nga gjykata themelore përkatësisht gjykata e shkallës së parë siç parashihej sipas KPP-së të mëparshëm.²⁰²

2. Procedura lidhur me ankesën kundër aktgjykimit në gjykatën e apelit

Kur Gjykata e Apelit pranon lëndën me ankesë, ato ia dorëzon kryetarit të kolegjit të caktuar sipas orarit të gjykatës. Kryetari i kolegjit të apelit cakton seancën e kolegjit. Me rastin e kthimit të lëndës, prokurori i shtetit mund të paraqesë propozim ose të deklarojë se atë do ta paraqesë në seancën e kolegjit të apelit. Gjyqtari raportues, sipas nevojës, mund të kërkojë nga gjykata

²⁰⁰ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 920.

²⁰¹ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 443 parag. 2.

²⁰² Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 921.

themelore raport për shkeljen e dispozitave të procedurës penale, e nëpërmjet kësaj gjykate ose në ndonjë mënyrë tjetër të vërtetojë pretendimet e ankesës lidhur me provat dhe faktet e reja ose ai siguron raportet dhe dokumentet e nevojshme nga organet ose nga persona të tjerë juridikë. Nëse i akuzuari është në paraburgim, gjyqtari raportues brenda pesë (5) ditësh pas pranimit të shkresave të lëndës shqyrton sipas detyrës zyrtare nëse ende ekzistojnë arsyet për mbajtje në paraburgim.²⁰³ Kur të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgim, njoftimi për seancën e kolegjit të apelit I dërgohet prokurorit kompetent të shtetit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij. Në qoftë se i akuzuari i cili gjendet në paraburgim ose në mbajtje të dënimit dëshiron të marrë pjesë në seancë, pjesëmarrja i mundësohet atij. Seanca e kolegjit fillon me raportim të gjyqtarit raportues mbi faktet. Kolegji mund të kërkojë nga palët dhe mbrojtësi që prezantojnë në seancë sqarime të nevojshme lidhur me pretendimet e tyre në ankesë. Palët dhe mbrojtësi mund të propozojnë që për plotësim të raportit të lexohet ndonjë shkresë dhe mund të japin shpjegime të nevojshme për qëndrimet e tyre në ankesë apo përgjigje në ankesë, pa përsëritur përmbajtjen e raportit. Mosardhja e palëve të njoftuara me rregull nuk pengon mbajtjen e seancës së kolegjit. Kur i akuzuari nuk e ka njoftuar gjykatën për ndërrimin e adresës ose të vendqëndrimit, seanca e kolegjit mund të mbahet edhe pa njoftimin e të akuzuarit. Publiku mund të përjashtohet nga seanca e kolegjit që mbahet me prani të palëve vetëm nën kushtet e parapara me këtë kod. Procesverbali i seancës i bashkëngjitet shkresave të gjykatës. Aktvendimet nga nenet 399 dhe 400 të këtij Kodi mund të merren edhe pa njoftimin e palëve për seancën e kolegjit.²⁰⁴ Gjykata e Apelit merr vendim në seancë të kolegjit ose në shqyrtim. Gjykata e Apelit në seancë të kolegjit vendos nëse do ta mbajë shqyrtimin.²⁰⁵

Shqyrtimi para Gjykatës së Apelit mbahet vetëm kur është e nevojshme që, për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, të merren prova të reja ose të përsëriten provat e marra më parë dhe kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme që lënda të mos i kthehet gjykatës themelore në rigjykim. Në shqyrtim të Gjykatës së Apelit thirren i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, prokurori i shtetit, i dëmtuari, përfaqësuesi ligjor dhe përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit, si dhe dëshmitarët dhe ekspertët të cilët gjykata me propozim të palëve apo sipas detyrës zyrtare vendos t'i pyesë. Në qoftë se i akuzuari gjendet në paraburgim ose në mbajtje të dënimit, kryetari i trupit gjykues i Gjykatës së Apelit ndërmerr masa të nevojshme për të siguruar

²⁰³ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 389.

²⁰⁴ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 390.

²⁰⁵ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 391.

praninë e të akuzuarit në shqyrtim.²⁰⁶ Shqyrtimi para Gjykatës së Apelit fillon me raportim të gjyqtarit raportues, i cili paraqet gjendjen faktike pa dhënë mendimin e tij për bazueshmërinë e ankesës. Aktgjykimi ose pjesa e tij për të cilën është ushtruar ankesë, dhe sipas nevojës, edhe procesverbali i shqyrtimit gjyqësor lexohet me propozim ose sipas detyrës zyrtare. Pas kësaj thirret ankuesi ta arsyetojë ankesën dhe pastaj pala kundërshtare që t'i përgjigjet. i akuzuari dhe mbrojtësi i tij gjithmonë e kanë fjalën të fundit. Palët gjatë shqyrtimit mund të paraqesin prova dhe fakte të reja. Prokurori i shtetit, mbështetur në rezultatet e shqyrtimit, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga aktakuza ose ta ndryshojë atë në dobi të të akuzuarit.²⁰⁷

Gjykata e Apelit shqyrton aktgjykimin në pjesën për të cilën është ushtruar ankesë, por çdo herë sipas detyrës zyrtare shqyrton:

- nëse ekziston shkelje e dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafët 1.1., 1.2., 1.6. dhe 1.8. deri në 1.12. të këtij Kodi;
- nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në mungesë të të akuzuarit në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi;
- nëse në çështjen e mbrojtjes së detyrueshme është mbajtur shqyrtimi gjyqësor pa praninë e mbrojtësit; dhe
- nëse është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit.

Nëse ankesa e paraqitur në dobi të të akuzuarit nuk përfshin të dhënat nga neni 382, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. ose 1.3. i këtij Kodi, Gjykata e Apelit kufizohet vetëm në shqyrtimin e shkeljeve nga paragrafi 1. Nënparagrafët 1.1. deri në 1.4. të këtij neni dhe në shqyrtimin e vendimit për dënimin, caktimin e masës për trajtim të detyrueshëm për rehabilitim dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale.²⁰⁸

Praktika gjyqësore

“Gjykata e shkallës së dytë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nëse nuk ka vendosur për të gjitha ankesat kundër aktgjykimit të njëjtë”. (Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të M.Zi, Kzp.br.123/09, dt.11.11.2009.)

“Gjykata e shkallës së dytë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale kur ka lëshuar rastin që për seancën e Kolegjit ta informojë të akuzuarin i cili në ankesë ka propozuar mbajtjen e shqyrtimit para gjykatës së shkallës së dytë”

²⁰⁶ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 392.

²⁰⁷ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 393.

²⁰⁸ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 393.

(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të M.Zi, Kzz.br.12/09, dt.26.09.2009.)

2.1. Reformatio in Peius

Ndalimi reformatio in peius përbën privilegjin më të rëndësishëm të të pandehurit, që gjen zbatim në procedurën sipas mjeteve juridike. Këtë privilegj e parashikojnë shumica e legjislacioneve bashkëkohore. Mirëpo, kushtet dhe vëllimi i zbatimit të këtij institucioni janë të rregulluara në mënyra të ndryshme në legjislacionet bashkëkohore proceduralo penale. Përveç kësaj, përmbajtja e këtij institucioni varet nga rregullimi i mjeteve juridike dhe i pozitës që ka i pandehuri në përgjithësi në procedurën penale sipas legjislacionit të shtetit përkatës. Përmbajtja konkrete e kësaj lehtësie të rëndësishme parashikohet nga ligjet e procedurës penale të vendeve të veçanta. Thelbi i këtij institucioni qëndron në faktin se, në kushtet e caktuara, ndalohej ndryshimi i vendimit gjyqësor të kundërshtuar, përkatësisht keqësimi i pozitës procedurale në dëm të të pandehurit, në rastet kur është paraqitur mjeti juridik vetëm në favor të tij. Ndalimi reformatio in peius i përcaktuar në këtë mënyrë është një përjashtim i rëndësishëm nga parimi i kërimit të së vërtetës në procedurën penale. Rregullimi i ndryshëm i këtij institucioni, përkatësisht çështjeve të caktuara lidhur me ndalimin reformatio in peius në legjislacionet e sotme tërheq vëmendjen si të teorisë, ashtu edhe të praktikës.²⁰⁹

Në dispozitën nenit 395, përcaktohet kuptimi i ndalimit reformatio in peius. Në të vërtetë, me këtë dispozitë parashikohet që në rastet kur ankesa është paraqitur vetëm në favor të të pandehurit, aktgjykimi nuk mund të ndryshohet në dëm të tij për sa i përket vlerësimit juridik të veprës, ashtu edhe në lidhje me sanksionin e dhënë penal. Megjithatë, një përkufizim i tillë i këtij institucioni krijon dilema të caktuara rreth interpretimit të vetë dispozitës me të cilën përcaktohet ky institut. akuzuarit se ankimi i bërë në favor të tij nuk mund të veprojë në dëm të tij. Me fjalë të tjera në themel të ndalimit reformatio in peius qëndrojnë arsyet e drejtësisë dhe nevoja procedurale për t'i dhënë të pandehurit liri të plotë në paraqitjen e mjeteve të caktuara juridike dhe për ta siguruar se me mjetin e paraqitur juridik në favor të tij nuk do të keqësohet pozita e tij në procedurën penale. Pra arsyetimin e zbatimit të këtij favorit duhet kërkuar në qëndrimin human ndaj të pandehurit, të cilit në procedurën e zhvilluar sipas mjeteve juridike duhet t'i lejohet e drejta e mbrojtjes dhe liria e plotë, përkatësisht siguria procedurale që me mjetin juridik

²⁰⁹ Afrim Shala, vep. e cit., fq. 180.

të paraqitur në të mirë të tij nuk mund të keqësohet pozita e tij, në të cilën ndodhej para përdorimit të mjetit të caktuar juridik. Lirimi nga kjo frikë është supozimi i parë që ankimi të jetë një mjet i mbrojtjes së të pandehurit në procedurën penale.²¹⁰

Praktika gjyqësore

“Nëse ankesa është ushtruar vetëm në dobi të pandehurit, aktgjykimi nuk guxon të ndryshohet në dëm të tij në aspektin e cilësimit të veprës penale dhe sanksionit penal”.

(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të M. të Zi, Kzp.br.25/10, dt.15.3.2010.)

“Është e vërtetë që me ankimin e tij, të pandehurit nuk mund t’i rëndohet pozita, por ky parim shërben si garanci kur mjetin e ankimit e ka përdorur i pandehuri dhe nuk mund të shërbejë si i tillë kur mjetin e ankimit e ka përdorur prokurori. Atë që nuk mund ta bënte në rastin konkret gjykata e apelit për shkak të kufizimit procedural, të parashikuar nga neni 425/3 i Kodit të Procedurës Penale, e realizoi Gjykata e Lartë, e cila sipas nenit 432 pranon rekursin kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të apeleve e të rretheve dhe vendos për çështjet ligjore sipas neneve 434 e 441 të KPP.”

(Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë nr. 96 të dt. 27.07.2001, pjesë e botuar në “KPP me praktik gjyqësore”, Tiranë 2008, fq. 471/472.)

2.2. Efekti shtesë i ankesës së paraqitur për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike ose shkeljes së ligjit penal

Ankesa e paraqitur në dobi të të akuzuarit për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, ose për shkak të shkeljes së ligjit penal përfshin edhe ankesën kundër vendimit lidhur me dënimin, trajtimin e detyrueshëm për rehabilitim dhe marrjen e dobisë pasurore të fituar me vepër penale.²¹¹ Me këtë dispozitë përcaktohet se ankesa e paraqitur për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, ose për shkak të shkeljes së ligjit penal në dobi të të akuzuarit, përfshinë edhe ankesën kundër vendimit lidhur me dënimin, trajtimin e detyrueshëm për rehabilitim dhe marrjen e dobisë pasurore të fituar me vepër

²¹⁰ Azem Hajdari, vep. e cit., fq. 241.

²¹¹ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 396.

penale.²¹² Në të vërtetë, në këtë rast vlen prezumimi se nëse parashtruesi i ankesës nuk është i kënaqur me gjendjen faktike përkatësisht me zbatimin e dispozitave materiale juridike penale, atëherë më pak është i kënaqur me dënimin, trajtimin e detyrueshëm për rehabilitim dhe marrjen e dobisë pasurore të fituar me vepër penale. Për këtë arsye, me këtë dispozitë, parashikohet veprimi i zgjeruar i ankesës bazuar në favor defensionis, në rastet kur i akuzuari, mbrojtësi i tij dhe prokurori i shtetit, (ky i fundit ndonëse shumë rrallë në praktikë - neni 381 paragrafi 2 dhe 5) paraqesin ankesë në dobi të të akzuarit. Duhet theksuar se sipas kësaj dispozite veprimi i zgjeruar ka vetëm ankesa për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal e paraqitur ekskluzivisht në dobi të të akzuarit, pa marr para sysh se cili bartës i ankesës e ka parashtruar ankesën. Si mund të shihet, veprimi i zgjeruar ka të bëjë vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin, trajtimin e detyrueshëm për rehabilitim ose marrjen e dobisë pasurore por jo edhe me vendimet të tjera të aktgjyqimit siç janë: shpenzimet e procedurës penale, kërkesa pasurore juridike dhe vendimi mbi shpalljen e aktgjyqimit nëpërmjet shtypit dhe radios. Kolegji i Gjykatës së Apelit së pari vendos për bazueshmërinë e ankesës së tillë dhe nëse vlerëson se ajo është e pabazuar ose se është e bazuar vetëm sa i përket shkeljeve të ligjit penal, më pastaj vendos në kuptim të dispozitës së nenit 396, që të marrë në shqyrtim vendimin lidhur me dënimin, trajtimin e detyrueshëm për rehabilitim dhe marrjen e dobisë pasurore të fituar me vepër penale. Me fjalë të tjera, Gjykata e Apelit, duke refuzuar ankesën si të pa bazuar lidhur me shkeljet e ligjit penal dhe gjendjes faktike sipas detyrës zyrtare mund të ndryshojë aktgjykimin e gjykatës themelore në mbështetje të nenit 394, dhe të nenit 396. Ndërkaq, nëse kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se ankesa e tillë është e bazuar sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike në këtë rast me aktvendim e prish aktgjykimin e gjykatës themelore dhe urdhëron mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.²¹³

Në këtë rast, në kuptim të kësaj dispozite nuk mund të shqyrtohet vendimin lidhur me dënimin, trajtimin e detyrueshëm për rehabilitim dhe marrjen e dobisë pasurore të fituar me vepër penale. Kur Gjykata e Apelit duke vendosur përkitazi me ankesën për shkak të gjendjes faktike ose të shkeljeve të ligjit penal, nuk e shqyrton edhe vendimin lidhur me dënimin, trajtimin e detyrueshëm për rehabilitim dhe marrjen e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, konsiderohet se ka bërë shkelje nga neni 384, paragrafi 2.

²¹² Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 378.

²¹³ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 398, paragrafi 1 nënparagrafi 1.3.

2.3. Beneficium Cohesionis

Kur me rastin e paraqitjes së ankesës së cilitdo të akuzuar, Gjykata e Apelit çmon se arsyet për të cilat ka marrë vendim në dobi të të akuzuarit, e që nuk janë të natyrës personale, shkojnë në dobi edhe të ndonjërit nga të bashkakuzuarit i cili nuk ka paraqitur ankesë ose nuk e ka paraqitur në atë drejtim, gjykata vepron sipas detyrës zyrtare sikurse ankesa e tillë të ishte paraqitur edhe nga i bashkakuzuari.²¹⁴ Beneficium cohesionis bën të mundshëm veprimin e zgjeruar të një mjeti të caktuar juridik mbi bashkë të pandehurit që nuk e kanë paraqitur këtë mjet juridik, në qoftë se janë plotësuar kushtet e caktuara me ligj. Prandaj për zbatimin e beneficium cohesionis duhet të plotësohen këto kushte: që vendimi gjyqësor të jetë dhënë në bazë të mjetit juridik të paraqitur në favor të të pandehurit dhe që arsyet e këtij vendimi të favorshëm të ekzistojnë edhe për të bashkëpandehurin, i cili nuk ka paraqitur ndonjë mjet juridik apo një mjet i tillë nuk është ushtruar në lidhje me të. KPP i Kosovës përmban disa dispozita që rregullojnë aplikimin e beneficium cohesionis. Ky favor së pari parashikohet në procedurën sipas mjeteve të rregullta juridike, kurse në procedurën me mjete të jashtëzakonshme juridike vetëm te kërkesa e rishikimit dhe e mbrojtjes së ligjshmërisë. Pra, ky institucion parashikohet shprehimisht te ankimi kundër aktgjykimit, te rishikimi²¹⁵ dhe në procedurën sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.²¹⁶

Është e qartë se zbatimi i kësaj lehtësie parashikohet në procedurën sipas mjeteve juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme, gjë që njëherazi kërkon shqyrtimin e posaçëm të këtij institucioni në secilën procedurë. Kjo do të thotë se natyra juridike e kësaj lehtësie është e ndryshme te mjetet e caktuara juridike, ashtu sikurse janë të ndryshme edhe kushtet për zbatimin e saj në raport me të bashkëpandehurin. Kështu Kodi i procedurës penale në nenin 397 ka përcaktuar nocionin e këtij institucioni dhe e ka rregulluar në atë mënyrë që, kur Gjykata e Apelit në lidhje me ankimin, konstaton se arsyet të cilat nuk janë plotësisht të natyrës personale, për të cilat e ka dhënë vendimin, shkojnë në favor të të akuzuarit apo të ndonjërit prej të bashkakuzuarve që nuk ka bërë ankim ose nuk e ka bërë për këtë qëllim, ajo vepron kryesisht sikur i bashkakuzuari të kishte paraqitur një ankim të tillë.²¹⁷ Nga kjo del se beneficium

²¹⁴ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 397.

²¹⁵ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 427 parag. 2.

²¹⁶ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 436 parag. 2.

²¹⁷ Rexhep Murati, vep. e cit., fq. 295.

cohaesionis synon njësimin e pozitës së të bashkakuzuarve. Sipas kësaj rregulle, gjykata vepron ashtu sikur të ekzistonte ankimi: i bashkakuzuarit që nuk ka bërë ankim; i bashkakuzuari, ankimi i të cilit është hedhur poshtë si i palejuar ose jashtë afatit dhe në kushte të caktuara, ankimi i të bashkakuzuarit që ka hequr dorë prej tij. Siç mund të shihet, sipas nenit 397, me të akuzuarin që nuk është ankuar duhet të barazohet ai person i akuzuar, ankimi i të cilit është hedhur poshtë si i palejuar ose jashtë afatit.²¹⁸ Kur është fjala për ankimin e të bashkakuzuarit që ka hequr dorë nga ankimi theksohet se favor i bashkëngjijtes vjen në konsiderim vetëm atëherë kur i bashkakuzuari ka hequr dorë nga ankimi në të cilin si bazë ankimore ka paraqitur shkeljet e ligjit, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset kryesisht kur e shqyrton cilëndo ankesë. Gjykata duhet t'i marrë parasysh shkeljet e ligjit penal që janë bërë në dëm të të akuzuarit edhe atëherë kur i akuzuari ka hequr dorë nga ankimi, në të cilin ka parashtruar ato shkelje. Mirëpo, në literaturën e së drejtës së procedurës penale ka mendime se kur i bashkakuzuari është tërhequr nga ankimi me të cilin e ka kundërshtuar aktgjykimin për arsyet për të cilat Gjykata e Apelit kryesisht nuk kujdeset (sidomos kur është fjala për gjendjen faktike), ndërsa Gjykata e Apelit duke vendosur për ankimin e një të akuzuari tjetër, konstaton se arsyet e njëjta janë të bazuara, në këtë rast nuk vlen favor i bashkëngjijtes. Kjo arsyetohet me faktin se do të ishte në kundërshtim me dispozicionin e palëve që me privilegjin e bashkëngjijtes të bashkakuzuarit t'i pranohet arsyea nga e cila parashtruesi i ankesës me vullnetin e tij është tërhequr.²¹⁹

3. Vendimi i Gjykatës së Apelit lidhur me ankesën ndaj aktgjyimit të gjykatës themelore

Gjykata e Apelit në seancë të kolegjit ose në bazë të shqyrtimit:

- e hudh ankesën si të paafatshme ose të palejuar;
- e refuzon ankesën si të pabazë dhe e vërteton aktgjykimin e gjykatës themelore;
- e anulon aktgjykimin dhe çështjen ia kthen gjykatës themelore për rigjykim dhe vendim; ose e ndryshon aktgjykimin e gjykatës themelore.

Gjykata e Apelit mund të urdhërojë gjykatën themelore që të caktojë një tjetër gjyqtar të vetëm gjykues, kryetar të trupit gjykues ose trup gjykues sipas një sistemi të caktimit të lëndëve

²¹⁸ Afrim Shala, vep. e cit., fq. 183.

²¹⁹ Po aty.

që të jetë objektiv dhe transparent, nëse Gjykata e Apelit vlerëson se gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose trupi gjykues që e ka gjykuar rastin në mënyrë të vazhdueshme nuk e ka zbatuar ligjin siç duhet, ka vlerësuar shumë gabimisht provat ose mosçaktimi i gjyqtarit apo trupit gjykues tjetër do të rezultonte në keqpërdorim të drejtësisë ose konflikt të interesit. Gjykata e Apelit vendos për të gjitha ankesat kundër të njëjtit aktgjykim me një vendim. Vendimi i Gjykatës së Apelit nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët e kolegjit, përveç vendimit të marrë sipas nenit 399 ose 400 të këtij Kodi. Një anëtar i kolegjit mund të jep mendim të ndarë, mospajtues ose pajtues për çështjet juridike ose faktike lidhur me ankesën, dhe mendimi i tillë i bashkëngjitet vendimit kryesor.²²⁰

Gjykata e Apelit me aktvendim e hudh ankesën si të paafatshme kur konstaton se është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor.²²¹ Gjykata e Apelit me aktvendim e hudh ankesën si të palejueshme kur konstaton se është paraqitur nga personi pa të drejtë ankese ose nga personi që ka hequr dorë nga ankesa, apo kur ankesa është tërhequr, ose kur ankesa e tërhequr paraqitet sërish apo ankesa nuk është e lejuar me ligj.²²² Gjykata e Apelit me aktgjykim refuzon ankesën si të pabazë dhe vërteton aktgjykimin e gjykatës themelore kur vërteton se nuk ekzistojnë shkaqet për të cilat është ushtruar ankesë ndaj aktgjykimit dhe nuk ka shkelje të ligjit sipas nenit 394, paragrafi 1. i këtij Kodi.²²³ Gjykata e Apelit, në raste të caktuara, anulon aktgjykimin e gjykatës themelore dhe çështjen e kthen në rigjykim kur vërteton se:

- ekziston shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, dhe Gjykata e Apelit nuk mund të procedojë sipas nenit 403 të këtij Kodi; ose
- për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike duhet urdhëruar shqyrtim të ri gjyqësor në gjykatë themelore dhe Gjykata e Apelit nuk mund të procedojë sipas nenit 403 të këtij Kodi.

Gjykata e Apelit me aktvendim e anulon aktgjykimin e gjykatës themelore edhe refuzon aktakuzën nëse konstaton rrethanat nga neni 358, paragrafi 1. i këtij Kodi. Gjykata e Apelit procedon në të njëjtën mënyrë kur gjen se gjykata themelore nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e rastit, përveç kur ankesa është paraqitur vetëm në favor të të akuzuarit. Gjykata e Apelit mund të anulojë pjesërisht aktgjykimin e gjykatës themelore kur pjesë të posaçme të

²²⁰ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 398.

²²¹ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 399.

²²² Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 400.

²²³ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 401.

aktgjykimit mund të veçohen pa ndonjë pasojë për gjykim të drejtë. Në qoftë se i akuzuari gjendet në paraburgim, Gjykata e Apelit shqyrton nëse ende ekzistojnë shkaqet për paraburgim dhe vendos me aktvendim për vazhdimin ose heqjen e paraburgimit. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.²²⁴

Gjykata e Apelit e ndryshon aktgjykimin e gjykatës themelore me aktgjykim kur vërteton se gjykata themelore ka bërë vërtetim të gabuar apo jo të plotë të fakteve, dhe për këtë qëllim:

- në bazë të kërkesës së palëve ose sipas detyrës zyrtare, zbaton shqyrtim për të marr prova të reja apo për të përsëritur shqyrtimin e provave në mënyrë që të vlerësojë drejtë dhe të çmojë provat materiale; ose
- mund të vërtetojë dhe të çmojë provat materiale pa mbajtur shqyrtim, nëse nuk ka nevojë për të marrëprova të reja apo për të përsëritur shqyrtimin e provave.

Kur Gjykata e Apelit çmon se ekzistojnë kushtet ligjore për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, e ndryshon aktgjykimin e gjykatës themelore me aktgjykim dhe shqipton vërejtjen gjyqësore. Kur për shkak të ndryshimit të aktgjykimit të gjykatës themelore ka arsye për caktimin ose heqjen e paraburgimit, për këtë Gjykata e Apelit merr aktvendim të posaçëm. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.²²⁵

4. Ankesa në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit

Ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit mund të paraqitet në Gjykatën Supreme të Kosovës në rastin kur Gjykata e Apelit e ndryshon aktgjykimin lirues të gjykatës themelore dhe e zëvendëson me aktgjykim dënues për të akuzuarin ose kur me aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ose Gjykatës së Apelit i është shqiptuar dënimi me burg të përjetshëm. Nenet 389 deri 406 të këtij Kodi zbatohen përshtatshëmrisht për procedurën ankimore para Gjykatës Supreme. Aktgjykimet e Gjykatës Supreme nënshkruhen nga të gjithë gjyqtarët e kolegjit. Një anëtar i kolegjit mund të paraqesë mendim të ndarë, mospajtues ose pajtues mbi çështje ligjore ose faktike lidhur me ankesën dhe mendimi i tillë i bashkëngjitet aktgjykimit.²²⁶ Me mbështetje në të drejtën ndërkombëtare, në procedurën penale ekziston rregulla e përgjithshme sipas të cilës

²²⁴ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 402.

²²⁵ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 403.

²²⁶ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 407.

secilit i garantohet e drejta në ankesë kundër vendimeve të gjykatave me të cilat vendoset për të drejtën ose interesin e tij të bazuar në ligj. KPP ka përcaktuar sipas rregullit parimin e gjykimit të një çështje penale në dy shkallë dhe vetëm përjashtimisht ka lejuar gjykimin në shkallës të tretë. Kjo do të thotë se derisa kundër aktgjykimit të gjykatës themelore ankesa është gjithmonë e lejuar, ankesa kundër vendimit të Gjykatës së Apelit sipas rregullit nuk është e lejuar ashtu që çështja penale në shumicën e rasteve përfundon në formë e prerë në momentin e marrjes së vendimit nga Gjykata e Apelit. Me fjalë të tjera, kundër vendimit të tillë të Gjykatës së Apelit nuk mund të paraqitën mjetet e rregullta juridike por vetëm mund të paraqitën eventualisht mjetet juridike të jashtëzakonshme.²²⁷ Kundër aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk është e lejuar ankesa pa kurrfarë përjashtimi²²⁸, ndërkaq kundër aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit ankesa është e lejuar përjashtimisht në dy rastet taksativisht të përcaktuara në nenin 430, paragrafi 1 nënparagr. 1 dhe 2. Me marrjen e aktgjykimit të shkallës së dytë, sipas rregullit, çështja penale konsiderohet çështje e gjykuar; res judicata, sepse aktgjykimi e fiton formën e prerë. Megjithatë, në disa raste të caktuara, KPP lejon mundësinë e tri shkallëve, apo mundësinë e paraqitjes së ankesës kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Në të vërtetë ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, sipas nenit 407 të KPP, mund të paraqitet në rastet vijuese:

- kur Gjykata e Apelit ndryshon aktgjykimin lirues të gjykatës themelore dhe e zëvendëson me aktgjykim dënues për të akuzuarin ose
- kur me aktgjykimin e gjykatës Themelore ose Gjykatës së Apelit i është shqiptuar dënimi me burgim të përjetshëm.

Siç mund të shihet, KPP në fuqi ka reduktuar rastet e paraqitjes së ankesës kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit, nga tri raste sa ishin sipas KPP të mëparshëm vetëm në dy raste. Ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit mund të paraqitet sipas të gjitha bazave për ankesë por jo edhe për shkak të kërkesës pasurore juridike, shpenzimeve të procedurës penale ose vendimit mbi shpalljen e aktgjykimit, sepse ankesa në shkallë të tretë është dhënë për shkak të dënimit. Lidhur me ankesën kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit vendos Gjykata Supreme e Kosovës në seancë të kolegjit në përshtatshmëri me dispozitat e nenit 389, dhe 406, që vlejnë për procedurën para Gjykatës së Apelit. Më në fund, vlen të potencohet se vendimi i gjykatës së shkallës së dytë nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e kolegjit. Një anëtar i kolegjit mund të japë

²²⁷ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 972.

²²⁸ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 408.

mendim tjetër, mospajtues ose pajtues, për çështjet juridike ose faktike lidhur me ankesën të cilat i bashkëngjiten aktgjykimit (neni 407, paragrafi 3).²²⁹

KPP ka përcaktuar sipas rregullit parimin e gjykimit të një çështje penale në dy shkallë dhe vetëm përjashtimisht ka lejuar gjykimin në shkallës të tretë. Kjo do të thotë se derisa kundër aktgjykimit të gjykatës themelore ankesa është gjithmonë e lejuar, ankesa kundër vendimit të Gjykatës së Apelit sipas rregullit nuk është e lejuar ashtu që çështja penale në shumicën e rasteve përfundon në formë e prerë në momentin e marrjes së vendimit nga Gjykata e Apelit. Me fjalë të tjera, kundër vendimit të tillë të Gjykatës së Apelit nuk mund të paraqitën mjetet e rregullta juridike por vetëm mund të paraqitën eventualisht mjetet juridike të jashtëzakonshme. Kundër aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk është e lejuar ankesa pa kurrfarë përjashtimi i (neni 408), ndërkaq kundër aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit ankesa është e lejuar përjashtimisht në dy rastet taksativisht të përcaktuara në nenin 430, paragrafi 1 nënparagrafi 1 dhe 2. Analiza e dispozitave të nenit 407 me të cilat rregullohet e drejta në ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit tregon, se këto dispozita nuk përmbajnë ndonjë dispozitë të veçantë sa i përket të drejtës në ankesë, përmbajtjes, dhe bazave të ankesës. Për më tepër sipas paragrafi 2 të këtij neni në procedurën ankimore para Gjykatës Supreme zbatohen përshtatëshmërisht dispozitat lidhur me ankesën kundër aktgjykimin në Gjykatën e Apelit bazuar në nenet 389-406.²³⁰

Duhet vënë në dukje, se me dispozitën e paragrafi 3 të këtij neni në një mënyrë plotësohen dispozitat e nenit 471, 472 dhe 473, me të cilat rregullohet procedura e marrjes së vendimit në seancën për këshillim dhe votim. Dispozitat në fjalë, plotësohen konkretisht kur është fjala për marrjen e vendimit, ashtu që një anëtar i kolegjit mund të paraqesë mendim të ndarë, mospajtues ose pajtues mbi çështje ligjore ose faktike lidhur me ankesën, i cili i bashkëngjiten aktgjykimit. Po ashtu, me këtë dispozitë plotësohet edhe dispozita e nenit 395 paragrafi 2 lidhur me nënshkrimin e aktgjykimit ashtu që në paragrafin 3 të këtij neni shprehimisht përcaktohet se Aktgjykimet e Gjykatës Supreme nënshkruhen nga të gjithë gjyqtarët e kolegjit. Përbërja e kolegjit, kur gjykata Supreme e Kosovës vendos lidhur me ankesën kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, rregullohet me dispozitën e nenit 21, të Ligjit për gjykatat e rregullta.²³¹

²²⁹ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, vep. e cit., fq. 972.

²³⁰ Po aty.

²³¹ Po aty, fq. 973.

5. Ankesa kundër aktvendimit

Kundër aktvendimeve të gjyqtarit të procedurës paraprake dhe kundër aktvendimeve tjera të gjykatës themelore, palët dhe personat të drejtat e të cilëve janë shkelur, në pajtim me nenin 411 të këtij Kodi mund të paraqesin ankesë, me përjashtim kur me dispozitat e këtij Kodi shprehimisht nuk lejohet ankesë e tillë. Kundër aktvendimit të marrë në procedurë paraprake nga kolegji shqyrtues i përbërë nga tre (3) gjyqtarë nuk lejohet ankesë, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parasheh ndryshe. Aktvendimet që merren për përgatitjen e shqyrtimit gjyqësor dhe të aktgjykimit mund të kundërshtohen vetëm me ankesë kundër aktgjykimit, përveç kur ky Kod parasheh ndryshe. Kundër aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk lejohet ankesë.²³² Ankesa i paraqitet gjykatës e cila ka marrë aktvendimin. Me përjashtim të rasteve kur ky Kod parasheh ndryshe, ankesa kundër aktvendimit paraqitet brenda tri (3) ditëve nga dita e dorëzimit të aktvendimit.²³³ Me përjashtim të rasteve kur ky Kod parasheh ndryshe, paraqitja e ankesës pezullon ekzekutimin e aktvendimit ndaj të cilit është ushtruar ankesë.²³⁴

Pala e autorizuar paraqet ankesë në pajtim me këtë Kapitull. Ankesa e cila nuk paraqitet në pajtim me këtë Kapitull mund të hudhet menjëherë nga Gjykata e Apelit pasi të jetë siguruar se në ankesë nuk ngritet ndonjë çështje e rëndësishme lidhur me të drejtat kushtetuese të garantuara. Ankesa kundër vendimit të gjykatës themelore paraqitet nga ankuesi në gjykatë themelore. Gjykata themelore i dërgon palës kundërshtare kopjen e ankesës. Gjykata themelore i përcjellë ankesën, përgjigjen dhe shkresat e ndërlidhura Gjykatës së Apelit. Ankesa mbi aktvendimin e Gjykatës së Apelit paraqitet nga pala e autorizuar në Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit i dërgon palës kundërshtare kopjen e ankesës. Gjykata e Apelit i përcjellë ankesën, përgjigjen dhe shkresat e ndërlidhura Gjykatës Supreme. Ankesa e paraqitur nga paragrafi 6. i këtij neni që nuk është në pajtim me këtë Kapitull mund të hudhet menjëherë nga Gjykata Supreme pasi të ketë siguruar se në ankesë nuk ngritet ndonjë çështje e rëndësishme lidhur me të drejtat kushtetuese të garantuara. Në rastet nga paragrafi 2. ose paragrafi 9. i këtij neni kur ankesa ngrit çështje të rëndësishme për të drejtat e garantuara kushtetuese, por nuk është në pajtim me këtë Kapitull,

²³² Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 408.

²³³ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 409.

²³⁴ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 410.

ankuesit i jepet mundësia që të korrigjojë ankesën. Ankesa apo kërkesa nga ky nen paraqitet në numër të mjaftueshëm të kopjeve për gjykatën dhe palët kundërshtare.²³⁵

Kur Gjykata e Apelit pranon lëndën me ankesë, ajo ia dërgon lëndën prokurorit kompetent të shtetit në kuadër të Prokurorisë së Apelit, i cili e shqyrton lëndën dhe pa vonesë ia kthen gjykatës. Me rastin e kthimit të lëndës, prokurori i shtetit mund të paraqesë propozim ose të deklarojë se atë do ta paraqesë në seancën e kolegjit të apelit. Pasi që prokurori i shtetit e kthen lëndën, kryetari i kolegjit të apelit cakton seancën e kolegjit.²³⁶ Kur Gjykata e Apelit pranon ankesë kundër aktvendimit kolegji mund të vendos për mbajtjen e seancës në të cilën njoftohen: prokurori kompetent i shtetit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tij. Në qoftë se i akuzuari i cili gjendet në paraburgim ose në mbajtje të dënimit dëshiron të merr pjesë në seancë, atij i mundësohet pjesëmarrja. Kolegji mund të kërkojë nga palët dhe mbrojtësi që prezantojnë në seancë sqarime të nevojshme lidhur me pretendimet e tyre në ankesë. Palët dhe mbrojtësi mund të japin shpjegime të nevojshme për qëndrimet e tyre në ankesë apo përgjigjen në ankesë. Mosardhja e palëve të thirrur me rregull nuk pengon mbajtjen e seancës së kolegjit. Kur i akuzuari nuk e ka njoftuar gjykatën për ndërrimin e adresës ose të vendqëndrimit, seanca e kolegjit mund të mbahet edhe pa njoftimin e të akuzuarit. Publiku mund të përjashtohet nga seanca e kolegjit që mbahet me prani të palëve vetëm nën kushtet e parapara me këtë kod. Procesverbali i seancës i bashkëngjitet shkresave të gjykatës. Aktvendimet nga nenet 399 dhe 400 të këtij Kodi mund të merren edhe pa njoftimin e palëve për seancën e kolegjit.²³⁷

Aktvendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues ose trupit gjykues mund të ankimohet kur ai aktvendim shkel:

- të drejtën e cila i njihet palës me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- të drejtën thelbësore të palës të paraparë me këtë Kodi;
- të drejtën thelbësore të palës të paraparë me ndonjë ligj tjetër të Kosovës; dhe
- të drejtën procedurale që ka për qëllim garantimin e të drejtës nga nën-paragrafët 1.1. deri 1.3. të këtij neni;

Pala e cila kundërshton aktvendimin e gjykatës themelore duhet të demonstrojë se shkelja e së drejtës i shkakton asaj dëm të parevokueshëm. Nëse arsyet e ankesës nuk janë në pajtim me paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, Gjykata e Apelit mund të hedhë ankesën. Ankesa e cila hudhet

²³⁵ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 411.

²³⁶ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 412.

²³⁷ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 414.

sipas këtij paragrafi mund të paraqitet sërish me ankesë kundëraktgjykimin nga neni 380 i këtij Kodi.²³⁸

Me përjashtim të rasteve kur parashihet ndryshe me këtë Kod, ankesat kundër aktvendimit të gjykatës themelore vendosen në seancë të kolegjit të Gjykatës së Apelit. Kur vendos për ankesë, gjykata me aktvendim mund ta hedhë ankesën si të paafatshme ose të papranueshme, ta refuzojë si të pabazë, ta aprovojë ankesën dhe ta ndryshojë aktvendimin ose ta anulojë dhe, sipas nevojës, çështjen ta kthejë për rivendosje. Kur vendos mbi ankesën kundër aktvendimit me të cilin hudhet aktakuza, gjykata mund të refuzojë ankesën e tillë me aktgjykim nëse mëson se ka arsye për aktgjykim të tillë. Kur e shqyrton ankesën, gjykata interesohet sipas detyrës zyrtare për të mësuar nëse gjykata themelore ka pasur kompetencë lëndore për marrjen e aktvendimit dhe nëse aktvendimi është marrë nga organi i autorizuar.²³⁹

²³⁸ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 415.

²³⁹ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 416.

PËRFUNDIMI

Gjykata e shkallës së parë, me gjithë përpjekjet dhe garancitë procedurale për të marrë aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm, jo gjithmonë e arrin këtë qëllim ashtu që përvoja shekullore e jurisprudencës tregon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë shpesh herë përmban gabime faktike dhe juridike. Shkaqet më të shpeshta që mund të sjellin te aktgjykimi jo i drejtë dhe jo i ligjshëm janë: lajthitjet e ndryshme, çmuarja e gabuar e provave, dalja në shesh e provave të panjohura deri pas marrjes së aktgjykimit, mungesa e profesionalizmit, mbingarkesa e gjykatës e të tjera. Për të evituar gabimet faktike dhe juridike në aktgjykimin e shkallës së parë, në procedurat penale bashkëkohore janë miratuar sisteme të ndryshme të mjeteve juridike. E drejta e përdorimit të mjeteve juridike në procedurën penal bashkëkohore është një e drejtë themelore e të pandehurit kundër të cilit zbatohet procedimi penal. Me realizimin e kësaj të drejte, në fakt mbrohen të drejtat dhe liritë e njeriut. Të drejtë në paraqitjen e mjeteve juridike, përveç të pandehurit e ka edhe pala kundërshtare por për shkaqe të caktuara i dëmtuari dhe disa persona të tjerë. Shqyrtimi i vendimit gjyqësor në shkallë të dytë nuk është i detyrueshëm. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë shqyrtohet parimisht në kufijtë e mjetit juridik të personave të autorizuar dhe përjashtimisht jashtë kufijve të mjetit juridik.

Ankesa kundër aktgjykimit është një mjet i rregullt juridik i goditjes së vendimeve gjyqësore të cilat nuk e kanë marrë formën e prerë. Ankesa kundër aktgjykimit në procedurë penale konsiderohet mjet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut për arsye se ekziston mundësia që me aktgjykim të shkelen të drejtat e njeriut. Në këtë mënyrë gjykata më e lartë asnjëherë nuk e merr në shqyrtim çështjen të cilën e ka zgjidhur gjykata më e ulët nëse kundër vendimit të gjykatës më të ulët nuk paraqitet ankesë. Prandaj me shqyrtimin e çështjes nga gjykata më e lartë, mundësohet që të mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në përgjithësi të eliminohen të metat që e kanë shoqëruar procedurën pranë gjykatës së shkallës së parë. Paraqitja e ankesës kundër aktgjykimit, në anën tjetër konsiderohet edhe si e drejtë themelore e njeriut e cila është e garantuar si me akte juridike të brendshme ashtu edhe me akte juridike ndërkombëtare.

ankesa si mjet i goditjes së vendimeve gjyqësore është e parashikuar në të gjitha procedurat gjyqësore, si psh., në procedurën penale, kontestimore, jokontestimore, përmbarrimore, administrative, etj. Duke i marrë për bazë elementet e përcaktuara me ligj, mund të përcaktojmë

edhe nocionin e ankesës kundër aktgjykimit në procedurë penale. Në këtë mënyrë ankesa kundër aktgjykimit është një mjet juridik i rregullt, suspenziv, i plotë, i dyanshëm të cilën e paraqesin personat e autorizuar për shkak të gabimeve ligjore apo faktike dhe me të cilën i propozojnë gjykatës së shkallës së dytë që aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj apo ta anuloj. për shkak të rëndësisë së saj shumë të madhe, rekomandohet që sa më shumë të shfrytëzohet e drejta e paraqitjes së ankesës kundër aktgjykimit në procedurë penale, sidomos nga i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, në rastet e shqiptimit të dënimit me burgim.

Ankesa kundër aktgjykimit në procedurë penale të rregullt duhet të ketë përmbajtjen e saj, në mënyrë që të mund të veprohet sipas saj. përmbajtja dhe elementet e ankesës kundër aktgjykimit në procedurë penale janë të përcaktuara me ligj. Ankesa e cila përmban të gjitha elementet e përcaktuara me ligj në teorinë e së drejtës së procedurës penale quhet ankesë e plotë.

Në ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit në procedurë penale mund të paraqiten fakte dhe prova të reja, mirëpo ankuesi është i obliguar që të paraqes arsye pse ato nuk i ka paraqitur më parë. në praktikën gjyqësore, kemi konstatuar se në një numër të vogël të rasteve në ankesë, ankuesi ka paraqitur fakte dhe prova të reja. ankesa kundër aktgjykimit mund të paraqitet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të shkeljes së ligjit penal, për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, konfiskimit të dobies pasurore juridike të fituar me vepër penale, shpenzimeve të procedurës penale, kërkesave pasurore juridike si dhe për shkak të vendimit mbi publikimin e aktgjykimit.

Ankesa kundër aktgjykimit duhet të paraqitet brenda afatit të përcaktuar me ligj. Afati për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit është afat ligjor dhe prekluziv. Është afat ligjor sepse është i përcaktuar me ligj, ndërsa është afat prekluziv sepse nuk mund të zgjatet dhe mos paraqitja e ankesës kundër aktgjykimit brenda këtij afati, do të thotë humbje e të drejtës për paraqitjen e ankesës pas këtij afati. Gjykata e shkallës së parë para se t'ia dërgoj ankesën gjykatës së shkallës së dytë, duhet që një kopje të ankesës t'ia dërgoj palës kundërshare, e cila në afat prej 8 ditëve ka të drejtë të paraqes përgjigje në ankesë. Personat të cilët sipas dispozitave të KPPK-së, kanë të drejtë të paraqesin ankesë kundër aktgjykimit në procedurë penale i kemi quajtur persona të autorizuar për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit.

Procedura sipas ankesës është faza e tretë e procedurës së rregullt penale. Kjo faze e procedurës penale, nuk është obligative, sepse procedura penale, mund të përfundojë edhe pa kaluar nëpër këtë faze, nëse personat e autorizuar nuk paraqesin ankesë kundër aktgjykimit.

Procedura jonë penale, parimisht është procedurë dyshkallëshe, çka do të thotë se me marrjen e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, sipas rregullit, çështja penale konsiderohet çështje e gjykuar (res iudicata), sepse aktgjykimi e fiton formën e prerë. Mirëpo me dispozitat e KPPK-së, është parashikuar mundësia e paraqitjes së ankesës edhe kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë përkatësisht lejohet trishkallëshmëria në procedurë penale. Rastet për të cilat mund të paraqitet ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë janë caktuar në mënyrë shprehimore me KPPK.

LITERATURA

1. Alsula Ardita, Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë me praktikë gjyqësore, Tiranë, 2008.
2. Aleks, Luarasi, Kodi i procedurës penale me praktikë gjyqësore, botimi i parë, Tiranë, 2002.
3. Afrim Shala, Ankesa kundër aktgjyimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2010.
4. Afrim Shala, Kompetencat e gjyqtarit të procedurës paraprake sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Revista “Justicia”, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, 2009.
5. Afrim Shala, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, Gjiilan, 2010.
6. Azem Hajdari, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2013.
7. Azem Hajdari, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2009.
8. Burim Ademi, Afrim Shala, Avni Mehmeti, Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional (Penale-materiale dhe procedurale), Prishtinë, 2021.
9. Bashkim Hyseni, Albert Zogaj, Fejzullah Hasani, Doracak i gjyqtarve për shkrim dhe arsyetim ligjor, Prishtinë, 2017.
10. Dragoljub Dimitrijeviq, E drejta e procedurës penale, (botim shqip), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të KSAK, Prishtinë, 1976.
11. Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005, fq. 223.
12. Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, Komentar Kodi i Procedurës, Prishtinë, 2014.

13. Ejup Sahiti, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, (shqyrtim teorik), Revista “E drejta”, nr. 3/2003, Prishtinë.
14. Ejup Sahiti, Rexhep Murati, E drejta procedurale penale “Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës”, botim i dytë, Prishtinë, 2004.
15. Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, Criminal Procedure System of Kosovo, Transittion of criminal procedure systems, volume II, Rijeka, 2004.
16. Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, Procedura penale, komentar, Tiranë, 2003.
17. Halim, Islami, Artan, Hoxha, Ilir, Panda, Procedura penale, Tiranë, 2009.
18. Henrik, Ligori, Manual i procedurës penale për policinë gjyqësore, Korçë, 1999.
19. Ismet Elezi, Njohuri për të drejtën zakonore mbarë shqiptare, Prishtinë, 2003.
20. Joel Samaha, Criminal Law, Tenth Edition, Wadsworth, Cengage Learning, 2011.
21. Maksim Haxhia, Komentar i Kodit Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1997.
22. Rexhep Murati, Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe provave të reja, Prishtinë, 2006.
23. Rexhep, Murati, Judicial criminal system in Kosova and the protection of human rights and fundamental freedoms, DIR-diritto&diritti, 08/12/2011.
24. Rexhep, Murati, Main Characteristics of the Judicial Criminal System in Kosovo, Deccenium Moztanicense, Rijeka, 2008.
25. Rexhep, Murati, Protection of Human Rights Under Kosovo’s Criminal Code and Criminal Procedure Code, Chicago-Kent Law Review, Volume 80, Number 1, 2005.
26. Rexhep Murati, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2022.
27. Tahir Rrecaj, Enver Peci, Kodi i Procedurës Penale, pjesa 5-8, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, 2008.
28. Koço Nova, Zhvillimi historik i gjykimit në Shqipëri, Tiranë, 1965.

29. Koço Nova, Procedura Penale, pjesa e përgjithshme, Tiranë, 1966.
30. K. Krisafi, etj, Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri, Tiranë, 2001.
31. Marenglen Rrapi, Komentari i Kodit të Procedurës Penale, Tiranë, 2000.
32. Shtjefën Gjeçovi, vepra 1 Kanuni i Lekë Dukagjinit, Rilindja, Prishtinë, 1985.
33. Weaver, Russell L. - Abramson, Leslie W. - Bacigal, Ronald - Burkoff, John M. - Hancock, Catherine - Lively, Donald E., Criminal Procedure: Cases, Problems and Exercises, second edition, Weaver, 2003.

Akte ligjore

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.
2. Kodi Nr. 04/L-123, i Procedurës Penale i Kosovës.
3. Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Kosovës.
4. Ligji për gjykatat i Kosovës.
5. Ligjin për amnistinë Ligji Nr. 04/L-209, datë 11 korrik 2013.